

GUIDA E STUDENTIT

2015-2016



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE



FAKULTETI I
SHKENCAVE HUMANE

Përmbajtja

1. Hyrja	3
2. Informacion i përgjithshëm për Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë	4
3. Statuti	6
4. Rregullorja	32
5. Te Drëjtat dhe Detyrat e Studentit	74
6. Rregjistrimi në UniVlora	76
7. Tarifat dhe kuotat e Studimit në Bachelor dhe Master	80
8. Bursat	84
9. Akomodimi i Studenteve	91
10. Përshkrimi i Fakultetit	93
11. Programet e Studimit dhe Përshkrimi i Lëndëve	96



Hyrja

Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës është universitet publik dhe i njohur në shkallë kombëtare, i cili u ofron studentëve një arsim profesional me cilësi të lartë dhe kosto të ulët përmes kombinimesh të shumëllojshme të studimeve vetijake, mësimdhënies profesionale dhe përvojës kulturore dhe sociale. I njohur si një nga universitetet kryesore të Shqipërisë universiteti i Vlorës u ofron 9.000 studentëve të tij për të marrë pjesë drejtpërdrejt në projekte kërkimore të drejtuara nga profesorë ekspert, të cilët sjellin njohuritë më të freskëta nga terreni drejt e në klasë. Në të gjitha aktivitetet e tij universiteti i Vlorës synon të jetë shembull drejtimi në arsim. Duke pasur në qendër një program të forte shkencash dhe inxhinierie, universiteti është i organizuar në: Fakultetin e Ekonomisë, Fakultetin e Shkencave Teknike, Fakultetin e Shkencave Humane si dhe Fakultetin e Shëndetit Publik. Universiteti ruan karakteristika të theksuara të mësimdhënies cilësore akademike, duke krijuar një ambient dinamik me në qendër studentin, si dhe duke integruar studimin e lirë profesional të studentit me përkushtimin e antareve të stafit akademik. Vlora vet ofron një experiencë të veçantë jo vetëm në studimet universitare, por ajo karakterizohet edhe nga programe të forta pasuniversitare dhe me arritje të dukshme në punën kërkimore. I lokalizuar në gjirin e Vlorës universiteti mund të arrihet lehtë nga miliona njerez që vijnë çdo vit për të vizituar qytetin tonë. Marrdhëniet e universitetit të Vlorës me komunitetet e qytetit e pasuron mjaft jetën studentore.

Informacion i pergjithshem per Universitetin “Ismail Qemali” Vlore

Vlora ka një traditë shumë të mirë në drejtim të arsimit. Shkolla “Tregëtare” e krijuar që në 1919 ka qenë një nga shkollat më të mira dhe më të njohura në Shqipëri për nivelin e saj shkencor . Gjatë periudhës 1970-1980 në Vlorë ka funksionuar Filiali i Fakultetit Ekonomik kryesisht për përgatitjen e kuadrove që do t'u shërbenin nevojave të ndërmarrjeve të ndryshme që operonin në qytet në degët e Ekonomisë , Planifikimit dhe Financës, me një staf akademik të përgatitur profesionalisht. Ekzistenca e kësaj shkolle ishte në atë periudhë ndihmëse e madhe për ekonominë e rrethit duke pasur parasysh që mbi 90% e punonjësve ishin pa arsim të lartë ndërkohë që kishin përvojë pune.

Mjaft nga studentët e asaj periudhe morën në dorë drejtimin e shumicës së ndërmarrjeve shtetërore . Në kuadrin e traditës arsimore të këtij qyteti vlen të përmendet Shkolla e Lartë e Marinës dhe Aviacionit të cilat kanë pasur si prioritet përgatitjen e kuadrove të aftë në fushat e tyre.

Një nga pikat kulmore të historisë më të re të Vlorës 2600 vjecare është hapja e Universitetit “Ismail Qemali”.

Idetë e para të këtij tempulli të dijes e kanë zanafillën e vet tek rilindasit tanë të mëdhenj, të cilët në pikëpamjet e tyre për zhvillimin e arsimit në Shqipëri parashikuan nevojën e ndricimit të mendjes së njerëzve dhe ndërgjegjes së tyre kombetare me anën e arsimit .

“Në ka gjë për të cilën shqiptarët duhet të kujdesen më tepër, ajo pa dyshim është dituria “-thotë Sami Frashëri.

Me V.K.M nr 105 dt. 28.02 1994, Universiteti më i ri i Shqipërisë , Universiteti “Ismail Qemali” hapi dyert e tij më 10 Tetor 1994 për 162 studentët e parë të shpërndarë në tre fakultete: Fakulteti i Tregëtisë me degët Biznes dhe Turizëm, Fakulteti i Marinës me degen Inxhinjeri Navale dhe Fakulteti i Infermierisë me degën Infermieri.

Për organizimin e gjithë punës përgatitore të ngritjes së Univeristetit u ngrit nje grup pune i krijuar nga Dr. Sezai Bazaj i cili me hapjen e Universitetit u emerua dhe Rektor i ketij institucioni. Universiteti filloi punë në dy godina që u rikonstruktuan (sot godina e Rektoratit dhe e Fakultetit te Mesuesise dhe Departamenti Infermierisë) me 162 student në të katër degët e tij dhe 10 pedagog efektive. Në fillimit e tij emertimi i Universitetit ishte “Universiteti Teknologjik Ismail Qemali Vlorë”. Nga viti në vit universiteti filloi të rritet si në numrin e degëve të reja ashtu edhe atë të studenteve dhe pedagoqeve efektive.

· Në vitin akademik 1995-1996 u hap dega e Gjuhes Angleze me 20 student dhe 4 pedagog efektiv.

· Në 1998 u hapen deget e Matematikë-Fizikës, dega e Ciklit te UlëtÂ si dhe dega e Navigacionit.

· Në vitin 2002 u hap dega e Gjuhes Italiane me 45 studente dhe 5 pedagoqe efektiv, si dhe dega e Ciklit te Ulët Parashkollor.

Në vitin 2003 u hap dega e Juridikut e atashuar pranë fakultetit te Tregëtisë si dhe Dega e Teknologjisë së Informacionit e atashuar prane Fakultetit te Detarisë.



Po në vitin 2003 ne bashkpunim me ambasaden Zvicriane dhe shoqaten "ASED" te Zvicres u hap kursi i parë për "Mesues dhe edukator të specializuar" të cilët do të shërbenin kryesisht në institucione me fëmijë antikapatë.

Në vitin 2005 u hap dhe dega e Gjuhë-Letërsisë Shqipe me 240 student. Krahas këtyre në vitin 2004-2005 u hap dhe sistemi i studimit me kohë të pjesshme (part-time) në degët Biznes, Turizem, Matematikë-Fizikë, Gjuhë-Letërsi, Cikël i Ulët, Cikël i Ulët Parashkollor.

Në vitin akademik 2007-2008 Universiteti "Ismail Qemali" numëron 14 degë me mbi 10000 student në të dy sistemet e studimit me 105 pedagog efektiv dhe mbi 400 pedagog te jashtëm, deri tani jane diplomuar mbi 4000 diplomant.

Në vitin 1998 Rektor u emerua Dr. Bilal Shkurtaj (sot Prof.Dr), i cili u zgjodh nga senati ne dy mandate, deri në zgjedhjet e vitit 2008 ku Rektor u zgjodh Prof. Tanush Shaska, i cili u largua në vitin 2010. Menjëherë pas largimit të këtij Rektori në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës u organizuan zgjedhjet të cilat nxorrën fitues me një shumicë të cilësuar votash Rektorin e ri Prof. Dr. Albert Qarri, i cili vazhdon në këtë detyrë edhe sot. Gjatë periudhes 14 vjecare të egzistences së vet Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës në menyre të vazhdueshme ka bërë përpjekje serioze për ngritjen e nivelit të mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore shkencore.

Për realizimin e këtyre objektivave është synuar në disa drejtime.

1. Në kualifikimin e vazhdueshem të pedagoqeve të rinj efektiv dhe të jashtëm. Universiteti e filloi punën me vetëm dy doktor shkencash ndërsa sot janë 3 profesor doktor, 6 profesor të asociuar dhe mjaft doktor shkencash. Pothuajse të gjithë pedagogët efektiv kanë fituar master të nivelit të dytë ose janë duke e përfunduar atë.

2. Lidhja me universitetet e vendeve të tjera ka qenë një nga pikësnyimet kryesore

për shkëmbimin e përvojave dhe modernizimin e tij. Kështu që në vitin e parë e në vazhdim është rritur numri i Universiteteve me të cilat Fakultetet e veçantë apo gjithë Universiteti ka krijuar lidhje të vazhdueshme ku pedagogët e tij kanë kryer kualifikime afatgjata ose afatmesme dhe afatshkurtra. Të tillë mund te përmendim Universitetin e Barit dhe Leces, Kozences Itali, Universitetin e Janines (Greqi), Universitetin e Nebraskës dhe Kolegjin San Hills ne SHBA, Universiteti Kokoolas në Finlande etj.

3. Ngritja dhe fuqizimi i bazës laboratorike ka qenë një domosdoshmeri e vazhdueshme për përsosjen e nivelit të mësimdhënies. Universiteti filloi punën me një kabinet modest të Fizikës dhe disa kabinete të Infermjerisë të trashëguar nga shkolla e mesme, inagurimi e gjeti Universitetin me vetëm një kompjuter. Gjatë viteve nga të gjithë departamentet është synuar fuqizimi i bazës materiale dhe sot mund të përmendim se kemi ngritur një sërë laboratoresh dhe kabinetesh mësimore ku mund të përmendim 5 kabinete Informatike, Kabinetine Gjuheve te Huaja, Laboratorin e Fizikës, Kimisë, Biologjisë, tre kabinete të Infermieristikës, kabinetin e Navigacionit etj. Sot numërohen 150 kompjutera në gjithë departamentet si dhe nje teknikë e pasur audio-vizive për transmetimin e njohurive.

4. Pjesëmarrja në mjaft projekte shkencore nga Universitetet e vendeve fqinje, pjesëmarrja në mjaft simpoziume e konferenca shkencore brenda dhe jasht vendit ka ndikuar ndjeshëm në kualifikimin e pedagoqeve tanë, por edhe në rritjen e kredibilitetit të Universitetit tonë jasht vendit.

5. Përfshirja e Universitetit tonë në zbatimin e Deklaratës së Bolonjës si dhe përsosja e strukturave të tij në të ardhmen do të krijonte mundësi që Universiteti "Ismail Qemali" të jetë një ndër më të kërkuarit nga studentët shqiptar pse jo edhe nga të jashtëm. Kjo është ambicja e gjithë stafit akademik, i cili në moshë mesatare mjaft të re, me kerkesat e

larta për kualifikim dhe me një organizim bashkëkohore të gjithë veprimtarisë garantojnë arritjen e këtij qëllimi.

Statuti

Miruar me Vendim nr.31, date 22.07.2013 të Senatit Akademik të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë

Kreu I : Dispozita të përgjithshme

- Neni 1: Pozita juridike
- Neni 2: Baza ligjore
- Neni 3: Roli dhe Misioni
- Neni 4: Qëllimet
- Neni 5: Parimet organizative
- Neni 6: Programimi i veprimtarisë

Kreu II : Organizimi i brendshëm i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë

- Neni 7: Njësitë përbërëse dhe struktura
- Neni 8 : Fakultetet
- Neni 9 : Departamentet
- Neni 10 : Organizimi i administratës

Kreu III : Organet dhe autoritetet drejtuese në universitet

- Neni 11 : Senati akademik
- Neni 12 : Këshilli i administrimit
- Neni 13 : Këshilli i etikës
- Neni 14 : Këshilli i profesoreve
- Neni 15 : Këshilli i fakultetit
- Neni 16 : Rektorati
- Neni 17 : Rektori
- Neni 18 : Zëvendësrektorët
- Neni 19 : Kancelari
- Neni 20 : Dekani
- Neni 21 : Zëvendësdekani
- Neni 22 : Përgjegjësi i departamentit

Kreu IV : Organizimi i studimeve

- Neni 23 : Studimet universitare
- Neni 24 : Ciklet dhe titujt e studimeve universitare
- Neni 25 : Pranimi në ciklet e studimeve
- Neni 26 : Sekretaria mesimore dhe regjistri themeltar
- Neni 27 : Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

- Neni 28 : Transferimet e studimeve
- Neni 29 : Transferimi për në institucione të tjera të arsimit të lartë
- Neni 30 : Transferimi nga institucione të tjera të arsimit të lartë dhe brenda vetë universitetit
- Neni 31 : Ndjekja e një programi të dytë studimi
- Neni 32 : Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve
- Neni 33 : Viti akademik sabbatik
- Neni 34 : Vlerësimi
- Neni 35 : Detyrimet dhe të drejtat e studentëve
- Neni 36 : Karta e Studentit
- Neni 37 : Organizimet studentore

Kreu V : Personeli i universitetit dhe punësimi

- Neni 38 : Struktura dhe organika
- Neni 39 : Personeli i universitetit
- Neni 40 : Punësimi i personelit me kohë të plotë
- Neni 41 : Kërkesat për punësim
- Neni 42 : Norma mesimore dhe mbingarkesa
- Neni 43 : Procedura e konkurimit
- Neni 44 : Komisioni i vlerësimit
- Neni 45 : Koha e provës
- Neni 46 : Kontrata e punës
- Neni 47 : Personeli akademik i ftuar
- Neni 48 : Personeli akademik me kontratë
- Neni 49 : Mbarimi i marrëdhënieve të punës
- Neni 50 : Masat Disiplinore
- Neni 51 : Konflikti i interesave
- Neni 52 : Kontrolli i cilësisë së mësimdhënies
- Neni 53 : Kërkimi shkencor



Neni 54 : Financimi i kërkimit shkencor

Neni 55 : Kërkimi shkencor me ose për të tretët

Kreu VI : Autonomia financiare

Neni 56 : Autonomia financiare

Neni 57 : Hartimi i buxhetit

Neni 58 : Burimet e financimit

Neni 59 : Kontrolli dhe auditimi

Kreu VII : Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 60 : Vula zyrtare dhe stema

Neni 61 : Miratimi i rregulloreve

Neni 62 : Hyrja në fuqi

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Pozita juridike

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është institucion publik i Arsimit të Lartë, me karakter mësimor e shkencor. Ai është krijuar me vendimin e këshillit të Ministrave Nr. 105, dt. 28.02.1994, bazuar në nenin 57, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është person juridik me seli në godinën qendrore të Rektoratit, me vendndodhje në Lagjen "Pavarsia", Rruga "Skelë" Vlorë, Albania.

3. Rektori është autoriteti që vepron në emër të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Brenda kufijve të të drejtave që i njeh ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ky Statut, Rregullorja dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

4. Stema dhe vula e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është sipas anekseve bashkëlidhur këtij statuti.

Neni 2 Baza ligjore

1. Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është hartuar, bazuar në Ligjin Nr. 9741,

datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi. Ai e shtrin veprimin e vet mbi të gjitha njësitë përbërëse organizative të këtij universiteti.

Neni 3 Roli dhe misioni

1. Përcaktimi i rolit dhe misionit të universitetit është si më poshtë. Në të theksohen katër përbërësit thelbësorë për drejtimin e universitetit:

a. mësimdhënie bashkëkohore sipas të gjitha standarteve ndërkombëtare;
b. punë kërkimore bazë dhe e aplikuar, si dhe punë akademike të cilësisë së lartë;
c. shërbime të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet;
d. programe gjithëpërfshirëse aktiviteteve për zhvillimin e studentëve.

2. Si institucion i arsimit të lartë i mbështetur nga shteti, Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ka një mision të dyfishtë:

a. Ofron programe studimi në mjaft fusha të cilat kulminojnë në diploma universitare të ciklit të parë "Bachelor", të ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional" si dhe programe të vecanta të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës së bashku me programe të tjera kualifikimesh profesionale;

b. Çon përpara njohurinë dhe shkencën përmes punës kërkimore, punës akademike dhe aktivitetit kreativ.

3. Në të gjitha aktivitetet e tij, Universiteti synon të jetë shembull drejtimi në arsim.

Neni 4 Qëllimet

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, është një bashkësi që ka për detyrë parësore kërkimin, studimin dhe formimin shkencor të studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës, për çdo tip formimi të nivelit të lartë, përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e



profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet, me interes publik apo privat.

3. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ndërmerr çdo inisiativë derisa e drejta e studimit të thelluar të studentit të jetë përmbushur në të tre nivelet, si dhe u garanton atyre realizimin e objektivave kulturore dhe profesionale.

4. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë u garanton punonjësve akademikë mundësi të barabarta për të përfituar nga financimet për kërkimin shkencor.

5. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë promovon dhe nxit dimensionin ndërkombëtar të studimeve, të të mësuarit dhe të kërkimit shkencor. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë konsideron si një nga detyrat e tij themelore edhe zhvillimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të pedagogëve dhe të studentëve, si dhe pranimin e formimit të studentëve të huaj.

6. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ndjek qëllimet e tij në përputhje të plotë me dinjitetin human, në pluralizmin e ideve dhe në transparencën e procedurave. I garanton çdo pedagogu autonominë e kërkimit dhe larmine e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij Statuti, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me të drejtën e studimit dhe pozitën juridike përkatëse.

7. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë lëshon diploma apo jep tituj akademik në përputhje me nivelin e kualifikimit dhe të aktivitetit kërkimor-shkencor. Gjithashtu ka të drejtën të japi certifikata apo tituj për kurse trajnimi, studime kualifikimi (Life Long Learning) apo kurse ad-hoc, sipas nevojave të shoqërisë, pasi me pare të jene miratuar nga instancat perkatese.

8. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë promovon aktivitete shkencore, organizon dhe përmbush shërbime kulturore dhe formuese në territorin e qarkut të Vlorës, në të gjithë vendin, si dhe jashtë tij.

9. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë organizon brenda tij vlerësimin e arritjes së qëllimeve të tij institucionale.

10. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë vendos dhe favorizon drejtimin didaktik të studentëve sipas nevojave formuese të tyre.

11. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është institucion i depolitizuar, laik dhe respekton shprehjen e lirë të ideve sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Parimet organizative

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka zotësi të plotë për të vepruar si subjekt i së drejtës publike dhe private, për të përmbushur qëllimet e tij, si dhe në ushtrim të kompetencave përkatëse, me përjashtim të atyre që nuk sjellin asnjë përfitim për qëllimet e universitetit.

2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë favorizon e garanton, diskutimin dhe shkëmbimin e mendimit të lirë për problemet që lidhen me përmbushjen e qëllimeve të universitetit. Gjithashtu garanton publikimin e propozimevetë akteve që shqyrtojnë organet e tij, me përjashtim të atyre propozimeve që kanë karakter thelbësisht privat apo personal. Publikimi kryhet me anë të shpalljes apo shpërndarjes së projekteve, si dhe me njoftimin e mëpastajm të akteve të miratuara nga organet kolegjiale përkatëse.

3. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë favorizon pjesmarrjen në votime dhe fshehtësinë e votës, në zgjedhjen e organeve të tij.

4. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë vlerëson mënyrën e përdorimit të buxhetit të shpenzuar nga njësitë e tij në përmbushjen e detyrave përkatëse, me qëllim ekonomizimin dhe efikasitetin e drejtimit të universitetit dhe përpunon e shpall indikatorët për të verifikuar objektivat e vendosura, rezultatet e arritura dhe kostot përkatëse.

5. Bilancet e Universitetit dhe të njësisve të tij, që kanë autonomi të brendshme financiare bëhen publike 30 ditë pas aprovimit nga organi përkatës.

6. Universiteti vendos lirisht për të kërkuar konsulencën e Avokaturës së Shtetit apo të

avokatëve profesionistë të lirë, të rregjistruar në Dhomën Kombëtare të Avokatëve.

Neni 6 **Programimi i veprimtarisë**

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë e zhvillon veprimtarinë e tij institucionale në mënyrë të pavarur në sistemin universitar ndërkombëtar, me partnerë me të cilët bashkëpunon dhe vetërregullon marrëdhëniet me qëllim përmbushjen e objektivave të tij.
2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në përputhje me objektivat e tij, të politikës kulturore, të kërkimit, të mësimdhënies dhe në respektimin e lirisë të secilit, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkuron ne projekte kombëtare e ndërkombëtare te fushave te ndryshme dhe vecanerisht projektet me impakt për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik dhe kulturor dhe financimin e tyre.
3. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në mbështetje të veprimtarisë së tij, të aktivitetit dhe kërkimit shkencor, të promovimit të vlerave, publikon periodikisht revista shkencore, proceeding të konferencave dhe aktiviteteve shkencore si dhe botime të ndryshme.

KREU II **ORGANIZIMI I BRENDSHËM I** **UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Neni 7 **Njësitë përbërëse dhe struktura**

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përbëhet nga njësitë kryesore (fakultetet), njësitë bazë (departamentet), Qendra Kërkimore-Shkencore, Shkolla e Masterit dhe Doktoratures, labororet, bibliotekat, qendrat dhe njësitë e tjera ndihmëse dhe administrative. Struktura organizative e miratohet me vendim të Këshillit të Administrimit me propozim të Rektoratit.
2. Organigrama percakton qartesisht struktura e universitetit. Detyrat dhe

veprimtaria e seciles njesi, secilit drejtues, personelit akademik, secilës zyre apo punonjesi administrative dhe mbeshtetes përcaktohet në rregulloret perkatese te institucionit dhe ne ate administrates se universitetit me përjashtim të atyre punonjësve që i kanë të përcaktuara në akte të tjera, veç sa parashikohet nga ligji dhe në këtë statut.

Neni 8 **Fakultetet**

1. Fakultetet si njësi kryesore përbëhen nga njësitë me emërtimet përkatëse, të cilat përcaktohen në rregulloren e universitetit që miratohet në zbatim të këtij statuti. Fusha specifike e secilës njësi bazë përcaktohet në rregulloren e fakultetit.
2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka këto njësi kryesore përbërëse:
 - a. Fakultetin e Ekonomisë
 - b. Fakultetin e Shkencave Teknike
 - c. Fakultetin e Shkencave Humane
 - d. Fakultetin e Shëndetit Publik
3. Secila nga këto njësi ka strukturën e saj, si dhe ka autonomi normuese, vetveprimi dhe financiare, sipas përcaktimeve në këtë statut dhe në rregulloren e universitetit.
4. Strukturat e reja të universitetit krijohen vetëm me vendim të Senatit Akademik dhe miratim të organit shtetëror kompetent. Ndryshimi i këtyre strukturave duhet të pasqyrohet menjëherë në statut.

Neni 9 **Departamentet**

1. Departamenti është njësia bazë mësimore-shkencore. Objekti i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Propozimi për hapjen dhe mbylljen e tyre bëhet me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe miratim të Senatit Akademik. Departamentet duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj. Në rast se këto kritere nuk plotësohen, u lihet një afat 5-vjeçar.



2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka këto njësi bazë përbërëse:

- a. Departamenti i Biznesit
- b. Departamenti i Ekonomiksit
- c. Departamenti i Financës
- d. Departamenti i Matematikës
- e. Departamenti i Fizikës
- f. Departamenti i Kimisë
- g. Departamenti i Biologjisë
- h. Departamenti i Shkencave Kompjuterike
- i. Departamenti i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale
- j. Departamenti i Inxhinierisë Elektrike
- k. Departamenti i Shkencave Detare
- l. Departamenti i Edukimit
- m. Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë
- n. Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- o. Departamenti i Drejtësisë
- p. Departamenti i Infermierisë
- q. Departamenti i Shendetit Publik
- r. Departamenti i Kujdesit për Nënë dhe Fëmijën

3. Veprimtaria, fusha e kërkimit shkencor, disiplinat mësimore dhe struktura organizative e secilit departament bazohet në ligj, Statutin dhe Rregulloren e universitetit.

Neni 10

Organizimi i administratës

1. Administrata sipas natyrës dhe funksioneve organizohet në departamente, degë dhe sektorë. Krijimi i degeve, departamenteve dhe sektorëve propozohet nga Rektorati dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit.
2. Struktura e organizimit të administratës dhe numri i punonjësve miratohen nga rektori.
3. Administrata e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore është e organizuar si më poshtë:
 - a. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve
 - Sektori i Marrëdhënieve me Studentët dhe Statistikës
 - Zyra Akademike
 - Zyra e Regjistrimit
 - b. Sektori i Burimeve Njerëzore
 - Protokoll Arkiva

- Specialiste pranë rektorit
- Sherbimi i Informacionit
- c. Drejtoria e Komunikimit
 - Zyra e Publikimeve dhe Botimeve Universitare
 - Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë
 - Zyra e Marketingut
 - Zyra e Marrëdhënieve me Publikun
 - Qendra e Edukimit fizik dhe Projekteve Sportive
- d. Dega e Financës dhe Buxhetit
- e. Sektori i Shërbimeve, Blerjeve dhe Mirëmbajtjes
- f. Dega Juridike
- g. Drejtoria e Projekteve, Investimeve dhe Aktiviteteve Shkencore
- h. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë
- i. Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit
- j. Qendra e Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Transparencës Administrative
- k. Sektori i Bibliotekave
- l. Njësi të tjera:
 - Qendra Kërkimore Shkencore
 - Shkolla e Masterit dhe Doktoratures
 - Qendra Life Long Learning

KREU III

ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE NË UNIVERSITET

Neni 11

Senati Akademik

1. Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është organ vendimmarrës kolegjal, i zgjedhur nga universiteti. Ai vendos për planifikimet strategjike dhe problemet më të rëndësishme të institucionit në fushën e mësim, të kërkimit shkencor dhe të organizimit administrativ e financiar. Senati akademik, përveç kompetencave të parashikuara në nenin 14, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:
 - a. Përcakton drejtimin akademik të universitetit dhe strategjinë afatgjatë të zhvillimit.
 - b. I propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës hapjen, mbylljen, ndryshimin dhe

emërtimin e njësive kryesore dhe programeve të studimit. Pasojat ekonomike përballohen nga universiteti deri në akordimin e buxhetit përkatës.

c. Miraton propozimet e këshillave të njësive kryesore për kuotat e pranimeve për çdo program studimi në universitet, tarifën e regjistrimit dhe i percjelle këto propozime në MASH.

d. Përcakton kritere të veçanta në përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar student në ciklin e parë, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve;

e. Përcakton kriteret e pranimit për kandidatë në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, sipas propozimeve të këshillave të fakulteteve, si dhe kuotat përkatëse ia propozon Ministrinë të Arsimit dhe Shkencës.

f. Miraton anëtarësimin e institucionit në organizata kombëtare e ndërkombëtare arsimore e shkencore, lidhjet e binjakëzimit me universitete e shkolla të tjera të larta të vendit e të huaja, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me organizma joqeveritare, donatorë vendas e të huaj që mund të ndihmojnë në zhvillimin e universitetit si dhe çdo marrëveshje që Rektori nënshkruan në emër të universitetit.

g. Miraton paraprakisht rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

h. Përcakton kriteret e shpërblimit për personelin akademik dhe administrativ ose të një pjese të tij, që është shquar në realizimin e një detyre të caktuar të një rëndësie të veçantë

i. Shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, vendimet e këshillit të fakultetit, kur bien ndesh strategjinë e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe me të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore.

j. Miraton krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme, si dhe projekte të tjera shërbimi që ofrohen nga fakultetet, bazuar në propozimin e këshillit të fakultetit përkatës.

k. Miraton kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e personelit akademik të ri efektiv, të ftuar, me kontratë me kohë të plotë apo të pjesshme.

l. Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës pas propozimit të rektorit.

2. Senati Akademik përbëhet nga anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, personelit jo akademik me kohë të plotë dhe studentë me kohë të plotë, të cilët zgjidhen drejtëpërdrejtë nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit.

a. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të personelit akademik, zgjidhen me shumicë votash nga fakultetet përkatëse. Çdo fakultet ka të paktën dy përfaqësues minimalisht me gradën shkencore "Doktor".

b. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të administratës dhe të studentëve zgjidhen përkatësisht nga administrata dhe studentët sipas një procedure të përcaktuar në Rregulloren e Zgjedhjeve. Përfaqësimi i studentëve duhet të jetë në çdo rast 15% e anëtarëve ndërsa i personelit administrativ jo më pak se 5 %.

c. Anëtarësia në Senatin Akademik është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të Këshillit të Administrimit.

d. Rektori i universitetit është Kryetar i Senatit Akademik.

3. Mandati i anëtarit të Senatit akademik mbaron kur:

a. Përfundon afati i mandatit.

b. Jep dorëheqjen ose del në pension.

c. Largohet nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ose humbet statusin e anëtarit me kohë të plotë, nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit

d. Vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin.

e. Kur nuk merr pjesë për 3 herë rradhazi, pa shkaqe të arsyeshme në mbledhjet e Senatit Akademik.

f. Kur shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statutit dhe rregullores, prish apo demton imazhin publik të institucionit, nuk respekton hierarkinë universitare.

g. Kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.

h. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve



gjatë votimit për anëtar të Senatit Akademik. Kur nuk ka tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të zgjedhur të tij.

5. Senati Akademik mbledhet në seanca të zakonshme të paktën dy herë në tre muaj. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari i Senatit Akademik dhe miratohet në çdo rast nga Senati Akademik.

a. Senati Akademik mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me një rend të caktuar me nismën e Rektorit ose me kërkesë me shkrim nga 50 % e anëtarëve.

b. Mbledhja e Senatit Akademik zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Senatit Akademik dhe drejtohet nga Kryetari i Senatit Akademik. Në raste të veçanta Kryetari i delegon të drejtën e drejtimit të mbledhjes së zakonshme Nënkryetarit.

c. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave (mbi 50%) të anëtarëve të Senatit Akademik të pranishëm në mbledhje.

d. Për çdo rast Senati Akademik vendos nëse votimi do të jetë i fshehtë apo i hapur. Mënyra e votimit të fshehtë mund të aplikohet në rastin e votimeve nominale dhe sa herë që kërkohet nga kryetari ose nga 1/2 e anëtarëve të Senatit Akademik të pranishëm në mbledhje.

e. Çdo anëtar e ushtron vetë të drejtën e votës, dhe nuk ka të drejtë ta delegojë atë.

f. Seancat e Senatit Akademik nuk janë publike, por në to mund të ftohen persona të jashtëm për konsultim me kërkesën e kryetarit. Procesverbalet e seancave të Senatit Akademik bëhen publike vetëm me vendim të Senatit Akademik. Vendimet e Senatit Akademik janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

g. Senati Akademik shprehet me vendime dhe për raste specifike me deklarata.

6. Senati Akademik me propozim të Kryetarit zgjedh nënkryetarin dhe sekretarin, si dhe miraton rregulloren e tij të brendshme me shumicë votash. Rektori, nënkryetari dhe sekretari përbëjnë Kryesinë e Senatit Akademik. Kryesia e Senatit Akademik kujdeset për krijimin e infrastrukturës së

domosdoshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të veprimtarisë së Senatit Akademik.

7. Përbërja dhe funksionimi i Senatit Akademik duhet të jetë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikëne Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 12

Këshilli i Administrimit

1. Këshilli i Administrimit është organ kolegjal vendimmarrës që mbikqyr dhe kontrollon veprimtarinë e universitetit që ka të bëjë me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij. Këshilli i administrimit, përveç kompetencave që parashikohen në nenin 16, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikëne Shqipërisë", i ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:

a. Miraton propozimet e rektoratit për tarifa të ndryshme dhe ia përcjell për miratim të mëtejshëm Senatit Akademik.

b. Miraton masen e honorareve për personelin akademik të ftuar dhe me kontrate, vendas dhe të huaj të angazhuar në mesimdhënie dhe të përcjell për miratim të mëtejshëm rektoratit.

c. Miraton shpërblimin e komisioneve të krijuara nga Senati Akademik dhe Rektori me propozimin e këtyre të fundit.

d. Informon Senatit Akademik dhe Rektori për situatën financiare dhe projektet përkatëse për të gjithë Universitetin.

2. Këshilli i Administrimit përbëhet nga:

a. Një përfaqësues i personelit akademik me kohe të plotë për çdo njësi kryesore.

a. Një anëtar përfaqësues i zgjedhur nga Këshilli i Studentëve.

b. Një më pak se gjysma e anëtarëve të KADM-it, janë përfaqësues të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit zgjidhen nga njësitë përkatëse me votim të fshehtë në përputhje me rregulloren e zgjedhjeve. Anëtarësia në Këshillin e Administrimit është e papajtueshme me



detyrën e anëtarit të Senatit Akademik, të zëvendësrektorit, dekanit, zëvendësdekanit.

4. Mandati i anëtarit të Këshillit të administrimit mbaron kur:

a. Përfundon afati i mandatit.

b. Jep dorëheqjen ose del në pension.

c. Largohet nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ose humbet statusin e anëtarit me kohë të plotë, nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit, për ata që janë të zgjedhur sipas pikës 4, shkronjat "a" dhe "c", të nenit 16, të ligjit nr. 9741, date 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

d. vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin.

e. Kur nuk merr pjesë, për 3 herë rradhazi, pa shkaqe të arsyeshme, në mbledhjet e këshillit të administrimit.

f. Për ata që janë të emëruar sipas pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5.

2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", kur lirohen me akt të

Ministrit dhe në këtë rast Ministri detyrohet të njoftojë Rektorin 15 ditë përpara se emërimi i ri të hyjë në fuqi.

g. Kur shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statutit dhe rregullores, prish apo demton imazhin publik të institucionit, nuk respekton hierarkinë universitare.

h. Kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.

i. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Përveç rasteve të përgjithshme sipas ligjit e këtij Statuti, mandati i anëtarit të zgjedhur, mbaron me rivotim të kërkuar nga KADM-i, kur në ushtrimin e funksionit të anëtarit, shkel rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat e brendshme të këshillit ose pa shkak e në mënyrë të përsëritur nuk ka realizuar detyrat e ngarkuara nga KADM-i.

6. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për anëtar të KADM-it. Kur nuk ka tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të zgjedhur të tij.

7. Anëtarët e KADM-it të emëruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, shkarkohen prej tij.

8. Këshilli i Administrimit mbledhet në seanca të zakonshme të paktën dy herë në tre muaj.

Në mbledhjen e tij të parë Këshilli i Administrimit zgjedh kryetarin e tij dhe vendos mënyrën e organizimit. Këshilli i Administrimit mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme kur kjo kërkohet nga 1/2 e anëtarëve të tij. Rendi i ditës, pjesmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e universitetit dhe në rregulloren e brendshme të Këshillit të Administrimit.

9. Këshilli i Administrimit shprehet me vendime dhe paraqet relacione për raste specifike.

Neni 13

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjal i cili diskuton probleme të etikës së jetës akademike dhe i paraqet propozime Rektorit për këto çështje.

2. Anëtarët e këshillit të etikës përzgjidhen nga Senati akademik, pas paraqitjes nga Rektori të propozimeve të këshillava të fakulteteve. Këshilli i etikës përbëhet nga 5 anëtarë të cilët zgjedhin kryetarin me votim të fshehtë. Në çdo rast 2/3 e anëtarëve të Senatit Akademik mund të kërkojë votëbesimin për çdo anëtar të Këshillit të Etikës.

3. Këshilli i Etikës i propozon Senatit Akademik Kodin e Etikës së universitetit.

4. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në rregulloren e universitetit.

5. Këshilli i etikës ka të drejtë t'i propozojë Rektorit masa konkrete mbi punonjësit e universitetit të cilët thyejnë normat e etikës që pasqyrohen në kodin e etikës.

Neni 14

Këshilli i Profesorëve

1. Këshilli i Profesorëve në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë ngrihet në nivel institucioni nëse njësitë kryesore nuk

përbushin numrin e nevojshëm të profesorëve me kohë të plotë. Këshilli i Profesorëve organizon dhe drejton studimet e doktoratës dhe kualifikimin shkencor pedagogjik pas doktoratës.

2. Këshilli i Profesorëve përbëhet nga të gjithë profesorët, me kohë të plotë, të universitetit. Numri minimal i anëtarëve të KP-së duhet të jetë shtatë veta, nga të cilët, së paku, pesë janë "Profesorë". Një ose dy anëtarë të KP-së janë "Profesor i Asociuar", të punësuar me kohë të plotë, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, që janë në prag të promovimit për titullin "Profesor". Në rast se numri i profesorëve të universitetit është më i vogël se pesë, për të arritur këtë numër në KP mund të thirren profesorë nga universitete të tjera brenda ose jashtë vendit. Propozimi për kandidatët që ftohen të bëhen anëtarë të KP, bëhet nga Rektorati dhe miratohet nga Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

3. Kompetencat e Këshillit të Profesorëve përcaktohen në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Profesorëve dhe procedurat e promovimit në Universitetin 'Ismail Qemali' Vlorë".

Neni 15

Këshilli i Fakultetit

1. Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, që programon, përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. Ai propozon programe të reja studimi ose kërkimi shkencor, për hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësive të tjera, merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij, shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor.

2. Këshilli i Fakultetit është një organ i zgjedhur, i cili vendos për problemet më të rëndësishme në fushën e mësimin, kërkimit shkencor dhe shërbimeve dhe i propozon Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikqyr zbatimin e

tij. Këshilli i Fakultetit shqyrton dhe miraton në një mbledhje të hapur për personelin akademik, administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të fakultetit.

3. Këshilli i Fakultetit përbëhet prej përfaqësuesve të personelit akademik me kohë të plotë, personelit joakademik me kohë të plotë dhe të studentëve me kohë të plotë, të zgjedhur nga departamentet dhe njësitë e tjera strukturore të fakultetit. Përbërja e Këshillit të Fakultetit, përfaqësitë e kategorive të ndryshme dhe mënyra e zgjedhjes përcaktohen në rregulloren e zgjedhjeve dhe në dispozitat e veçanta për zgjedhjet në universitet. Përfaqësimi i studentëve bëhet sipas rregulloreve të zgjedhjeve.

4. Mandati i Këshillit të Fakultetit është 4-vjeçar. Mandati i anëtarit të këshillit dhe përfundimi i tij është i njëjtë sipas rasteve të parashikuara për mandatin e anëtarit të Senatit Akademik në këtë Statut. Këshilli i Fakultetit kryen veprimtarinë e tij në përputhje me rregulloret e brendshme përkatëse ku përcaktohen mënyrat e mbledhjes, votimi e gjithçka tjetër që ka të bëjë me to.

5. Këshilli i Fakultetit, përveç kompetencave, që parashikohen në nenin 18, të ligjit nr. 9741, datë 21. 5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:

a. Miraton rregulloren e fakultetit

b. Propozon, për miratim në Senat, strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet.

c. Miraton në parim marrëveshjet që synon të lidhë fakulteti i tyre me të tretë, përpara se të nënshkruhen nga dekani të cilat me tej duhet të marrin edhe nënshkrimin e rektorit, i cili përfaqëson universitetin në marrëdhënie me të tretët.

d. Shpall projektet fituese, për t'u financuar nga fondet për kërkim shkencor nga buxheti i fakultetit, si dhe bursat për studime apo kërkime shkencore, që administrohen nga vetë fakulteti.



e. Propozon listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti, si dhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e fakultetit.

f. Miraton mënyrën e përdorimit të dhurimeve që janë kryer në favor të një departamenti, duke marrë parasysh propozimin e departamentit përfitues.

g. Ushtron edhe kompetenca të tjera që përcaktohen në rregulloren e universitetit apo të fakultetit, bazuar në specifikën e secilit fakultet.

6. Këshilli i Fakultetit shprehet me vendime.

Neni 16 Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv dhe përbëhet nga:

- a. Rektori
- b. Zëvendësrektorët
- c. Dekanët
- d. Kancelari

2. Rektorati, përveç misionit, të drejtave dhe detyrave, që përcaktohen në nenin 15, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:

a. Ofron infrastrukturën e nevojshme dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e funksionimit të organeve drejtuese të universitetit.

b. Ushtron kontrolle tematike, të organizuara dhe të njoftuara me parë, në njësitë e universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të universitetit.

c. Jep opinionin e tij kur kjo kërkohet nga rektori, për çështje të ndryshme të universitetit, sipas kompetencave që ligji i njej rektorit.

3. Administrata e rektoratit dhe universitetit organizohet dhe funksionon në përputhje me detyrat dhe objektivat e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë.

Neni 17 Rektori

1. Rektori është autoriteti drejtues i Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë

2. Rektori zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë dhe emërohet me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

3. Rektori, përveç kompetencave që ushtron si drejtues i Rektoratit, siç përcaktohet në nenin 15, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", ushtron edhe këto kompetenca:

a. Drejton dhe përfaqëson Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë.

b. Siguron zbatimin e vendimeve, masave dhe kërkesave të Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit.

c. Paraqet propozimet për aktet që janë në kompetencë për t'u shqyrtuar nga Senati akademik, Këshilli i Administrimit apo Këshilli i Etikës;

d. Kryeson mbledhjet e Senatit Akademik dhe përfaqëson Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë në marrëdhënie me organet e institucionet shtetëror dhe të tretët.

e. I kërkon informacion Këshillit të Administrimit për çështje të kompetencës së tij.

f. Shfuqizon, kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit, aktet e të gjithë autoriteteve drejtuese të intitucionit kur bien ndesh me legjislacionin në fuqi, me Kodin e Punës në RSH, me këtë Statut dhe Rregulloren e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.

g. Miraton emërimet, caktimet apo komandimet e dekanit për përgjegjësin e një njësie bazë në të cilën nuk janë zhvilluar zgjedhje për këtë autoritet drejtues.

h. Miraton në përputhje me strukturën e miratuar nga Këshilli i Administrimit shpërndarjen e detajuar nominale të punonjësve për administratën dhe njësitë përbërëse të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë.

i. Urdhëron angazhimin e personelit të administratës dhe njërive përbërëse të universitetit në detyra të tjera të përkohshme në raste të zëvendësimit të personelit të larguar nga puna, të atyre me paaftësi të përkohshme në punë, leje lindje, apo raste të ngjashme si dhe lëvizje të tjera



brenda administratës dhe njësisive bazë dhe kryesore.

j. Nënshkruan kontratat e punës për të gjithë personelin në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

k. Nënshkruan kontratat kolektive të punës me organizatat sindikale.

l. Nënshkruan diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, pa të drejtë për ta deleguar nënshkrimin.

m. Zgjidh çështjet e kompetencës mes organeve dhe drejtuesve të njësisive, përveç atyre mes Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit.

n. Zgjidh mosmarrëveshjet në fushën akademike midis dy dekanëve dhe midis dekanit dhe përgjegjësit të departamentit.

o. Organizon ose ushtron kontrolle në fakultete, për cilësinë dhe çdo aspekt të procesit të mësimdhënies, administrimit e buxhetit, kërkimin shkencor, si dhe çdo çështje tjetër që kanë në kompetencë këto të fundit, kur ky kontroll nuk është në kompetencë të organeve kolegjiale.

p. Ngre komisione e grupe pune për çështje, studime dhe veprimtari të veçanta.

q. Është autoriteti i vetëm kontraktues për Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, me përjashtim të rasteve kur me rregulloret përkatëse kjo kompetencë u është lënë dekanëve të fakulteteve apo kancelarit me autorizim.

r. Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

s. Përcakton fushën e veprimit të zëvendësrektorëve dhe bën ndryshimin e tyre kur e gjen të nevojshme për nevoja të institucionit në rastet dhe mënyrën e parashikuar në kete statut dhe rregulloren e universitetit.

4. Mandati i Rektorit mbaron kur:

a. Përfundon afati i mandatit.

b. Jep dorëheqjen ose del në pension.

c. Vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin.

d. Kur shkarkohet nga Presidenti i Republikës si në rastin e parashikuar në pikën 3, të nenit 64, të ligjit nr. 9741, datë

21. 5. 2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".

e. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Rekrori në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me vendime, urdhra dhe udhëzime.

Neni 18

Zëvendësrektorët

1. Zëvendësrektori është një nga autoritetet e tjera të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Zëvendësrektori emërohet dhe shkarkohet nga rektori pas miratimit të kandidaturës së propozuar prej tij në Senatin Akademik.

2. Kriteret për tu emëruar zëvendësrektor dhe detyrat:

a. Zëvendësrektori duhet të ketë të paktën titullin "Profesor i Asociuar", nëse nuk ka kandidatë që plotësojnë këtë kriter, atëherë mund të perzgjidhet edhe me gradën "Doktor i Shkencave" vetëm për një periudhë njëvjecare.

b. Zëvendësrektori kryen detyrat e përcaktuara në statut dhe rregullore, si edhe të gjitha kompetencat e deleguara nga Rektorit.

c. Në rastin kur ka më shumë se një zëvendësrektor fusha e kompetencës e secilit përcaktohet në rregullore.

d. Marrëdhëniet e zëvendësrektorit me autoritetet drejtuese dhe organet e tjera në Universitet përcaktohen në rregulloren e universitetit.

e. Përcjell urdhërat e Rektorit tek dekanet dhe kontrollon ecurinë e punës në njësitë kryesore.

3. Zëvendësrektori largohet nga detyra kur:

a. Përfundon afati i mandatit.

b. Jep dorëheqjen ose del në pension.

c. Kur largohet me propozim të rektorit dhe miratohet në Senatin Akademik.

d. Vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrisë funksionin.

e. Përfundon afati njëvjecar pas miratimit, për rastet kur ai është Dr. i Shkencave dhe është emëruar sipas pikes 2.a të këtij neni.

- f. Kur largohet nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlore ose humbet statusin e anëtarit akademik me kohë të plotë.
- g. Kur konkludohet paaftësi për kryerjen e detyrave.
- h. Kur shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statutit dhe rregullores, prish apo demton imazhin publik të institucionit, nuk respekton hierarkinë universitare.
- i. Kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.
- j. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 19 Kancelari

- 1. Kancelari i universitetit është një nga autoritetet e tjera të universitetit, përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për mbikqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare si dhe zbatimin e ligjshmërisë në universitet.
- 2. Kandidatura për kancelar përzgjidhet nëpërmjet konkursit të hapur nga Këshilli i Administrimit sipas dispozitave ligjore në fuqi. Rektori ia paraqet kandidaturën e përzgjedhur Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për miratim. Kancelari emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Kancelari duhet të ketë formim të lartë ekonomik apo juridik dhe së paku 5 vjet përvojë pune.
- 3. Kancelari i universitetit përgjigjet përpara Senatit Akademik, Këshillit të Administrimit, institucioneve qëndrore dhe organeve shtetërore të kontrollit, për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën ekonomiko-financiare.
- 4. Kancelari përveç kompetencave siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore ushtron dhe këto kompetenca:
 - a. Përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të universitetit, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Këshillit të Administrimit.
 - b. Është titullar i entit prokurues.
 - c. I paraqet aktet me natyrë ekonomike dhe financiare për miratim në Këshillin e

- Administrimit dhe për mendim paraprak në Senatit akademik, kur është e nevojshme.
- d. Propozon studimet për zhvillimin perspektiv të universitetit.
- e. Përfaqëson Universitetin e Vlorës si firmë e parë e deleguar nga Rektori në marrëdhënie financiare me Bankën e Shtetit Shqiptar dhe në marrëdhëniet kontraktore me të tretët, brenda përshkrimit të tij të punës.
- 5. Kancelari nuk mund të ushtroje asnjë funksion tjetër akademik apo administrativ.
- 6. Kancelari shkarkohet nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me iniciativën e vet, me propozimin e KADM-it ose të Rektorit.
- 7. Marrëdhëniet e kancelarit me autoritetet dhe organet e tjera drejtuese në Rektorat të Universitetit, si dhe detyra të tjera që mund t'i delegohen, përcaktohen në rregulloren e Universitetit.

Neni 20 Dekani

- 1. Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit. Ai zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore dhe emërohet nga Rektori.
- 2. Dekani i fakultetit, veç pozitës juridike që përcaktohet për të, në paragrafin e dytë, të nenit 20, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ushtron edhe këto kompetenca:
 - a. Për çdo vendimmarrje të Këshillit të Fakultetit përgatit propozimin përkatës.
 - b. Përgjigjet para këshillit të fakultetit për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;
 - c. Përgjigjet në rektorat për gjithë ecurinë e punës në fakultet dhe siguron zbatimin e vendimeve dhe urdhërave të Rektorit ose zëvendësrektorit.
- 3. Detyra dhe kompetenca të tjera të dekanit përcaktohen në rregulloren e universitetit.
- 4. Mandati i dekanit të fakultetit mbaron kur:
 - a. Përfundon afati i mandatit.
 - b. Jep dorëheqjen ose del në pension.



- c. Vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin.
 - d. Kur pezullohet nga Rektori sipas nenit 64, pikës 4 e ligjit nr. 9741, datë 21. 05. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe shkarkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
 - e. Kur shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statutit dhe rregullores, prish apo demton imazhin publik të institucionit, nuk respekton hierarkinë universitare dhe pezullohet nga Rektori si në piken 4.d të këtij neni.
 - f. Kur largohet nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlore ose humbet statusin e anëtarit akademik me kohë të plotë.
 - g. Kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.
 - h. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.
5. Në ushtrim të kompetencave të tij, shprehet me vendime, urdhra dhe udhëzime.

Neni 21 Zëvendësdekani

1. Zëvendësdekani, emërohet siç përcaktohet në pikën 5, të nenit 22, të ligjit nr.9741, date 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe duhet të plotësojë këto kritere:
- a. të jetë lektor i një lënde dhe në marrëdhënie pune me afat të pacaktuar në atë fakultet;
 - b. nëse nuk ka me tituj dhe grada, të ketë kryer, të paktën studimet universitare të nivelit "Master".
2. Zëvendësdekani ka pozitën juridike, siç përcaktohet në nenin 34, të Kodit të Procedurave Administrative. Fusha e kompetencës e secilit zëvendësdekan, aty ku janë emëruar më shumë se një, përcaktohet me urdhër të dekanit.

Neni 22 Përgjegjësi i departamentit

1. Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë për departamentin. Ai zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë

personeli akademik respektiv, sipas procedurave dhe kriterëve akademike të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve dhe emërohet nga dekan.

2. Kompetencat e përgjegjësit të departamentit janë si më poshtë:

- a. Ndjek zbatimin e programeve mësimore;
 - b. Evidenton aktivitetin shkencor të secilit anëtar të departamentit. Dokumentacioni përkatës vihet në dispozicion të departamentit;
 - c. I propozon dekanit masat për shkeljet eventuale të disiplinës në punë;
 - d. Harton dhe i paraqet këshillit të fakultetit për miratim programet mësimore;
 - e. I propozon këshillit të fakultetit organizimin e grupeve mësimore dhe kërkimore;
 - f. Organizon përzgjedhjen me konkurim dhe i propozon dekanit emërimin e titullarëve të grupeve mësimore e kërkimore;
 - g. Funksionet më të hollësishme të përgjegjësit të departamentit, trajtohen në rregulloren e fakultetit ose njësisë kryesore.
3. Përgjegjësi i departamentit largohet nga detyra:

- a. Përfundon afati i mandatit.
 - b. Jep dorëheqjen ose del ne pension
 - c. Vdes, bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin.
 - d. Kur pezullohet nga dekan sipas nenit 64, pikës 5 e ligjit nr. 9741, datë 21. 05. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe shkarkohet nga Rektori.
 - e. Kur shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statutit dhe rregullores, prish apo demton imazhin publik të institucionit, nuk respekton hierarkinë universitare dhe pezullohet nga dekan si në piken 3.d të këtij neni.
 - f. Kur largohet nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlore ose humbet statusin e anëtarit akademik me kohë të plotë.
 - g. Kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.
 - h. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.
4. Deri në zgjedhjen dhe emërimin e përgjegjësit të ri, funksionet dhe kompetencat e tij me urdhër të dekanit dhe



me miratim te rektorit i caktohen njërit nga anëtarëve të departamentit.

5. Pozita juridike e përgjegjësit të departamentit, marrëdhëniet e tij me pedagogët e departamentit, me organet e tjera në fakultet, si dhe me të tretët, përcaktohen në rregulloren e institucionit.

KREU IV ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 23 **Studimet universitare**

1. Në Universitetin e Vlorës studimet ndiqen në këto forma studimi:

- a. studime me kohë të plotë;
- b. studime me kohë të pjesëshme;

2. Programet e studimeve propozohen nga departamentet e fakulteteve dhe Këshilli i Fakultetit dhe i paraqiten për miratim Senatit Akademik. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton hapjen e programeve të studimit. Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës shpall publikisht programet e studimeve që ofron, para fillimit të aplikimeve për pranime në të.

Neni 24 **Ciklet dhe titujt e studimeve universitare**

1. Programet e studimeve në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme:

- a. cikli i parë,
- b. cikli i dytë,
- c. cikli i tretë.

2. **Programet e studimeve të ciklit të parë** synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjerë profesionesh e specialitetesh, realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) (më tej: kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike ndërsa në sistemin me kohë të pjesëshme është jo më pak se katër vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.

3. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, programet e studimeve të ciklit të parë

konceptohen në radhë të parë nga departamentet e fakulteteve duke respektuar dhe kërkesat e dispozitave ligjore dhe nënligjore. Departamentet hartojnë programe studimore për çdo lëndë që përfshihet në sferën e departamentit. Projekt-programet e përgatitura nga departamentet duhet të respektojnë standartet e kërkuara.

4. Propozimet e departamenteve, shqyrtohen dhe marrin një miratim paraprak në Këshillin e Fakultetit. Këshilli i Fakultetit shqyrton në veçanti justifikimin e departamenteve për numrin e krediteve të propozuara për çdo lëndë. Këshilli i Fakultetit mund të rikthejë propozimin për përpunim të mëtejshëm në departamente. Orientimet e Këshillit të Fakultetit në këtë rast janë të detyrueshme për departamentin. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të programeve brenda fakultetit, Këshilli i Fakultetit, përmes Dekanit, ia dërgon programin për miratim Senatit Akademik. Senati Akademik mund ta kthejë programin e propozuar pranë fakultetit propozues për rishikim të mëtejshëm. Orientimet e Senatit Akademik janë të detyrueshme për fakultetin në këtë rast.

5. Kanë të drejtë për t'u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, kandidatet që plotesojnë kriteret e mëposhtme:

- a. shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore;
- b. studentët shqiptarë që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj, që kanë dhënë provimet me zgjedhje;
- c. shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Brenda muajit janar të çdo viti, krahas propozimit të justifikuar për kuotat e pranimit, secili Fakultet përgatit edhe propozimin për kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kriteret bëhen publikisht të njohura nga UV-ja, të paktën një vit para fillimit të pranimeve të rradhës në institucion, së bashku me



informacionin e nevojshëm mbi fakultetin përkatës dhe programet që ofron.

7. Programet e studimeve të ciklit të dytë japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushëbrenda një specialiteti. Ato janë programe të studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" dhe "Master Profesional".

8. Rregulla dhe specifika të këtyre programeve janë:

a. Programet e studimeve "Master i shkencave" ose "Master i artevetë bukura" realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kreditepër projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale etyre është 2 vite akademike. Studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare për nivelin e miratuar nga Senati Akademik. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave"ose "Master i arteve të bukura" në fushën e arsimimit të kryer.

b. Programet e studimeve "Master profesional" ofrojnë arsimim dhe trajnim të mirëfilltë professional dhe realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik. Studentët e këtij program studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare për nivelin e miratuar nga Senati Akademik. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare "Master profesional" në fushën e arsimimit e të trajnimit profesional të kryer.

c. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë kandidatë që kanë fituar diplomë "Master profesional" mund të pranohen në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare "Master i shkencave" ose "Master i arteve të bukura", vetëm nëse plotësojnë kriteret e vendosura për këto raste.

9. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që:

a. Kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe të zotërojnë një diplomë

te këtij cikli ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të.

b. Kane rezultate të mira në studimet e ciklit të parë

c. Plotësojnë standardet akademike të kriterëve specifike të pranimit per cdo program.

10. Kriteret specifike e pranimit per cdo program studimi te ciklit te dyte e pranimit përcaktohen në Rregulloret e Fakulteteve.

11. Programet e ciklit të tretë janë studime të doktoratës dhe janë programe studimi me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarura.

12. Në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i shkencave"ose "Master i arteve të bukura" apo diploma ekuivalente me to dhe zgjasin të paktën 3 vite dhe përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara teorike.

13. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, në bazë të rezultateve të arritura në studimet e organizuara teorike, vendos kriteret klasifikimi për kandidatët që kanë të drejtë të zhvillojnë projektin kërkimor dhe të përgatisin tezën e doktorates dhe përcakton standarde e kriteret kualifikuese për njohjen e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, si dhe metoda për vlerësimin e nivelit teorik tëpërgjithshëm të kandidatëve. Kandidatët, që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të vazhduar më tej studimet e doktoratës dhe pajisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditet e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre.

14. Organizimi dhe funksionimi i programeve të studimeve të doktoratës, përcaktohet me rregullore të veçantë të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

15. Në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor"(Dr).

16. Kriteret bazë të përzgjedhjes së kandidatëve në studimet e ciklit të tretë janë:

a. Të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave", ose cdo diplomë tjetër të vlerësuar të barazvlefshme me të, në fushën e programit të doktoratës apo në një fushë të përafërt të përcaktuar më parë në rregulloren e programit përkatës të doktoratës". Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të njohura dhe të njëjsuara nga organet kompetente.

b. Të ketë notë mesatare të paktën 8 (tetë) në cdo diplomë që zotëron (kjo është e domosdoshme dhe për diplomat e universiteteve të huaja për të cilat është bërë njësimi i saj dhe i rezultateve të edukimit). Këshilli i Profesorëve ka të drejtën të vendosi kritere të tjera të mesatares (ose më të ulët ose më të lartë) në varësi të programit të doktoratës duke konsideruar prioritarë kandidatët që janë anëtarë të personelit akademik të institucionit

c. të ketë dëshmi zotërimi të njëres prej gjuhëve të huaja anglisht, frëngjisht, italisht ose gjermanisht lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ne Universitetin e Tiranës, apo të ketë dëshmi të gjuhëve të huaja të mësipërme mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

d. Të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

e. Kriteret e tjera specifike siç janë të përcaktuara në programet e studimit të doktoratës të miratuara nga Agjencia e Akreditimit të MASH, apo të miratuara nga Këshilli i Profesorëve.

Neni 25

Pranimi në ciklet e studimeve

1. Çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës.

2. Ciklin e parë të studimeve në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës mund ta ndjekin edhe studentë të huaj kundrejt pagimit të tarifës së caktuar.

3. Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës ka të drejtë të përcaktojë kritere të veçanta për

përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kritere bëhen publikisht të njohura nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion, së bashku me informacione nevojshëm mbi fakultetin përkatës dhe programet që ofron.

4. Kriteret të tjera dhe standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në rregulloret e fakulteteve.

Neni 26

Sekretaria mësimore dhe regjistri themeltar

1. Sekretaritë mësimore të fakulteteve dhe departamenteve duhet të mbajnë regjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore.

2. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore e çdo fakulteti apo departamenti përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë) të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Regjistri themeltar pl otësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye.

3. Në sekretarinë mësimore depozitohen të firmosura nga anëtarët e personelit akademik ne kohen e duhur lista e studenteve te regjistruar ne kursin perkates e ndare ne leksione dhe seminare me informacionin per mungesat si dhe proces-verbalet e vleresimeve ne provimet e pjesshme dhe perfundimtare te kurseve dhe cdo informacion tjetër që kerkohet për të konfirmuar realizimin e procesit të mesimdhënies, i firmosur ky i fundit nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit.



4. Çdo studenti me regjistrimin fillestar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, i jepet një numër unik matrikullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, duke respektuar edhe udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Neni 27

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës zhvillohen me bazë vitin akademik i cili organizohet në tre semestra:

- a. Semestri i Vjeshtës,
- b. Semestri i Pranverës,
- c. Semestri i Verës.

3. Semestri i Verës organizohet për t'u krijuar mundësi studentëve të rijapin provimet e cdo lënde në të cilat rezultojnë ngelës. Regjistrimi i studentëve në kurset semestrit të verës bëhet vetëm nëpërmjet Sistemit të Manaxhimit të Informacionit Univlora. Cdo student mund të regjistrohet në kurset e lëndëve në të cilat rezulton ngelës, por numri i krediteve që mund të marre është i kufizuar dhe në total nuk duhet të jete me shume se 40 (dyzet). Keto kurse zgjatën të paktën tre javë dhe organizohen në formën konsultimeve ose leksioneve të permbledhura të mirëpërcaktuara në syllabus.

4. Për kurset e Semestrit të Verës mund të aplikohen tarifa mbi bazë të numrit të krediteve të regjistruara, pasi këto tarifa janë aprovuar më parë. Çdo fakultet dhe departament jo me vonë se dy javë para fillimit të semestrit të verës, duhet të shpallë orarin e kurseve të këtij semestri. Orët mesimore të realizuara në këtë semestër nga cdo pedagog përlogariten si pjesë e ngarkesës mësimore vjetore.

5. Fillimi i vitit akademik shpallet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Organizimi i vitit akademik, datat fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga rektori në fillim të vitit akademik.

Neni 28

Transferimet e studimeve

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë, si dhe transferime nga një formë studimi në një formë tjetër. Këto transferime bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e vendosura. Të gjitha transferimet miratohen nga rektori.

2. Për procedurat e ripranimeve, transferimeve dhe regjistrimeve në programe të dyta studimi, me vendim të rektoratit ngrihet komisioni përkates i përhershëm në nivel institucioni. Në çdo departament, me urdhër të dekanit ngrihen komisionet e ekuivalentimit dhe vleresimit të cilat miratohen prej tij.

3. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka të drejtë t'i mohojë të drejtën për transferim çdo student i mbi kriteret akademike. Procedurat transferuese përfundojnë përpara fillimit të vitit akademik.

4. Të drejtën për transferime studimesh e kanë studentët që kanë siguruar të paktën 30 kredite.

5. Të gjitha llojet e transferimeve bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit duke plotësuar një formular tip. Ky formular publikohet në faqen zyrtare të universitetit së bashku me informacionin e nevojshëm. Kërkesat për transferime pranohen dhe administrohen në Zyrën e Marrëdhënieve me Studentet gjatë gjithë vitit akademik deri në 10 Shtator të çdo viti, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga aktet e tjera nenligjore. Më tej, këto kërkesa l përcillen Zyrës Akademike.

Neni 29

Transferimi për në institucione të tjera të arsimit të lartë

1. Kërkesat e studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të cilët duan të transferohen në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën program dhe sistem, nëpërmjet



zyrës akademike i përcillet rektoratit jo më vonë se data 15 Shtator e çdo viti. Propozimet u përcillen universiteteve përkatëse shoqëruar me dokumentacionet e nevojshëm për vlerësim.

2. Pas përgjigjes së pranimit nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit që përmban: detyrimet e shlyera me notat përkatëse, dëftesa e shkollës së mesme, dokumentacioni i bursës, etj. Studenti i transferuar humb statusin e studentit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

3. Vendimi i transferimit i përcillet nga rektorati zyrës akademike, zyrës së regjistrimit, sekretarive mesimore dhe Drejtorisë së IT-së për kryerjen e gjithë veprimeve procedurale të mëtejshme.

Neni 30

Transferimi nga institucionet e tjera të arsimit të lartë dhe brenda vetë universitetit

1. Kërkesat dhe dokumentacionin e studentëve që duan të transferohen në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, zyra akademike ua përcjelle fakulteteve përkatëse jo më vonë se data 15 Shtator e çdo viti. Komisioni i ekuivalentimit, i ngritur pranë çdo departamenti, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, nëse pranohet në atë program studimi, sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë.

2. Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit brenda 3 ditëve i përcjellë dekanit të fakultetit listën e studentëve të propozuar që plotësojnë kriteret e transferimit. Dekani i përcjell këtë listë zyrës akademike dhe për dijeni rektorit.

3. Zyra akademike administron gjithë propozimet e njëjësive kryesore dhe i përcjellë ato brenda datës 20 Shtator pranë komisionit përkatës të ripranimeve, transferimeve dhe regjistrimeve në programe të dyta studimi, i cili pas shqyrtimit i dërgon propozimet rektorit.

4. Vendimin për pranimin e studentëve të propozuar për transferim e merr rektori duke patur parasysh mundësitë e kapacitetin e programit dhe ciklit të studimit sipas kuotave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave si dhe rezultatin e ekuivalentimit.

5. Studentët që kanë kryer një pjesë të studimeve në institucione të huaja të arsimit të lartë, mund të transferohen në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në kërkesën e tyre dhe dokumentacionin që paraqesin. Pasi bëhet verifikimi për saktësinë e dokumentacionit, komisioni i ekuivalentimit përcakton detyrimet, nëse studenti pranohet. Procedurat e mëtejshme janë të njëjta si në rastin e studentëve që kërkojnë transferim nga universitetet brenda vendit.

6. Vendimi i transferimit i përcillet nga rektorati Zyres Akademike, Zyrës së Regjistrimit, sekretarive mesimore dhe Drejtorisë së IT-së për kryerjen e gjithë veprimeve procedurale të mëtejshme.

7. Transferimet e studentëve brenda vetë institucionit mund të bëhen vetëm për programe të përafërta studimi. Për këto transferime ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e studentëve që kërkojnë transferim nga universitetet brenda vendit, duke patur parasysh mundësitë dhe kapacitetin e programit dhe ciklit të studimit sipas kuotave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave si dhe rezultatin e ekuivalentimit.

8. Të gjitha transferimet bëhen sipas akteve ligjore dhe nenligjore të miratuara nga MASH.

Neni 31

Ndjekja e një programi të dytë studimi.

1. Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast si rregull përzgjidhen kandidatët, të cilët kanë mesatare më të lartë. Kandidatët që pranohen në një program të dytë studimi përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer sipas kriterëve dhe procedurave që parashikon ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në



Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Kuotat e pranimit dhe tarifa e shkollimit për programet e dyta të studimit përcaktohen me vendim të Keshillit të Ministrave. Kriteria specifike për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në rregulloret e fakulteteve.

Neni 32

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve

1. Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës mund të bëjë ekuivalentim të pjesëve ose programesh të plota studimi ose diploma të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja. Ekuivalentimi realizohet nga një komision ad-hoc i ngritur në njësinë përkatëse. Ky komision shqyrton rastet kur studenti kandidon për transferim programi studimi në vite të ndërmjetme, kur pranohet në program të dytë studimi ose kur i kërkohet nga MASH-i në kuadër të procedurave të njohjes së diplomave të huaja.

2. Proçedurat dhe kërkesat për ekuivalentim përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

Neni 33

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik me tituj i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë përpërparimin e tij akademik, pas miratimit të keshillit të Fakultetit të njësisë kryesore. Autoritetet drejtuese në universitet nuk kanë të drejtë për vit sabatik gjatë kohës së ushtrimit të mandatit si drejtues, i zgjedhur apo i emëruar. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti dhe kurse specializimi deri tremujore jashtë institucionit.

2. Midis të interesuarit dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë nënshkruhet një kontratë e posaçme.

Neni 34

Vlerësimi

1. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët për kalim është 5 (pesë). Në listën e notave që shoqërojnë diplomën pasqyrohen vetëm notat përfundimtare kaluese ≥ 5 të çdo lënde.

2. Mesatarja e studentit llogaritet si mesatare e ponderuar. Shuma e produkteve të notave përfundimtare me kreditet përkatëse të lëndës pjestohet me totalin e kredive. Universiteti "Ismail Qemali" akordon për studentët në përfundim të studimeve titujt e nderit në tre nivele në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:

- a. 8.00-8.89, cum laude
- b. 8.90-9.39, magna cum laude
- c. 9.40-10.00, summa cum laude

Këta tituj lëshohen së bashku me diplomën universitare të fituar nga studenti.

3. Një student me mesatare 10 (dhjetë) dekorohet nga Senati Akademik me "Medalje të Artë".

4. Lëshimi i një diplome me tituj nderi nga universiteti do të bazohet vetëm në kredite të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës ose studenti duhet të ketë fituar të paktën 110 kredite në Universitetin "Ismail Qemali" e Vlorës në mënyrë që të jetë i zgjedhshëm për të tillë tituj nderi. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni të përgjithshme për të gjithë fakultetet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratit, administratës e studentëve.

Neni 35

Detyrimet dhe të drejtat e studentëve

1. Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe e humbet me marrjen e diplomës ose çertifikatës përkatëse si edhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij.

2. Studentët janë të detyruar:

- a. Të zbatojnë rregullat e hartuara ne statut dhe rregullore;
 - b. Të ndjekin kurset e plota të leksioneve, seminareve, laboratoreve, praktikave mësimore, etj sipas syllabus-it të pedagogut;
 - c. T'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në të gjitha veprimtaritë akademike;
 - d. Të paguajnë tarifën e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofrojnë institucioni brenda afateve;
 - e. Të respektojnë kodin e etikës, dhe rregulloren e univerisitetit;
 - f. Të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë.
3. Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre. Për çdo shkelje nga ana e studenteve në rregulloren e institucionit përcaktohen masat disiplinore.
4. Studentët kanë këto të drejta:
1. Të përfaqësohen në Këshillat e Fakulteteve, në Këshillin e Administrimit dhe në Senatin Akademik;
 2. Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli I Ministrave si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga universiteti;
 3. Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit;
 4. Të ndjekin një degë të dytë studimesh kur plotësojnë kushtet akademike;
 5. Të rregjistrohen për çdo lëndë që ju ofrohet në universitet duke respektuar procedurat e përcaktuara në rregullore;
 6. Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
 7. Të organizohen në shoqata studentore jopolitike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse;

Neni 36 Karta e studentit

1. Studentët e Universitetit pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë

shërbime me çmime të reduktuara. Ministria e Arsimit dhe Shkencës përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.

2. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Neni 37 Organizimet studentore

1. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në universitet, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këta këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të universitetit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

2. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo vit nga votat e studentëve në semestrin e dytë të çdo viti akademik dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Këshillat e studentëve organizohen në nivel fakulteti (këshilli i studentëve të fakultetit), në nivel universiteti (Këshilli I studentëve të UV) dhe në nivel kombëtar (Këshilli Kombëtar i Studentëve).

3. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë.

4. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në statutin dhe rregulloren e tyre, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Rregulloren.

5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të



shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

KREU V PERSONELI I UNIVERSITETIT DHE PUNËSIMI

Neni 38 Struktura dhe Organika

Struktura dhe organika e personelit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë propozohet nga rektorati dhe miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura duhet të përmbajë numrin e punonjësve të Rektoratit, administratës dhe çdo njësie përbërëse të universitetit.

Neni 39 Personeli i universitetit

1. Personeli i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës përbëhet nga:

a. Personeli akademik në përbërje të të cilit janë:

- Profesorët
- Docentët
- Lektorët

b. Personeli ndihmës mësimor shkencor në përbërje të të cilit janë:

- Laborantët me arsim të lartë
- Laborantët me arsim të mesëm

c. Personeli administrativ. Pjesë e personelit administrativ janë të gjithë punonjësit të cilët janë pjesë e administratës dhe kryejnë detyra që shërbejnë në realizimin e misionit të arsimit të lartë pranë Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

2. Personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrative fillojnë e përfundojnë marrëdhëniet e punës në mënyrën e përcaktuar në Kodin e Punës, ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe kriteret e posaçme të parashikuara në këtë Statut e Rregulloren e Universitetit

"Ismail Qemali" Vlorë. Personeli akademik si dhe specialistë të tjerë të jashtëm, lidhin e përfundojnë marrëdhëniet me marrëveshje të veçanta që i nënshtrohen legjislacionit juridikocivil së drejtës ndërkombëtare në mënyrën e format e parashikuara në Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

3. Personeli akademik me titull "Profesor" mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, me të drejtë rikthimi, për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh, të rinovueshme, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Këtu përfshihen edhe pozicionet drejtuese të agjencive të rëndësishme të sistemit të arsimit dhe shkencës. Për periudhën e shkëputjes, ky personel akademik mund të zëvendësohet nga personel akademik me kontratë të përkohshme ose nga personel akademik i ftuar.

Neni 40 Punësimi i personelit me kohë të plotë

1. Punësimi në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës bëhet në mbështetje të legjislacionit të punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr 9741 dt 21.05.2007 "Per Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të këtij statuti. Ky punësim realizohet nëpërmjet procedurës së konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshem dhe objektiv.

2. Rregullat, kriteret dhe procedurat e punësimit, të drejtat dhe detyrat e personelit përcaktohen në rregulloren e universitetit.

Neni 41 Kërkesat për Punësim

1. Personat kandidatë për punësim të të tre niveleve, duhet të plotësojnë këto kërkesa të përgjithshme:

- a. të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë
- b. të kenë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe

studentët

c. të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë

d. të mos jetë marrë më parë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna apo zgjidhjes së kontratës nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

e. të mos kenë vepruar ose propoganduar në veprim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese, në median vizive dhe të shkruar, rrjetet sociale etj.

2. Komisionet ad-hoc të vlerësimit kontrollojnë me rigorozitet plotësimin e këtyre kërkesave më pare se të filloj procedura e vlerësimit duke eliminuar kandidatet që nuk i plotesojnë. Kërkesa të tjera të veçanta vendosen në njoftimin e konkurimit për vendin e lirë të punës mbështetur në pozicionin dhe përshkrimin e punës. Këto kërkesa i propozohen paraprakisht rektorit nga njësitë përkatëse që kërkojnë plotësimin e vendit vakant.

Neni 42

Norma mësimore dhe mbingarkesa

Norma mësimore për personelin akademik përcaktohet me Udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Personelit akademik i njihet e drejta e pagesës së orëve të realizuara mbi normën, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Elemente të normës së pedagogut janë mësimdhënia, kërkimi shkencor, dhe veprimtaria në mbështetje të institucionit.

Neni 43

Procedura e Konkurimit

Procedura e konkurimit fillon me publikimin e vendit të lirë të punës. Publikimi i vendit të lirë të punës dhe njoftimi për konkurim bëhet nga Rektori konform procedurave standarte për këto raste dhe njëkohësisht publikohet në faqen zyrtare të internetit apo në stendat e njoftimeve në ambientet e Universitetit. Njoftimi duhet të përmbajë: pozicionin, përshkrimin e vendit të punës, kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, listën e dokumenteve që duhet të paraqesin

kandidatët, afatin brenda të cilit do të kryhen aplikimet për vendin vakant, vendin e dorëzimit të dokumentacionit dhe menyrën e dorëzimit të tij (personalisht, me postë apo elektronike). Pas paraqitjes së dokumentacionit nga aplikantët, për vendin vakant dhe dokumentimit të këtij dokumentacioni nga struktura përkatëse e rektoratit, fillon procesi i vlerësimit nga komisionet përkatëse, në përfundim të të cilit i paraqesin Rektorit rezultatet e konkurimit dhe i bën ato publike.

Neni 44

Komisioni i vlerësimit

1. Komisioni i vlerësimit të kandidaturave për personel akademik zgjidhet me votim nga departamenti përkatës dhe përbëhet nga tre anetarë të departamentit, një anëtar nga një departament tjetër dhe përgjegjësi i departamentit i cili është njëkohësisht dhe kryetar i komisionit. Ky komision pasi miratohet nga dekani i fakultetit përkatës, bën vlerësimin e gjithë kandidaturave të paraqitura mbi bazën e dosjeve dhe intervistës. Vlerësimi bëhet me pikë dhe ndiqet proceduara konform e përcaktuar në rregulloren e universitetit dhe udhëzimin përkatës. Komisionet ad-hoc plotesojnë pasqyrën përmbledhëse të rezultateve të konkurimit në të dy fazat dhe së bashku me gjithë dokumentacionin përkatës ia përcjellin dekanit të fakultetit. Më tej dekani i fakultetit, përcjellë dosjet përkatëse dhe klasifikimin tek rektori brenda një periudhe një javove. Rektori vendos përfundimisht mbi kandidaturat e paraqitura.

2. Komisioni i vlerësimit të kandidaturave për personel administrativ propozohet nga kancelari dhe miratohet nga rektori. Ky komision bën vlerësimin e gjithë kandidaturave të paraqitura mbi bazën e dosjeve dhe intervistës. Vlerësimi bëhet me pikë dhe ndiqet proceduara konform e përcaktuar në rregulloren e universitetit dhe udhëzimin përkatës. Komisioni ad-hoc plotëson pasqyrën përmbledhëse të rezultateve të konkurimit në të dy fazat dhe së bashku me gjithë dokumentacionin përkatës ia përcjellin kancelarit të



institucionit. Më tej kancelari i institucionit përcjellë dosjet përkatëse dhe klasifikimin tek rektori brenda një periudhe një javove. Rektori vendos përfundimisht mbi kandidaturat e paraqitura.

Neni 45 **Koha e proves**

I punësuari rishtaz në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës i nënshtrohet një periudhe prove (jo domosdoshmërisht) e cila nuk mund të jetë më shumë se sa 1 vit akademik. Në mbarim të kësaj periudhe vendoset nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet. Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të punësuarit duhet t'i bëhen të ditura arsyet që çojnë në marrjen e një vendimi të tillë.

Neni 46 **Kontrata e punës**

1. Kontratat e punës, për personelin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës nënshkruhen nga Rektori. Rektori për disa kategori të caktuara punësh mund t'i delegojë këtë të drejtë një personi tjetër të autorizuar prej tij me akt përkatës.
2. Kontrata e punës nder te tjera duhet të përmbajë:
 - a. identitetin e palëve
 - b. vendin e punës
 - c. përshkrimin e punës që do të kryejë individi
 - d. datën e fillimit
 - e. kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës
 - f. kohëzgjatjen e kohës së punës dhe të pushimit
 - g. detyrat, të drejtat dhe detyrimet e palëve
 - h. normën mësimore (për personelin përkatës) e të tjerë element që konsiderohen të rëndësishëm
3. Kontrata e punës nënshkruhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e emerimit në punë. Si rregull, personeli akademik i përzgjedhur pas konkurimit merret në punë fillimisht me kontratë një vjeçare. Kjo kontratë me afat njëvjeçar mund të përsëritet edhe për një vit. Pas përfundimit të këtij afati dhe në rast se plotësohen

kushtet e vëna në kontratë, Rektori vendos nëse mund të lidh kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar. Bazuar në vlerësimin e performancës për kandidatët që kanë eksperiencë në punë në profesion jo më pak se 5 vjet, kontrata e punës mund të lidhet me kohëzgjatje të pacaktuar. Për personelin akademik me grada shkencore, kontrata e punës mund të lidhet me kohëzgjatje të pacaktuar. Për personelin akademik me titullin "Profesor", kontrata e punës lidhet me kohëzgjatje të pacaktuar.

Neni 47 **Personeli akademik i ftuar**

1. Personeli akademik i ftuar thirret për nevoja të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Personel akademik të ftuar dhe mund të jenë:
 - a. Profesor
 - b. Docent
 - c. Lektor
 - d. Specialist të kualifikuar në fusha përkatëse dhe plotësojnë kriteret bazë të punësimit në UV
2. Personeli akademik i ftuar përzgjidhet dhe miratohet në keshillat e fakulteteve nga lista e personave që propozohen nga departamentet përkatëse, duke mbajtur parasysh formimin akademik të tyre apo eksperiencën profesionale, në një fushë të caktuar, e cila i shërben nevojave konkrete të mësimdhënies ose kërkimit shkencor. Kriteret për përzgjedhjen e këtij personeli përcaktohen në rregulloret e fakulteteve.

Neni 48 **Personeli akademik me kontratë**

1. Njësitë kryesore me propozim të njërive bazë, përcaktojnë nevojat e tyre për staf të jashtëm dhe i përcjellin rektorit kërkesen për miratimin e numrit të personelit akademik me kontratë me kohë të plotë apo të pjesshme në Senatin Akademik. Senati Akademik duke u mbështetur në keto propozime në varësi të burimeve financiare që ka në dispozicion, miraton çdo vit numrin e personelit akademik me kontratë për

gjithë univerisitetin i cili pasqyrohet në strukturen dhe në buxhetin e institucionit.

2. Punësimi për personelin me kontratë me kohë të plotë apo të pjesshme bëhet në perputhje me nenin 49 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Personeli që punësohet me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, miratohet nga dekani i fakultetit dhe propozohet nga përgjegjesi i departamentit përkatës, duke mbajtur parasysh formimin akademik të tyre apo eksperiencën profesionale, në një fushë të caktuar, e cila i shërben nevojave konkrete të mësimdhënies ose kërkimit shkencor. Në propozimet e tyre departamentet i referohen jo vetëm kërkesave të kandidatëve të mundshëm por dhe informacioneve të tjera, duke kombinuar nevojën për mësimdhënie me kualifikimet e tyre. Për këte grup të personelit kontrata do të nënshkruhet për një punë të caktuar dhe për një kohë të caktuar. Rregulla më të hollësishme për perzgjedhjen e personelit akademik me kontratë me kohë të plotë dhe të pjesshme do të përcaktohen në rregulloret e njëjësive kryesore.

Neni 49

Mbarimi i marrëdhënieve të punës

1. Marrëdhëniet e punës në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë rregullohen me ligj dhe mbarimi i këtyre marrëdhënieve për çdo kategori të personelit bëhet kur:

- kur japin dorëheqjen.
- kur mbaron afati i parashikuar në kontratën e punës.
- kur bëhen të paaftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike dhe mendore.
- kur dënohen me vendim të formës së prerë
- kur konkludohet paaftësi për kryerjen e detyrave apo papershtatshmëri me vendin e punës (në rastin e ndryshimit të kërkesave për vendin e punës apo ndryshim ose mbyllje të departamenteve dhe njëjësive të tjera)
- kur shkelen rregullat e etikës së jetës akademike, të statutit dhe rregullores, nuk

respektohet hierarkia universitare.

- kur merret masa disiplinore e largimit nga puna.

Neni 50

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore jepen konform procedurave të percaktuara në Kodin e Punes, ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe rregulloren e UV-se. Autoritetet drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë marrin masa disiplinore në raste të mosplotësimit të detyrave të parashikuara në kontratën e punës, të mosrespektimit të urdhrave të titullarëve, të thyerjeve të disiplinës në punë, shkeljeve të rregullave dhe stadandarteve akademike si dhe në raste shkeljesh të rregullave të etikës dhe Kodit të Punes e parashikuar kjo dhe në nenin 50, pika 6 e ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

2. Llojet e masave disiplinore që marrin autoritetet drejtuese të universitetit në rastin shkeljes së dispozitës së mësipërme janë:

- a. Tërheqje vemendje.
- b. Vërejtje me shkrim.
- c. Vërejtje me paralajmerim.
- d. Pezullim nga detyra.
- e. Largim nga puna.

3. Masat disiplinore jepen nga Rektori me propozim të shefit të departamentit, dekanit, zëvendësrektorit. Masat disiplinore jepen nga direkt nga rektori për rastet që parashikohen në Kodin e Punes, në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Rregulla, procedura dhe rastet për të cilat merret masa disiplinore përcaktohen me të detajuara në rregulloren e universitetit.

Neni 51

Konflikti i interesave

Punonjësit e Universitetit duhet të evitojnë situatën që krijojnë konflikte midis



universitetit dhe interesave të tyre, po ashtu dhe institucioneve të tjera.

Neni 52

Kontrolli i cilësisë së mësimdhënies

1. Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit është pjesë e strukturës së universitetit dhe përbëhet nga:

- a. Pergjegjesi i njësise
 - b. Specialisti
 - c. Një përfaqësues për çdo njësi kryesore
 - d. Një përfaqësues i Këshillit të Studentëve
 - e. Një përfaqësues i Drejtorisë së Informacionit të Teknologjisë
 - f. Një përfaqësues ekspert i jashtëm i propozuar nga APAAL.
2. Kjo njësi ka për qëllim të vlerësojë periodikisht çdo semester efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe të praktikave profesionale, procesin e kontrollit të dijeve, diplomimit, si dhe të veprimtarive administrative dhe financiare të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Pas përfundimit të semestrit kjo njësi i paraqet Rektoratit raportin e vlerësimit semestral.

Neni 53

Kërkimi shkencor

1. Është detyrë e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe gjithë administratës së Universitetit të nxisë kërkimim-shkencor. Kërkimi shkencor është një komponent shumë i rëndësishëm i vlerësimit vjetor për gjithë stafin akademik.
2. Personeli akademik i universitetit si dhe studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve kanë të drejtë të zhvillojnë aktivitet kërkimor shkencor për funksione të universitetit apo të institucioneve të tjera.

Neni 54

Financimi i kërkimit shkencor

1. Veprimtaria kërkimore shkencore brenda universitetit planifikohet dhe mbështetet financiarisht në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Financimet për kërkimin shkencor për çdo vit, miratohen si pjesë e buxhetit.

2. Personeli akademik, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë kanë të drejtë të aplikojnë pranë Rektoratit, për fondet e miratuara nga buxheti i UV-së, për kërkimin shkencor, kualifikimet, botimet, konferencat shkencore etj. Në rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin përcaktohen procedurat për miratimin e mbështetjes financiare dhe rimbursimin e pagesave për aktivitetin e kërkimit shkencor të personelit të universitetit.

Neni 55

Kërkimi shkencor me ose për të tretët

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë nëpërmjet strukturave të tij, u ofron të tretëve ose pranon oferta për kërkim shkencor, ekspertizë shkencore, shërbime e të tjera, duke ndjekur procedurat e miratimit dhe kontribuar financiarisht sipas marrëveshjeve e në përputhje me Rregulloren.
2. Aktivitetet kërkimore shkencore për llogari të të tretëve mund të realizohen kur plotësohen kur nuk çënon përmbushjen e detyrimeve ndaj universitetit sipas kontratës së punës dhe nuk pengon punën kërkimore dhe shkencore në universitet.
3. Të ardhurat që krijohen nga aktiviteti kërkimor shkencor, për llogari të universitetit apo për institucione të tjera, përdoren sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke synuar stimulimin e pjesmarrësve në këto aktivitete.

KREU VI AUTONOMIA FINANCIARE

Neni 56

Autonomia financiare

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë funksionon sipas parimit të autonomisë financiare. Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga UV përcaktohet në rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin.

Neni 57

Hartimi i buxhetit



1. Projektbuxheti hartohet nga Rektorati, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga fakultetet dhe njësitë e tjera, si dhe miratohet nga Senati Akademik, pasi miratohet prej KADM-it.

2. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga Ministria e Financave. Projektbuxheti i përcillet Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, i cili brenda 30 ditëve ushtron kontrollin që i takon sipas ligjit në formën e kërkesës së motivuar për rishikim.

Neni 58 **Burimet e financimit**

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlore ka buxhetin tij që krijohet nga burime të përcaktuara dhe që realizohet në përputhje me rregulla ligjore të detyrueshme përgjithësisht në entet publike duke ruajtur autonominë në përdorimin e të ardhurave.

2. Burimet e financimit të "Ismail Qemali" Vlore janë :

- a. transfertat nga buxheti i shtetit
- b. të ardhura të krijuara nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlore
- c. burime të tjera me destinacion.

3. Universiteti "Ismail Qemali" Vlore përgatit rregulloren e tij për mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat e USH, në respektim të ligjeve në fuqi.

Neni 59 **Kontrolli dhe auditimi**

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlore i nënshtrohet auditit financiar (të brendshëm e të jashtëm), që realizohet nga institucionet e parashikuara me ligj.

2. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në "Ismail Qemali" Vlore dhe në njësitë përbërëse të tij, realizohet nga audit i brendshëm i Universiteti "Ismail Qemali" Vlore dhe njësitë e auditit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 60 **Vula zyrtare dhe stema**

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka vulën zyrtare sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka për simbol të tij stemën e paraqitur nga modeli i miratuar në faqet pasardhëse. Fakultetet e veçanta miratojnë simbolet e tyre nisur nga ky model.

Neni 61 **Miratimi i rregulloreve**

Brenda dy muajve nga miratimi i këtij Statuti, Senati akademik miraton Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Rregulloret e tjera të njohura në këtë Statut, miratohen brenda një muaji nga miratimi i Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 62 **Hyrja në fuqi**

Ky Statut hyn në fuqi me shpalljen e tij nga Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë pas miratimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës apo të nesërmen e mbarimit të afatit 2-mujor për t'u shprehur Ministri. Nëse Ministri e kthen këtë Statut për ripunim në Senatin Akademik, për vërejtje nga pikëpamja e ligjshmërisë, atëherë brenda 5 ditëve nga kthimi i Statutit, Senati Akademik mbledhet për të shqyrtuar dhe miratuar ndryshimet e propozuara me 2/3 e votave dhe statuti i riparaqitet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratim. Nëse krijohet konflikt që nuk zgjidhet me mirëkuptim, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë rezervon të drejtën, që me vendim të Senatit Akademik, të kundërshtojë sipas rregullave ligjore për aktet administrative.

KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. Albert Qarri

Rregullorja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme

- Neni 1: Baza ligjore
- Neni 2: Misioni dhe objekti
- Neni 3: Rregulloret e brendshme
- Neni 4: Qëllimet bazë
- Neni 5: Rregulla të veçanta
- Neni 6: Vendimet, urdhërat dhe udhëzimet
- Neni 7: Njoftimet, komunikimet shkresore dhe përdorimi i postës elektronike
- Neni 8: Njoftimi individual
- Neni 9: Interpretimi i aktit
- Neni 10: Interpretimi dhe kundërshtimi i aktit
- Neni 11: Korrigjimi dhe plotësimi i aktit

Kreu II: Struktura organizative e universitetit

- Neni 12: Njësitë përbërëse dhe struktura
- Neni 13: Organizimi i brendshëm

Kreu III: Funksione dhe kompetenca të tjera të organeve dhe autoriteteve drejtuese

- Neni 14: Senati Akademik
- Neni 15: Këshilli i Administrimit
- Neni 16: Rektori
- Neni 17: Këshilli i Fakultetit
- Neni 18: Këshilli i Etikës
- Neni 19: Këshilli Botues
- Neni 20: Rektori
- Neni 21: Zëvendësrektorët
- Neni 22: Kancelari
- Neni 23: Dekani
- Neni 24: Zëvendësdekani
- Neni 25: Përgjegjësi i departamentit

Kreu IV: Personeli i universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe punësimi

- Neni 26: Personeli i Universitetit
- Neni 27: Punësimi
- Neni 28: Kërkesat për Punësim
- Neni 29: Përzgjedhja dhe emërimi i personelit akademik me kohë të plotë, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ
- Neni 30: Personeli akademik i ftuar, me kontratë me kohë të plote ose të pjesshme
- Neni 31: Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik
- Neni 32: Të drejtat dhe detyrat e personelit ndihmës mësues-shkencor
- Neni 33: Të drejtat dhe detyrat e personelit administrativ
- Neni 34: Masat disiplinore

Kreu V: Organizimi i studimeve universitare

- Neni 35: Format e studimeve
- Neni 36: Programet e studimeve
- Neni 37: Ciklet dhe titujt e studimeve universitare
- Neni 38: Studimet me kohë të pjesshme
- Neni 39: Pranimi i studentëve
- Neni 40: Afati i studimeve
- Neni 41: Ndjekja e një programi të dytë studimi
- Neni 42: Nderprerja e studimeve
- Neni 43: Shkëputja e studentit nga programi
- Neni 44: Ripranimi
- Neni 45: Viti akademik dhe organizimi i mësimit
- Neni 46: Struktura e Studimeve



Neni 47: Disiplinat e detyrueshme dhe me zgjedhje

Neni 48: Plani Mësimor

Neni 49: Tekstet mësimore

Neni 50: Elementët e studimeve

Neni 51: Orari mësimor

Neni 52: Ndarja e studentëve në klasa

Neni 53: Frekuentimi i orëve mësimore dhe detyrimi i paraqitjes në provim

Neni 54: Sekretaria mësimore dhe regjistri themeltar

Neni 55: Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjise

Kreu VI: Transferimet, ekuivalentimi dhe ndërrimi i formës së studimeve

Neni 56: Transferimet e studimeve

Neni 57: Transferimi për në institucione të tjera

Neni 58: Transferimi nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 59: Ndërrimi i formës të studimeve

Kreu VII: Kontrolli i dijes

Neni 60: Sistemi i vlerësimit

Neni 61: Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi

Neni 62: Ankimi për rezultatin përfundimtar

Neni 63: Përmirësimi i notës

Neni 64: Praktika profesionale

Kreu VIII: Diplomimi

Neni 65: Mbrojtja e tezës së diplomës

Neni 66: Pajisja me diplomë

Neni 67: Tërheqja e diplomës

Kreu IX: Statusi, të drejtat dhe detyrimet e studentit

Neni 68: Marrja e statusit të studentit

Neni 69: Përfundimi dhe heqja e statusit

Neni 70: Të drejtat e studentëve

Neni 71: Detyrat e studentëve

Neni 72: Organizimet studentore

Neni 73: Veprimtaria

jashtëmësimore

Neni 74: Masat disiplinore për studentët

Kreu X: Rregulla dhe procedura akademike

Neni 75: Sistemi i kurseve dhe i krediteve

Neni 76: Pozita e studentit

Neni 77: Rregullat e regjistrimit dhe organizimi i kurseve

Neni 78: Ndjekja e kurseve jashtë programit të studimit

Neni 79: Tërheqja e studentëve nga kursi

Neni 80: Dëgjimi i kurseve

Neni 81: Përsëritja e kurseve

Neni 82: Rregullat e sjelljes akademike

Neni 83: Përgjegjësi të tjera të personelit akademik

Neni 84: Përgjegjësi të tjera të studentëve

Neni 85: Këshillimi akademik

Neni 86: Anketimi dhe vlerësimi

Neni 87: Probleme akademike dhe zgjidhja e tyre

Neni 88: Probleme joakademike

Kreu XI: Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialitetit

Neni 89: Mbrojtja e të dhënave

Neni 90: Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale

Kreu XII: Mbrojtja procedura e ankimit kundër diskriminimit dhe masat përkatëse

Neni 91: Hartimi i ankimit

Neni 92: Paraqitja e ankimit

Neni 93: Eprori, të cilit i drejtohet ankimi

Neni 94: Shqyrtimi i ankimit

Neni 95: Masat ndaj moszbatimit të detyrave

Neni 96: Masat ndaj diskriminimit

Kreu XII: Dispozita të fundit



**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Rregullorja e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë mbështetet në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Statutin e këtij universiteti dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi.

**Neni 2
Misioni dhe objekti**

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe administrative të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të tij dhe e shtrin veprimin e saj mbi gjithë organet dhe autoritetet drejtuese, njësitë përbërëse, personelin akademik, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ, studentët, bashkëpunëtorët e institucionit si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që vepron në objektet apo territorin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Rregullorja përcakton misionin e programeve të studimit dhe vendos rregullat normative të organizimit të tyre, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve, rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikime, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

**Neni 3
Rregulloret e brendshme**

Njësitë kryesore kanë rregullore të brendshme, të cilat duhet të jenë në përputhje me këtë rregullore. Rregulloret e brendshme të njësive kryesore hartohen nga këshillat përkatës të tyre dhe miratohen

nga Senati Akademik. Në funksion të mbarëvajtjes së gjithë veprimtarisë administrative dhe financiare në universitet mund të hartohen dhe rregullore të brendshme të administratës.

**Neni 4
Qëllimet bazë**

Mësimdhënia.

Mësimdhënia. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron programe rigorozë edukimi në mjaft fusha. Kurrikulumi përmban një thelb të fortë të bazuar në shkencat dhe artet e lira, mbi këtë bazë studentët tanë universitarë zhvillojnë mjeshtëritë, njohuritë, dhe aftësitë e duhura për të bërë një jetë aktive dhe të sukseshme si dhe për të qënë qytetarë të mirë. Një shumëllojshmëri profilizimesh dhe kurrikulash të specializuara i përgatisin studentët për ciklin e dytë dhe të tretë të studimit, për shkolla profesionale, ose për karriera menjëherë pas diplomimit. Çdo program ofron një shumëllojshmëri kursesh dhe eksperiencash kurrikulare që sigurojnë një jetë më të pasur, së bashku me një përgatitje të shkëlqyer për karrierën. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron programe Bachelor dhe Master në një hapësirë të gjerë disiplinare që përmbushin nevojat më thelbësore të qytetarëve shqiptarë në përputhje me kërkesat e tregut. Programet e doktoraturës që ofrohen sjellin risi në fushat përkatëse. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është përzgjedhës në standartet e tij të pranimit dhe synon si studentët tradicionalë po ashtu dhe ata jotradicionalë, duke u siguruar mundësi të barabarta të gjithë atyre që mund të përfitojnë prej programeve të tij. Një përpjekje e veçantë është bërë për të lokalizuar dhe për të pranuar studentë me disavantazhe por që kanë një potencial të fortë për sukses akademik dhe për t'u siguruar atyre mbështetjen që do të çojë në realizimin e atij potenciali.

Në regjistrimin e studentëve dhe ndarjen e tyre në grupe leksionesh dhe seminaresh apo çdo forme tjetër të marrjes së dijeve



respektohen standartet me qëllim që të ruhet cilësia e lartë e mësimdhënies.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron dhe do të vazhdojë të ofrojë vetëm ato programe për të cilat ka në dispozicion burimet njerëzore të duhura dhe kualifikuara, si dhe për të cilat ekziston një nevojë e dukshme dhe një potencial për studentë të kualifikuar.

Puna kërkimore-shkencore dhe akademike. Misioni i punës kërkimore-shkencore dhe akademike të Universitetit "Ismail Qemali" Vlore gjen shprehje në një shumëllojshmëri formash, duke variuar që nga studimet bazë, tek hulumtimet e aplikuara dhe të drejtuara ndaj problemeve të veçanta, e deri tek kontributet në letërsi e në art. Brenda mundësive të veta, universiteti ynë siguron mbështetje financiare për punë kërkimore-shkencore dhe akademike. Njëkohësisht ai është vazhdimisht në kërkim të burimeve të jashtme të mbështetjes. Institucionet e kërkimit shkencor, të financuara kryesisht nga fondet e jashtme, përbëjnë një kontribut të rëndësishëm ndaj këtij misioni. Është qëllim më vete përfshirja e studentëve në projekte kërkimore-shkencore dhe rezultatet e punës kërkimore dhe akademike të integrohen në kurset përkatëse mësimore. Aplikimi i hulumtimeve kërkimore e shkencore ndaj problemeve dhe shqetësimeve të industrisë dhe biznesit të vendit, si dhe ndaj agjencive shkencore, arsimore, qeveritare, shëndetësore dhe të shërbimeve publike shërben gjithashtu për të përforcuar rolin e shërbimit publik të universitetit.

Shërbimi publik. Universiteti "Ismail Qemali" bashkëpunon me biznese, njësi qeveritare, grupe komunitare, si dhe të tjera organizata në aspekte të kërkimit shkencor të zhvillimeve teknike dhe të iniciativave për t'u dhënë zgjidhje problemeve të ndryshme, duke u përpjekur t'a aplikoi ekspertizën e universitetit ndaj çështjeve të shoqërisë në përgjithësi ose të rajonit në veçanti, në mënyrë që të përmirësojë më tej cilësinë e jetës, përmes shërbimeve të tij. Ai synon të ruajë shkallën e duhur të fleksibilitetit që i

nevojitet për të reaguuar me mësimdhënie koherente, me hulumtime dhe të tjera shërbime ndaj nevojave gjithnjë në ndryshim të kohës. Universiteti vë në dispozicion ambientet e veta për një shumëllojshmëri aktivitete të agjensive dhe grupeve komunitare qëllimet e të cilave përputhen me misionin e universitetit. Ai u jep këtyre akses në programet e veta dhe në kampus, për sa kohë që qëllimet e tyre janë në përputhje me rolin dhe qëllimin kryesor edukues të institucionit.

Filozofia e Vitit të Parë. Eksperiencia e vitit të parë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë hedh themelet për suksesin e studentëve duke krijuar një ambient që nxit rritjen intelektuale dhe e trajton të nxënit si një aktivitet që zgjat për gjithë jetën. Studentët nxiten për të zhvilluar formimin e tyre në fushat përkatëse nëpërmjet programesh akademike bashkëkohore.

Neni 5 Rregulla të veçanta

Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë mund të nxjerrë rregulla të veçanta të zbatueshme në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, vetëm për një fushë, për një drejtim, për një objekt apo për një njësi të caktuar, për të siguruar zbatimin e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe këtë Rregullore, ose kur ka detyrim ligjor të posaçëm, në drejtime, situata apo kushte të një rëndësie të veçantë apo të jashtëzakonshme.

Neni 6 Vendimet, urdhërat dhe udhëzimet

Vendimet, urdhërat dhe udhëzimet e organeve dhe autoriteteve drejtuese i shtrijnë efektet e tyre në drejtimet përkatëse dhe subjektet përkatëse, kur janë hartuar dhe miratuar sipas rregullave, në formë dhe përmbajtje brenda kompetencave ligjore.

Neni 7

Njoftimet, komunikimet shkresore dhe përdorimi i postës elektronike

Organet dhe autoritetet drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe njësitë kryesore përbërëse, marrin dijeni për aktet ligjore e nënligjore, apo aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tyre, nga struktura përkatëse.

Dorëzimi apo njoftimi mbi aktet e mësipërme të protokolluara u bëhet anëtarëve të organeve drejtuese dhe autoriteteve drejtuese apo gjithë personelit të institucionit kur kjo është e nevojshme, përkundrejt nënshkrimit të drejtpërdrejtë apo të bashkëlidhur të tekstit përkatës, i cili ruhet nga komunikuesi për aq kohë sa ka fuqi vepruese akti. Më pas akti arkivohet.

Komunikimi i mësipërm dhe njoftimet e çdo lloji drejtuar personelit akademik dhe gjithë punonjësve të tjerë të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë është i vlefshëm dhe konsiderohet i kryer edhe kur bëhet nëpërmjet postës elektronike zyrtare, ose publikimit në faqen zyrtare të internetit www.univlori.edu.al, ose njoftimit verbal nga autoritet drejtuese të çdo niveli apo nga personat e caktuar prej tyre për të bërë njoftimin. Në këtë mënyrë veprohet edhe për aktet e brendshme të organeve dhe njërive përkatëse. Njoftimi konsiderohet i kryer dhe në rastet e mosnënshkrimit të aktit, kur personi refuzon të nënshkruaj apo njoftimi nëpërmjet shërbimit postar kthehet për shkak të refuzimit të marrjes në dorëzim nga personi, mosdodhjes në adresën e deklaruar prej tij dhe e konfirmuar nga shërbimi postar, si dhe raste të tjera të paparashikuara. Nga ana e personelit akademik dhe joakademik, komunikimi nëpërmjet postës elektronike zyrtare nuk përdoret për çdo arsye dhe në çdo kohë. Komunikimi nëpërmjet postës elektronike jozyrtare, nuk përdoret për çështje apo probleme që lidhen me veprimtarinë në institucion dhe konsiderohet i pavlefshëm.

Personeli akademik dhe gjithë punonjësit e tjerë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, përdorin komunikimin nëpërmjet postës elektronike zyrtare vetëm për të bërë njoftime dhe vetëm në ato raste kur

komunikimi verbal apo shkresor është i pamundur dhe pamundësia të jetë e justifikuar, veçanërisht kur ky njoftim u drejtohet autoriteteve drejtuese të çdo niveli. Personeli akademik dhe gjithë punonjësit e tjerë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, janë të detyruar që të mos përdorin shërbimin postar, për të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me çështje apo probleme që lidhen me punën, për ankesat dhe çdo lloj shkresë, për njoftimet apo letër informacioni, të cilat u drejtohen autoriteteve drejtuese, organeve apo çdo punonjësi. Në të gjitha rastet e mësipërme përdoret vetëm komunikimi i brendshëm zyrtar. Ky rregull është i njëjtë dhe për kthimet e përgjigjeve. Përgjigjet zyrtare, të cilat duhen bërë vetëm përmes shkresave zyrtare, nuk mund të zëvendësohen me kthim përgjigje përmes përdorimit të postës elektronike zyrtare në asnjë rast.

Mosrespektimi i këtij neni, përbën shkelje dhe merren masa disiplinore referuar nenit 50 të Statutit dhe nenit 34 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 8

Njoftimi individual

Personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor, personeli administrativ dhe studentët marrin dijeni për Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin, Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, rregulloret e brendshme të njërive dhe aktet e tjera me karakter të përhershëm, duke njohur vetë tekstin që u vihet në dispozicion nga struktura akademike dhe administrative përkatëse, në kohën e fillimit të marrëdhënieve të punës ose studimit.

Ndryshimi apo shfuqizimi i akteve bëhet me komunikim të përgjithshëm duke e publikuar në ambiente të posaçme ose në faqen zyrtare të internetit www.univlori.edu.al, përveç kur ligji përcakton shprehimisht njoftimin individual. Tekstet e akteve me karakter të përhershëm dhe ndryshimet e mëvonshme, konsiderohen të njoftuara nëse publikohen në faqen zyrtare të internetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, ose në ambiente të posaçme apo mënyra të tjera të

njoftimit, përveç kur ka detyrim për njoftim individual.

Neni 9 Interpretimi i aktit

Kur në kuadrin e zbatimit të një akti ka qëndrime të ndryshme për përmbajtjen e tij, autoriteti drejtues përkatës bën interpretimin me shkrim. Organet më të larta se interpretuesi me iniciativë ose me kërkesë, miratojnë ose ndryshojnë interpretimin e bërë. Organi që ka nxjerrë aktin bën interpretimin, i cili është i detyrueshëm për të gjithë.

Neni 10 Interpretimi dhe kundërshtimi i aktit

Kur kundërshtohet akti dhe/ose interpretimi i aktit, organi më i lartë hierarkik se hartuesi i aktit, sipas rastit, shqyrton ligshmërinë e aktit dhe/ose interpretimit të aktit, dhe bën interpretimin përfundimtar, anulimin, ose shfuqizimin e plotë ose të pjesëshëm të aktit.

Neni 11 Korrigjimi dhe plotësimi i aktit

Kur në kuadrin e zbatimit të aktit dalin aspekte, çështje apo elementë të parregulluara, lëshuesi i aktit apo organi që ka kompetencë për çështjen përkatëse, përcakton mënyrën e veprimit nisur nga rregullimi i aspekteve të ngjashme e kur është e pamundur, nga parimet e përgjithshme të ligjit nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Në këto raste plotësimi i aktit është detyrë e atij organi.

KREU II STRUKTURA ORGANIZATIVE E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Neni 12 Njësitë përbërëse dhe struktura

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përbëhet nga njësitë kryesore (fakultetet), njësitë bazë (departamentet), Qendra Kërkimore-Shkencore, Shkolla e Masterit dhe Doktoraturës, laboratorët, bibliotekat, qendrat dhe njësitë e tjera ndihmëse dhe administrative. Struktura organizative miratohet me vendim të Këshillit të Administrimit me propozim të Rektoratit dhe është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.

Neni 13 Organizimi i brendshëm

Struktura si më poshtë paraqet organizimin e brendshëm të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Autoritete drejtuese:

1. Rektori

Autoritete të tjera:

1. Kancelari

2. Zëvendësrektori

Organet drejtuese:

1. Senati Akademik

2. Rektorati

3. Këshilli i Administrimit

4. Këshilli i Etikës

Administrata Qendrore:

1. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve

- Sektori i Marrëdhënieve me Studentët dhe Statistikës

- Zyra Akademike

- Zyra e Regjistrimit

2. Sektori i Burimeve Njerëzore

- Protokoll Arkiva

- Specialiste pranë rektorit

- Sherbimi i Informacionit

3. Drejtoria e Komunikimit

- Zyra e Publikimeve dhe Botimeve Universitare

- Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë

- Zyra e Marketingut

- Zyra e Marrëdhënieve me Publikun

- Qendra e Këshillimit të Karrierës, Alumnit e Transparencës Administrative

- Qendra e Edukimit Fizik dhe Projekteve Sportive

4. Dega e Financës dhe Buxhetit

5. Sektori i Shërbimeve, Blerjeve dhe Mirëmbajtjes

6. Dega Juridike



7. Drejtoria e Projekteve, Investimeve dhe Aktiviteteve Shkencore
8. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë
9. Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit
10. Sektori i Bibliotekave

FAKULTETI I EKONOMISË

Autoritete drejtuese:

1. Dekani
2. Përgjegjësit e departamenteve

Organe drejtuese:

1. Këshilli i Fakultetit

Autoritete të tjera:

1. Zëvendësdekani

Njësitë bazë

1. Departamenti i Biznesit
2. Departamenti i Ekonomiksit
3. Departamenti i Financës

Administrata

1. Sekretaria mësimore

Punonjës ndihmës mësimor shkencorë

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE

Autoritete drejtuese:

1. Dekani
2. Përgjegjësit e departamenteve

Organe drejtuese:

2. Këshilli i Fakultetit

Autoritete të tjera:

1. Zëvendësdekani

Njësitë bazë

1. Departamenti i Matematikës
2. Departamenti i Fizikës
3. Departamenti i Kimisë
4. Departamenti i Biologjisë
5. Departamenti i Shkencave Kompjuterike
6. Departamenti i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale
7. Departamenti i Inxhinierisë Elektrike
8. Departamenti i Shkencave Detare

Administrata

1. Sekretaria mësimore

Punonjës ndihmës mësimor shkencorë

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Autoritete drejtuese:

1. Dekani
2. Përgjegjësit e departamenteve

Organe drejtuese:

1. Këshilli i Fakultetit

Autoritete të tjera:

1. Zëvendësdekani

Njësitë bazë

1. Departamenti i Edukimit
9. Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë
10. Departamenti i Gjuhëve të Huaja
11. Departamenti i Drejtësisë

Administrata

2. Sekretaria mësimore

Punonjës ndihmës mësimor shkencorë

FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK

Autoritete drejtuese:

1. Dekani
2. Përgjegjësit e departamenteve

Organe drejtuese:

1. Këshilli i Fakultetit

Autoritete të tjera:

1. Zëvendësdekani

Njësitë bazë:

1. Departamenti i Infermierisë
2. Departamenti i Shëndetit Publik
3. Departamenti i Kujdesit për Nënë dhe Fëmijën

Administrata

1. Sekretaria mësimore

Punonjës ndihmës mësimor shkencorë

NJËSI TË TJERA

1. Qendra Kërkimore Shkencore
2. Shkolla e Masterit dhe Doktoraturës
3. Qendra Life Long Learning

KREU III FUNKSIONE DHE KOMPETENCA TË TJERA TË ORGANEVE DHE AUTORITETEVE DREJTUESE

Neni 14

Senati Akademik

Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është organ vendimmarrës kolegjal dhe i zgjedhur. Ai vendos për planet e zhvillimit strategjik dhe problemet më të rëndësishme të institucionit në fushën e mësimt, të kërkimit shkencor dhe të organizimit administrativ e financiar. Detyrat dhe kompetencat e Senatit Akademik përcaktohen në ligjin nr. 9741, date

25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Senati Akademik përbëhet nga anëtarë përfaqësues të personelit akademik me kohë të plotë, të personelit administrativ dhe të studentëve me kohë të plotë, të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Rregulloren e Zgjedhjeve.

Neni 15 Këshilli i Administrimit

Funksionet, përbërja dhe funksionimi i Këshillit të Administrimit bazohen në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Këshilli i Administrimit mbledhet në seanca të zakonshme të paktën dy herë në tre muaj sipas rendit të ditës të përcaktuar më parë. Në mbledhjen e tij të parë Këshilli i Administrimit zgjedh kryetarin e tij dhe vendos mënyrën e organizimit. Këshilli i Administrimit mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme, kur kjo kërkohet nga kryetari ose 1/2 e anëtarëve të tij apo me kërkesë të rektorit ose kancelarit të institucionit për çështje të ndryshme në kompetencë të tij.

Neni 16 Rektorati

Rektorati funksionon duke u bazuar në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Rektorati kryesohet nga Rektori dhe përbëhet nga zëvendësrektorët, dekanët dhe kancelari. Rektorati funksionon me mbledhje. Si rregull rektorati mbledhet një herë në dy javë. Mbledhja e rektoratit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve. Përveç funksioneve dhe detyrave që

përcaktohen në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, rektorati ka edhe këto funksione:

1. Merr në shqyrtim problematika të funksionimit të përditshëm të njësive kryesore dhe të administratës e në përputhje me funksionet dhe kompetencat merr vendim ose e kalon çështjen për shqyrtim në organe apo autoritete të tjera drejtuese;
2. Merr vendim për masat administrative të propozuara nga organet dhe autoritet e tjera drejtuese;
3. Propozon në organet e tjera drejtuese vendosjen e tarifave për shërbimet që u ofrohen studentëve, stafit dhe të tretëve.

Neni 17 Këshilli i Fakultetit

Këshilli i Fakultetit funksionon bazuar në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, si dhe rregulloren e tij të brendshme. Rregullorja e brendshme e Këshillit të Fakultetit miratohet nga Senati Akademik. Këshilli i Fakultetit kryesohet nga dekani dhe përbëhet nga anëtarë të personelit me kohë të plotë, të zgjedhur në përputhje me Rregulloren e Zgjedhjeve të universitetit. Këshilli i Fakultetit funksionon me mbledhje. Mbledhja e Këshillit të Fakultetit zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve; Përveç funksioneve dhe detyrave që përcaktohen në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Këshilli i Fakultetit ka dhe këto funksione:

1. Merr në shqyrtim problematika të funksionimit të përditshëm të njësive kryesore dhe në përputhje me funksionet dhe kompetencat merr vendim ose ia kalon për shqyrtim organeve apo autoriteteve të tjera drejtuese.
2. Miraton listën e personelit akademik të ftuar që do të aktivizohet gjatë procesit



mësimor dhe ia kalon atë për miratim Rektorit.

3. Merr vendim për masat administrative të propozuara nga organet dhe autoritet e tjera drejtuese dhe i percjell ato në organet më të larta.

4. Shqyrton propozimet e ardhura nga departamentet për ndryshimin e kurrikulave, programit të kurseve, hapjen apo mbylljen e programeve të studimit dhe pasi merr vendim ia percjell organeve më të larta për miratim;

5. Propozon në organet e tjera drejtuese vendosjen e tarifave për shërbimet që u ofrohen studentëve, stafit dhe të tretëve.

Neni 18 Këshilli i Etikës

Këshilli i Etikës funksionon bazuar në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë si dhe Kodin e Etikës të miratuar nga Senati Akademik. Kodi i Etikës përcakton mënyrën e marrjes së vendimeve, paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, ekzekutimin e vendimeve dhe sanksionet përkatëse. Në Kodin e Etikës përcaktohen detyrimet e personelit dhe studentëve, mosrespektimi dhe shkelja e tyre, konsiderohet shkelje e etikës dhe është objekt i shqyrtimit në Këshillin e Etikës dhe nga autoritetet drejtuese të çdo niveli apo organi kolegjal.

Shkelje të rregullave etike konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e personelit akademik, personelit administrativ, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe studentit që çenojnë personalitetin e të tjerëve, etikën akademike, rregullat dhe normat etiko-morale të institucionit e të shoqërisë, sipas Kodit të Etikës i cili miratohet nga Senati Akademik. Këshilli i Etikës është organ kolegjal i cili diskuton probleme të etikës së jetës akademike dhe i paraqet propozime rektorit për këto çështje. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë të stafit akademik që kanë së paku titullin "Lektor". Anëtarët e Këshillit të Etikës përzgjidhen nga Senati

akademik, pas paraqitjes nga Rektori të propozimeve të këshillava të fakulteteve. Anëtarët e Këshilli i Etikës zgjedhin kryetarin me votim të fshehtë. Në çdo rast 2/3 e anëtarëve të Senatit Akademik mund të kërkojë votëbesimin për çdo anëtar të Këshillit të Etikës. Këshilli i Etikës vihet në lëvizje menjëherë kur ka ankesë me shkrim dhe/ose me kërkesë të Rektorit.

Organet dhe autoritet drejtuese të universitetit janë të detyruara të vënë në dispozicion të Këshillit të Etikës të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar për shqyrtimin e ankesave përkatëse. Këshilli i Etikës pasi shqyrton çështjen në fjalë, i bën propozime autoritetit drejtues përkatës, ose drejtpërdrejtë të rektorit kur kërkesa është bërë prej tij, për të vendosur mbi masat disiplinore.

Neni 19 Këshilli Botues

Këshilli Botues i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është një organ kolegjal i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë të personelit akademik, përbërja e të cilit miratohet nga Senati Akademik. Këshilli Botues ka për detyrë të shqyrtojë, të diskutojë dhe të miratojë botimet e personelit akademik, që do të shërbejnë si tekst bazë në programet e kurseve, sipas propozimeve të departamenteve përkatëse. Diskutimi dhe miratimi paraprak i botimeve të personelit akademik që do të shërbejnë si tekst bazë, duhet të bëhet më parë në departament dhe më tej të kalojë për miratim në Këshillin e Fakultetit.

Neni 20 Rektori

Rektori është autoriteti më i lartë i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Detyrat dhe kompetencat e tij janë përcaktuar në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin e këtij universiteti dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Neni 21

Zëvendësrektori

Zëvendësrektori përzgjidhet nga rektori dhe miratohet nga Senati Akademik. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë ka një zëvendësrektor që ndjek veprimtarinë mësimorëshkencore, atë të administratës dhe informacionit. Detyrat konkrete të zëvendësrektorit janë të përcaktuara më poshtë, por për nevoja të institucionit, rektori mund të bëjë ndryshimin e fushave të veprimit të tij.

Detyrat e zëvendësrektorit janë:

1. Bashkërendon dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore midis gjithë njësive bazë dhe atyre kryesore.
2. Ndjek dhe monitoron gjithë procesin mësimor.
3. Drejton punën për hartimin e planeve mësimore dhe shpërndarjen e ngarkesave mësimore.
4. Bën analizën e të gjithë aspekteve të punës së njësive akademike dhe mban kontakte të vazhdueshme me dekanët për të gjitha proceset akademike.
5. Ndjek strategjinë e zhvillimit akademik të institucionit.
6. Kryen gjitha detyrat e deleguara nga rektori.
7. Raporton tek rektori për gjithë procesin akademik.
8. Ndjek e kontrollon aktivitetin shkencor të universitetit.
9. Nxit dhe ndjek gjithë grantet dhe programet shkencore në të cilat merr pjesë universiteti.
10. Bashkërendon veprimtarinë shkencore të universitetit me institucionet e tjera shkencore, njësitë qeveritare dhe komunitetin.
11. Ndjek dhe mbështet ecurinë e kualifikimit shkencor të personelit akademik.
12. Ndjek ecurinë e buletinit shkencor, revistave shkencore, dhe konferencave që organizohen nga universiteti.
13. Nxit integrimin e studentëve në projekte shkencore
14. Nxit përfshirjen e projekteve shkencore në procesin e mësimdhënies.
15. Bashkërendon dhe kontrollon gjithë veprimtarinë e administratës.

16. Drejton punën për përditësimin e informacionit dhe editimin e tij në faqen zyrtare të universitetit.

17. Bën analizën e të gjithë aspekteve të punës së administratës.

18. Kryen gjithë detyrat e deleguara nga rektori.

19. Raporton tek rektori për gjithë veprimtarinë e administratës.

Neni 22

Kancelari

Kancelari i universitetit është personi që ndjek mbarëvajtjen administrative dhe ekonomike të institucionit. Detyrat dhe kompetencat e tij përcaktohen ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në akte ligjore e nënligjore dhe në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Kancelari i universitetit përgjigjet përpara Senatit Akademik, Këshillit të Administrimit, Rektorit, institucioneve qendrore dhe organeve shtetërore të kontrollit, për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën ekonomiko-financiare.

Neni 23

Dekani

Dekani është autoriteti më i lartë i Fakultetit. Veç pozitës juridike dhe kompetencave që përcaktohen për të në ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" ka edhe këto detyra:

1. Miraton komisionet ad-hoc për rekrutimin e personelit akademik dhe i përcjellë rektorit klasifikimin e kandidatëve.

2. Merr masa disiplinore për personelin akademik, ndihmës mësimor-shkencor, administrativ dhe studentët, kur konstaton vetë apo informohet nga përgjegjësi i departamentit për raste shkeljesh të përcaktuara në Statut, Rregullore, Kodin e Etikës, Kodin e Punës, Ligjin e Arsimit të Lartë etj. Në rastet e ndërprerjes së



marrëdhënieve të punës për personelin akademik që ka shkelur kontratën e punës dhe dispozitat ligjore në fuqi, i jep mendim me shkrim rektorit.

3. Miraton në parim kërkesat e personelit akademik dhe lejet për nevoja të kualifikimit shkencor, specializime e përvoja të tjera, brenda dhe jashtë vendit dhe i propozon për miratim në Rektorat së bashku me dokumentacionin shoqërues të lektorit kërkues.

4. Përcjell për njohje apo miratim në rektorat vendimet e emërimit apo të caktimit të autoriteteve drejtuese të njësisë kryesore.

5. Paraqet për miratim në Këshillin e Fakultetit raportin vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të fakultetit.

6. Miraton orarin mësimor dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore të fakultetit të hartuar nga departamentet dhe ia përcjellë rektorit për miratim përfundimtar.

7. Mbikqyr, kontrollon dhe vlerëson, madje drejtpërdrejtë në auditor, vetë ose me grupin e specialistëve të fushës përkatëse realizimin e procesit të mësimdhënies dhe sigurimin e standardeve të cilësisë.

8. Ka të drejtë në çdo kohë, para fillimit të semestrit dhe gjatë semestrit, të bëjë çdo ndryshim në orarin mësimor, të riorganizojë apo zëvendësojë personelin akademik dhe të rishpërndajë ngarkesën mësimore në rast se konstaton shkelje të disiplinës në punë, të rregullave e standardeve akademike, moszbatim të urdhrave të autoriteve drejtuese në lidhje me procesin e mësimdhënies, abuzime apo performancë e dobët, apo kur vetë i konsideron të nevojshme këto ndryshime në funksion të menaxhimit me të mirë dhe sigurimit të standardeve të cilësisë.

9. Mbikqyr dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik të gjithë fakultetit.

Neni 24 Zëvendësdekani

Zëvendësdekani është autoriteti drejtues për anën mësimore ose shkencore në

njësinë kryesore në mungesë të dekanit dhe për detyra të tjera të autorizuar prej tij.

Zëvendësdekani mbulon veprimtarinë mësimore, sektorin e kurrikulave dhe standarteve si dhe vlerësimin e brendshëm. Për nevoja të fakultetit, dekani mund të ndryshojë fushat e veprimit të zëvendësdekanit si dhe mund t'i caktojë atij detyra të tjera.

Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, zëvendësdekani ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:

1. Organizon e kontrollon punën mësimore e shkencore në fakultet;
2. Ndjek zbatimin e urdhrave të dekanit;
3. Ushtron kompetencat e dekanit në mungesë dhe me porosi të tij;
4. Ndjek përgatitjen dhe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore;
5. Organizon e kontrollon punën për të gjitha ciklet e studimeve;
6. Bashkërendon punën për shpërndarjen e ngarkesës mësimore të personelit dhe kontrollon realizimin e procesit të mësimdhënies;
7. Ndjek bashkëpunimin shkencor të njësisë të fakultetit;
8. Ndjek ecurinë e punës shkencore dhe të kualifikimit në fakultet;
9. Drejton hartimin e orarit mësimor, të provimeve dhe ndjek zbatimin e tyre;

Neni 25 Përgjegjësi i departamentit

Përgjegjësi i departamentit është autoriteti më i lartë për departamentin. Në veprimtarinë e tij mbështetet dhe përfaqëson mendimin e personelit akademik të departamentit. Veç detyrave të tjera të përcaktuara nga aktet normative në fuqi, përgjegjësi i departamentit ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij

1. Drejton punën për hartimin kurrikulave të programeve studimit që mbulon departamenti dhe ndjek me korrektësi zbatimin e tyre.
2. Ndjek e kontrollon aktivitetin shkencor në departament, në përputhje me planifikimin vjetor dhe mban dokumentacionin e



aktivitetit shkencor e akademik të anëtarëve të departamentit, pas raportimeve në analizën vjetore të tij.

3. Harton orarin mësimor dhe bashkërendon shpërndarjen e ngarkesës mësimore në çdo formë të mësimdhënies midis personelit akademik të departamentit sipas rregulloreve e udhëzimeve perkatëse të MAS-it e Rektoratit dhe ia përcjell për miratim dekanit

4. I propozon dekanatit masat për shkeljet e disiplinës në punë, të rregullave dhe standarteve akademike nga pedagogët.

5. Organizon analizën vjetore të punës mësimore shkencore, analiza periodike ose analiza të tjera për raste e aspekte të veçanta në departament

6. Mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, të kërkimeve shkencore dhe të veprimtarive të tjera, në kohën e në mënyrën e caktuar;

7. Mbikqyr dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore të personelit akademik të departamentit;

8. I paraqet dekanit listën me propozimet për personelin akademik të ftuar dhe atë me kontratë të përkohshme me kohë të plotë ose të pjesshme, pas miratimit paraprak në departament;

9. Propozon në Këshillin e Fakultetit krijimin, ndryshimin apo shkrirjen e grupeve mësimore e kërkimore, strukturën e tyre dhe ndryshimet e saj në përputhje me Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë;

10. Mbikqyr respektimin e disiplinës në punë, merr masat përkatëse për rivendosjen e rregullit në raste shkeljesh apo të metash. Njofton dekanin dhe bën rekomandimet përkatëse për çështje organizative e disiplinore kur e çmon të arsyeshme;

11. Ka të drejtë në çdo kohë, para fillimit të semestrit dhe gjatë semestrit, të bëjë çdo ndryshim në orarin mësimor, të riorganizojë apo zëvendesojë personelin akademik dhe të rishpërndajë ngarkesën mësimore në rast se konstaton shkelje të disiplinës në punë, të rregullave e standardeve akademike, moszbatim të urdhrave të autoriteve drejtuese në lidhje me procesin e mësimdhënies, abuzime apo

performancë e dobët, apo kur vetë i konsideron të nevojshme këto ndryshime në funksion të menaxhimit me të mirë dhe sigurimit të standardeve të cilësisë dhe ia përcjellë dekanit për miratim.

KREU IV PERSONELI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË DHE PUNËSIMI

Neni 26 Personeli i Universitetit

Personeli i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës përbëhet nga:

1. Personeli akademik në përbërje të të cilit janë, profesorët, docentët dhe lektorët. Kriteret e ndarjes në kategori dhe nivele përcaktohen në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

2. Personeli ndihmës mësimor-shkencor në përbërje të të cilit janë, laborantët me arsim të lartë, laborantët me arsim të mesëm.

3. Personeli administrativ, pjesë e së cilit janë të gjithë punonjësit e administrates dhe që kryejnë detyra që shërbejnë në realizimin e misionit të arsimit të lartë pranë Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

Neni 27 Punësimi

Punësimi në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë bëhet në mbështetje të legjislacionit të punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr. 9741 dt 21.05.2007 "Per Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, akteve nënligjore dhe Statutit. Ky punësim realizohet nëpërmjet procedurës së konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.

Neni 28 Kërkesat për Punësim

Personat kandidatë për punësim të të tre niveleve, për t'u punësuar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë duhet të plotësojnë së pari këto kërkesa të përgjithshme:

1. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë.
2. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët.
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një krimi.
4. Të mos jetë marrë më parë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna apo zgjidhjes së kontratës nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
5. Të mos kenë vepruar ose propoganduar në veprim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese, në median vizive dhe te shkruar, rrjetet sociale etj.

Neni 29

Përzgjedhja dhe emërimi i personelit akademik me kohë të plotë, ndihmës-mësimor-shkencor dhe administrative

Procedura e konkurimit të hapur për përzgjedhjen dhe emërimin e personelit akademik me kohë të plotë, ndihmes mësimor shkencor dhe administrativ realizohet si më poshtë:

1. Njësitë bazë dhe kryesore përcjellin në rektorat kërkesat e tyre për personel akademik me kohë të plotë dhe ndihmës-mësimor-shkencor. Kancelari përcjell kërkesat për personel administrativ.
2. Pas vlerësimit të kërkesave në referencë të nevojave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe administratës apo sektorëve të tjerë, bëhet publikimi i vendeve të lira të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në mënyrat e tjera si është përcaktuar në statut. Njoftimi përmban pozicionin, përshkrimin e vendit të punës, kërkesat e përgjithshme të përcaktuara dhe në statut si dhe kërkesa të tjera të veçanta të miratuara nga Rektori, listën e dokumenteve që duhet të paraqesin kandidatët, afatin brenda të cilit do të kryhen aplikimet për vendin vakant, vendin e dorëzimit të dokumentacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tij (me postë apo elektronike).
3. Pas njoftimit Rektori urdhëron ngritjen e komisioneve ad-hoc pranë çdo njësie dhe

pranë rektoratit për përzgjedhjen e personelit administrativ. Komisioni për personelin administrativ miratohet nga rektori dhe propozohet nga kancelari.

4. Dosjet e kandidatëve pranohen dhe protokollohen duke bërë regjistrimin e emrit të kandidatit dhe datën e vulës postare, e cila do të shërbejë për të përcaktuar nëse është respektuar apo jo afati i aplikimit.

5. Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore, merr në dorëzim gjithë dosjet e kandidatëve dhe u përcjell komisioneve të vlerësimit listën e kandidatëve.

6. Komisionet ad-hoc fillojnë procedurën e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve sipas udhëzimit përkatës. Në një pasqyrë të vecantë paraqiten rezultatet e konkurimit të të gjithë kandidatëve sipas pikëve të fituara dhe e përcjellin atë dekanit të fakultetit ose kancelarit në rastin e kandidatëve për personel administrativ.

7. Të gjithë kandidatët njoftohen nga sektori i burimeve njerëzore për datën dhe orën e intervistës së punësimit. Ky njoftim publikohet në ambiente pranë rektoratit.

8. Intervista zhvillohet me punëdhënësin dhe komisionin e intervistës. Komisioni i intervistës për personel akademik përbëhet nga dekani dhe përgjegjësit e departamenteve të fakultetit përkatës. Në rastin e kandidatëve për personel administrativ në intervistë është i pranishëm komisioni ad-hoc dhe kancelari.

9. Pas përfundimit të intervistës, komisioni bën vlerësimin me pikë të kandidatëve të intervistuar dhe e nënshkruan. Rezultatet i percillen më tej komisioneve ad-hoc.

10. Komisionet ad-hoc plotësojnë pasqyrën përmbledhëse të rezultateve të konkurimit në të dy fazat dhe së bashku me gjithë dokumentacionin përkatës ia përcjellin dekanit të fakultetit ose kancelarit të institucionit në rastin e kandidatëve për personel administrativ.

11. Dekani i fakultetit ose kancelari i institucionit përcjellin dosjet përkatëse dhe klasifikimin tek rektori brenda një periudhe një-javore. Rektori vendos përfundimisht mbi çdo kandidaturë që paraqitet.

12. Sektori i Burimeve Njerëzore bën njoftimin e kandidatëve fitues dhe atyre që nuk përzgjidhen (jo fitues).

13. Kandidatët jo fitues kanë të drejtën e ankimit tek Rektori brenda 5 ditëve pas marrjes së vendimit të komisionit.

Neni 30

Personeli akademik i ftuar, me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme

Njësitë kryesore përpara fillimit të çdo semestri ose gjatë vitit akademik, bazuar në nevojat e domosdoshme për realizimin e procesit të mësimdhënies, përcjellin për miratim në Rektorat listën emërore të personelit akademik të ftuar, me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, duke iu përmbajtur numrit të miratuar nga Këshilli i Administrimit për këtë kategori punonjësish. Konkurrimi për personelin akademik për të dyja kategoritë bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes. Kandidati duhet të plotësojë së pari kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 28 të kësaj rregulloreje dhe kriteret specifikë të përcaktuar në rregulloret e njësive kryesore.

Përzgjedhja bëhet në perputhje me nenin 48 dhe 49 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe modaliteteve të përcaktuara në Statutin e UV-së. Kriteret më specifike përcaktohen në rregulloret e brendshme të njësive kryesore.

Neni 31

Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik

Përveç sa përcaktohen në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodin e Punës, Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe në kontratat kolektive ose individuale të punës, personeli akademik ka edhe këto të drejta:

1. Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron universiteti, fakulteti dhe departamenti, duke respektuar rregullat e vendosura.

2. Të kërkojë të respektohen dhe të zbatohen të gjitha detyrimet që shtrohen gjatë procesit mësimor.

3. Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, fakultetit dhe universitetit, respektimin e të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë.

4. Të kërkojë nga studentët një frymë etike dhe morale në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Personeli akademik ka edhe këto detyra:

1. Të hartojë sipas afateve të përcaktuara nga dekani, programin e mësimdhënies dhe syllabusin e kursit të cilin ua bën të njohur studenteve, dhe një kopje e të tij duhet t'a dorëzojë në departament.

2. Të shfrytëzojë me efektivitet orën e mësimi duke iu përmbajtur orarit mësimor.

3. Të ndjekë sistematikisht zhvillimin dhe arrijtet e shkencës sipas profilit përkatës në planin kombëtar e ndërkombëtar dhe ta reflektojë atë në procesin mësimor.

4. Të hartojë në kohën e duhur tezat e provimit, të cilat çdo vit duhet të jenë të riformuluara, të azhornuara dhe gjithëpërfshirëse.

5. Të dorëzojë në kohë në sekretarinë mësimore rezultatet e vlerësimit të studentëve.

6. Të depozitojë në kohë në sekretarinë e departamentit testet e provimeve, të cilat ruhen të pakten deri në përfundim të provimeve të semestrit të ardhshëm.

7. Të zbatojë udhëzimet në fuqi gjatë realizimit të programit mësimor.

8. Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij parimet e etikës qytetare, Kodin e Etikës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, duke shfaqur një figurë të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në universitet.

9. Të respektojë me përgjegjësi orarin mësimor e zyrtar dhe disiplinën në punë;

10. Të ruajë sekretin profesional, të mos japë të dhëna lidhur me detyrën që kryen pa qenë autorizuar nga autoriteti drejtues.

11. Të japë me përgjegjësi informacion mbi realizimin e procesit të mësimdhënies, kerkimit shkencor, kontributit në institucion dhe aspekteve tjera të punës, sa here që

kjo i kërkohet nga autoritetet drejtuese të departamentit, fakultetit dhe universitetit.

12. Përpara fillimit të çdo semestri personeli akademik me kohë të plotë, merr miratimin nga përgjegjësi i departamentit, nga dekani i njësisë kryesore dhe nga rektori, për aktivitetin mësimor me kohë të pjesshme që mund të kryejë në institucione të tjera të arsimit të lartë.

13. Të zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e autoriteteve drejtuese të çdo niveli, të dhëna me shkrim ose me gojë.

14. Të realizojë normen e ngarkesës mësimore dhe mbingarkesen në raste nevojë. Për personelin akademik në kategorinë "Lektor" dhe "Docent" ngarkesa mësimore mund të realizohet edhe vetëm në një nga format e mësimdhënies. Personeli akademik në kategorinë "Profesor" mund ta realizojë ngarkesën mësimore vetëm me leksione ose edhe në format e mësimdhënies që dëshiron.

Neni 32

Të drejtat dhe detyrat e personelit ndihmës mësimor-shkencor

Përveç sa përcaktohen në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodin e Punës, Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe në kontratat kolektive ose individuale të punës, personeli ndihmës mësimor-shkencor ka edhe këto të drejta:

1. Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron institucioni, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
2. Të kërkojë të respektohen dhe të zbatohen të gjitha detyrimet që shtrohen gjatë realizimit të detyrës së ngarkuar në procesin mësimor;
3. Të kërkojë nga autoritetet dhe organet drejtuese të departamentit, fakultetit dhe universitetit, respektimin e të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë;
4. Të kërkojë nga kolegët dhe studentët një frymë etike dhe morale të tillë, që të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi;

2. Personeli ndihmës mësimor-shkencor ka edhe këto detyrime:

1. Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij parimet e etikës qytetare, Kodin e Etikës të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, duke shfaqur një figurë të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në të;
2. Të kryejë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar duke vënë në shërbim aftësitë profesionale dhe intelektuale;
3. Të shfrytëzojë me efektivitet orën e mësimin duke iu pëmbajtur orarit mësimor;
4. Të respektojë me përgjegjësi disiplinën në punë;
5. Të ruajë bazën materiale që ka në ngarkim;
6. Të ruajë sekretin profesional, të mos japë të dhëna lidhur me detyrën që kryen pa qenë i autorizuar nga autoriteti drejtues përkatës;
7. Të zbatojë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të programit mësimor;
8. Përveç detyrave kryesore të përcaktuara në rregulloret përkatëse, të realizojë edhe detyra të tjera në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, apo udhëzime të tjera të autoritetit drejtues përkatës;
9. Të zbatojë çdo urdhër të posaçëm të autoritetit drejtues përkatës, për situata të veçanta, emergjente apo ngjarje të rëndësishme në institucion.

Neni 33

Të drejtat dhe detyrat e personelit administrativ

Përveç sa përcaktohen në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodin e Punës, Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe në kontratat kolektive ose individuale të punës, personeli administrative ka edhe këto të drejta:

1. Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron institucioni, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
2. Të kërkojë të respektohen dhe të zbatohen të gjitha detyrimet që shtrohen gjatë realizimit të detyrës së ngarkuar;

3. Të kërkojë nga autoritetet dhe organet drejtuese të universitetit, respektimin e të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë;

4. Të kërkojë nga kolegët një frymë etiko-morale të tillë, që të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi;

Personeli administrativ ka edhe këto detyrime:

1. Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij parimet e etikës qytetare, Kodin e Etikës të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë duke shfaqur një figurë të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në universitet;

2. Të kryejë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar duke vënë në shërbim aftësitë profesionale dhe intelektuale;

3. Të respektojë me përgjegjësi disiplinën në punë;

4. Të ruajë bazën materiale që ka në ngarkim;

5. Të ruajë sekretin profesional, të mos japë të dhëna lidhur me detyrën që kryen pa qenë i autorizuar nga autoriteti drejtues përkatës;

6. Të zbatojë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të detyrës së ngarkuar;

7. Përveç detyrave kryesore të përcaktuara në rregulloret përkatëse, të realizojë edhe detyra të tjera në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi apo urdhrave të drejtuesit përkatës;

8. Të zbatojë çdo urdhër të posaçëm të drejtuesit përkatës, për situata të veçanta, emergjente apo ngjarje të rëndësishme në institucion.

Neni 34 Masat disiplinore

Masat disiplinore jepen konform procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës, ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Statutin e UV-së. Autoritetet drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë marrin masa disiplinore në raste shkeljeve të Statutit, të Rregullores, të mosplotësimit të detyrave të

parashikuara në kontratën e punës, të mosrespektimit të urdhërave të titullarëve të dhëna me gojë apo me shkrim, të thyerjeve të disiplinës në punë, shkeljeve të rregullave dhe stadandarëve akademike, shkeljeve të rregullave të etikës së jetës akademike dhe institucionale të përcaktuara në Kodin e Etikës dhe shkeljet e Kodit të Punës e parashikuar kjo dhe në nenin 50, pika 6 e ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Llojet e masave disiplinore që marrin autoritetet drejtuese të universitetit në rastin shkeljes së dispozitës së mësipërme janë:

1. Tërheqje vëmendje;

2. Vërejtje me shkrim;

3. Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna;

4. Pezullim nga detyra ose puna;

5. Largim nga puna.

Nuk është e nevojshme të merren të gjitha masat disiplinore përpara se punëmarrësi të largohet nga puna. Masat disiplinore për të gjithë punonjësit e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë jepen nga rektori, si rregull me propozim të dekanit të njësisë kryesore për personelin akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në njësinë kryesore përkatëse, apo kancelarit për personelin administrativ të Rektoratit. Masat disiplinore jepen direkt nga rektori për rastet që parashikohen në Kodin e Punës, në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutin dhe këtë Rregullore. Dekani ka të drejtë marrjen e masave disiplinore për personelin akademik, ndihmës mësimor-shkencor, administrativ dhe studentët, kur konstaton vetë apo informohet nga përgjegjësi i departamentit për të gjitha rastet e shkeljeve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni. Masa disiplinore i përcjelllet Rektorit për miratim. Përgjegjësi i departamentit ka gjithashtu të drejtë të propozojë tek dekani masa disiplinore për personelin akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ të njësisë që ata drejtojnë. Këto masa ata i propozojnë tek dekani dhe në rast mospërputhje apo



kundërshtimi i përcjellin drejtpërdrejt tek Rektori. Rektori ka të drejtë të japë masen disiplinore të pezullimit nga puna deri në një muaj, nëse konstaton shkelje të përsërituara, shkelje që çënojnë drejtëpërdrejt procesin e mësimdhënies dhe cilesinë e tij, prishin imazhin e universitetit apo raste të tjera që konsiderohen për një masë të tillë. Masa disiplinore jepet pasi bëhen verifikimet e nevojshme për shkeljen dhe dëgjohen paraprakisht pretendimet e punonjësit. Si rregull, masat disiplinore merren sipas radhës së përcaktuar më sipër, përveçse kur punonjësi ka kryer shkelje të rëndë të normave ligjore dhe nënligjore. Masa disiplinore "Largim nga puna" për personelin akademik merret në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon marrëdhënien e punës, si dhe pasi është marrë mendimi i titullarit të grupit mësimor-kërkimor, përgjegjësit të departamentit dhe titullarit të njësisë kryesore. Në raste të shkeljes flagrante të Kodit të Punës dhe etikës akademike, masa disiplinore "Largim nga puna" merret drejtpërdrejt nga rektori pa propozim. Masat disiplinore "Vërejtje me shkrim" dhe "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" shlyhen brenda gjashtë muajve, nëse punonjësi ndaj të cilit është marrë ajo, nuk kryen shkelje tjetër. Pas shlyerjes së masës, punonjësi konsiderohet pa masë disiplinore.

KREU V ORGANIZIMI I STUDIMEVE UNIVERSITARE

Neni 35 Format e studimeve

Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë studimet universitare organizohen në këto forma:

- studime me kohë të plotë;
- studime me kohë të pjesshme;

Aplikimi dhe zbatimi i çdonjëres formë të studimit të parashikuar, miratohet paraprakisht në Senatin Akademik dhe i përcillet për miratim të mëtejshëm Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Neni 36 Programet e studimeve

Programet e studimeve në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, si ato me kohë të plotë apo të pjesshme, organizohen në cikle dhe përfundojnë me marrjen e diplomave ose çertifikatave përkatëse. Universitetin "Ismail Qemali" i Vlorës ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit. Programet e studimeve hartohen nga vetë universiteti dhe miratohen në Senatin Akademik. Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron, para fillimit të aplikimeve për pranime në to.

Neni 37 Ciklet dhe titujt e studimeve universitare

Programet e studimeve në Universitetin e Vlorës organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme:

- cikli i parë,
- cikli i dytë,
- cikli i tretë.

Programet e studimeve të ciklit të parë:

1. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjerë profesionesh e specialitetesh.
2. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) (më tej: kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike ndërsa në sistemin me kohë të pjesshme është jo më pak se katër vite akademike.
3. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer. Në Universitetin "Ismail

Qemali" Vlorë, programet e studimeve të ciklit të parë konceptohen në radhë të parë nga departamentet e fakulteteve duke respektuar dhe kërkesat e dispozitave ligjore dhe nënligjore. Departamentet hartojnë programe studimore për çdo lëndë që përfshihet në sferën e departamentit. Projekt-programet e përgatitura nga departamentet duhet të respektojnë standartet e kërkuara. Propozimet e departamenteve, shqyrtohen dhe marrin një miratim paraprak në Këshillin e Fakultetit. Këshilli i Fakultetit shqyrton në veçanti justifikimin e departamenteve për numrin e krediteve të propozuara për çdo lëndë. Këshilli i Fakultetit mund të rikthejë propozimin për përpunim të mëtejshëm në departamente. Orientimet e Këshillit të Fakultetit në këtë rast janë të detyrueshme për departamentin. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të programeve brenda fakultetit, Këshilli i Fakultetit, përmes dekanit, ia dërgon programin për miratim Senatit Akademik. Senati Akademik mund ta kthejë programin e propozuar pranë fakultetit propozues për rishikim të mëtejshëm. Orientimet e Senatit Akademik janë të detyrueshme për fakultetin në këtë rast.

Programet e studimeve të ciklit të dytë:

Programet e studimeve të ciklit të dytë japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti. Ato janë programe të studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" dhe "Master Profesional". Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standartet akademike të kriterëve të pranimit. Kriteret e pranimit për studimet e ciklit të dytë përcaktohen në rregulloret e fakulteteve. Rregulla dhe specifika të këtyre programeve janë:

1. Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale etyre është 2 vite akademike. Studentët e këtij programi

studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare për nivelin e miratuar nga Senati Akademik. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" në fushën e arsimimit të kryer.

2. Programet e studimeve "Master Profesional" ofrojnë arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional dhe realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik. Studentët e këtij program studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare për nivelin e miratuar nga Senati Akademik. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare "Master Profesional" në fushën e arsimimit e të trajnimit profesional të kryer.

3. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë kandidatë që kanë fituar diplomë "Master Profesional" mund të pranohen në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura", vetëm nëse plotësojnë kriteret e vendosura për këto raste.

Programet e studimeve të ciklit të tretë:

1. Programet e ciklit të tretë janë studime të doktoratës dhe janë programe studimi me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarura.

2. Në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" apo diploma ekuivalente me to dhe zgjasin të paktën 3 vite dhe përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara teorike.

3. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, në bazë të rezultateve të arritura në studimet e organizuara teorike, vendos kritere klasifikimi për kandidatët që kanë të drejtë të zhvillojnë projektin kërkimor dhe të përgatisin tezën e doktorates dhe përcakton standarde e kritere kualifikuese për njohjen e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, si dhe metoda për



vlërësimin e nivelit teorik të përgjithshëm të kandidatëve. Kandidatët, që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të vazhduar më tej studimet e doktoratës dhe pajisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditet e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre.

4. Organizimi dhe funksionimi i programeve të studimeve të doktoratës, përcaktohet me rregullore të veçantë të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

5. Në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor"(Dr).

Neni 38

Studimet me kohë të pjesshme

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në fakultetet e tij organizon studimet me kohë të pjesshme. Kuotat e pranimit dhe tarifa e veçantë e shkollimit për studimet me kohë të pjesshme përcaktohen në aktet nënligjore të Keshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në formën e studimit me kohë të pjesshme realizohen me të njëjtat kredite si programet e studimit me kohë të plotë. Kohezgjatja normale studimeve të ciklit të parë është jo më pak se 4 (katër) vite akademike. Programet mësimore në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në formën e studimit me kohë të pjesshme janë të njëjta me atë të sistemit me kohë të plotë. Ngarkesa mësimore ditore është jo më shumë se 8 orë mësimi 60 minutëshe. Departamenti dhe fakulteti përcaktojnë mënyrën se si do të organizohen studimet me kohë të pjesshme.

Neni 39

Pranimi i studentëve

Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e ciklit të parë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, bëhet sipas listave përkatëse të miratuara nga MAS. Është e drejta e Senatit Akademik të përcaktojë kriteret shtesë për pranimet ciklin e parë të

studimeve në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Pranimi i kandidatëve për të ndjekur studimet e ciklit të dytë dhe të tretë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, bëhet konform kriterëve dhe standarteve të miratuara në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

Neni 40

Afati i studimeve

Afati i studimeve për çdo cikël studimesh është i përcaktuar në ligjin nr. 9741, datë 25.08.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Studenti mund të përfundojë studimet e plota dhe të mbrojë diplomën, brenda afatit të rregullt të studimeve ose tej kufirit që parashikon ky afat, por në sistemin e studimit me kohë të plotë ky afat nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i afatit të rregullt. Në sistemin me kohë të pjesshme nuk ka kufizime në kohëzgjatjen e studimeve, përveç rasteve kur studimet ndërpriten pa arsye të justifikuara dhe të miratuara për një periudhë më shumë se tre vite.

Neni 41

Ndjekja e një programi të dytë studimi

Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast si rregull përzgjidhen kandidatët, të cilët kanë mesatare më të lartë. Kandidatët që pranohen në një program të dytë studimi përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer sipas kriterëve dhe procedurave që parashikon ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kuotat e pranimit dhe tarifa e shkollimit për programet e dyta të studimit përcaktohen me vendim të Keshillit të Ministrave. Kriteret specifike për t'u pranuar në një program të dytë studimi përcaktohen në rregulloret e fakulteteve.

Neni 42 Ndërprerja e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko-ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi.
- kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat perkatese

Në çdo rast dokumentat duhet të paraqiten përpara se të ndërpresë studimet, të shoqëruara

me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Për studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra rradhë dhe nuk

kanë marrë lejen nga rektori për këtë ndërprerje duhet të aplikojnë përsëri për praninë në universitet.

Ndërprerja e studimeve, me miratimin e organit përkatës, quhet e justifikuar dhe nuk llogaritet në vitet e përsëritura.

Çdo ndërprerje e pajustificuar dhe e pa merituar është e barsvlershme me mosparaqitjen

në procesin mësimor dhe viti konsiderohet si vit përsëritje.

Neni 43 Shkëputja e studentit nga programi

Studenti që shkëputet në kuadrin e projekteve e programeve ndërkombëtare në të cilat

Universiteti "Ismail Qemali" i Vlores ka marrëveshje, lirohet nga detyrimet e frekuentimit

parashikuar nga kjo dispozitë. Atij i njihen provimet e dhëna jashtë shtetit për lëndët e ngjashme dhe me kthimin në atdhe, duhet të shlyejë detyrimet për lëndët e tjera.

Neni 44 Ripranimi

Ripranimi është kusht i domosdoshëm për të gjithë studentët frekuentimi i të cilëve është

ndërprerë për një periudhë prej një a më shumë vjet. Studenti që kërkon t'i rikthehet studimeve duhet e të paraqesë kërkesën për ripranim (plotësohet një formular kërkesëripranimi)

pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Studentët, e cila ia përcjellë këtë Zyrës Akademike. Numri i herëve që një student të ripranohet është i kufizuar, jo më shumë se 2

herë. Ripranimet do të bëhen konform akteve ligjore dhe nënligjore.

Vendimet për ripranim merren duke e trajtuar çdo rast si të veçantë, gjë që përfshin rishikimin e dosjes së studentit dhe vlerësimin e arsyejeve të largimit. Vlerësimi bëhet nga komisioni i ripranimeve, transferimeve dhe regjistrimeve në programe të dyta studimi I ngritur në nivel institucioni. Vendimi i komisionit i përcillet Rektorit për miratim. Nëse një student ripranohet ai duhet të fillojë regjistrimin në kurse po në atë semestër. Në rast se studentët e ripranuar nuk arrijnë të regjistrohen në semestrin apo sezonin për të cilin u është dhënë ripranimi, ai ripranim do të konsiderohet pavlefshëm. Në rast se studentët dëshirojnë të regjistrohen për semestrin apo sezonin që pason menjëherë periudhën për të cilën është dhënë ripranimi, ata mund ta bëjnë këtë me anë të një kërkesë të shkruar për të rinovuar aplikimin e tyre për ripranim të adresuar Zyrës Akademike. Megjithatë nëse këta studentë dëshirojnë të regjistrohen pas një periudhe më të vonë sesa një semestër apo sezon duke filluar nga momenti në të cilin u pranuan, atyre u duhet të kompletojnë një tjetër aplikim për ripranim dhe ta dorëzojnë atë brenda limitit 45-ditor.

Studentit që ka ndërprerë studimet, i njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitin që është shkëputur. Ai i nënshtrohet detyrimeve të programit mësimor që gjen pas rifillimit të studimeve.

Neni 45



Viti akademik dhe organizimi I mësimdhënies

Studimet në Universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës zhvillohen me bazë vitin akademik i cili organizohet në tre semestra:

- Semestri i Vjeshtës,
- Semestri i Pranverës,
- Semestri i Verës.

Në ciklin e parë të studimeve kohëzgjatja e semestrit të vjeshtës dhe pranverës është 15 javë kalendarike. Ngarkesa mësimore javore e studentit për çdo disiplinë, e ndarë në leksione,

seminare, laboratorë apo forma të tjera, përcaktohet në planet mësimore.

Në ciklin e dytë të studimeve master, semestret e vjeshtës dhe pranverës kanë të njëjtën kohëzgjatje, por me specifikën që programi i një discipline mund të realizohet jo domosdoshmërisht për një periudhë 15-javore, bazuar në burimet njerëzore të brendshme dhe të jashtme që ofron universiteti dhe në varësi të kushteve të tjera. Kjo nënkupton që plani mësimor semestral mund realizohet, duke bërë një organizim të mësimdhënies dhe shpërndarje të disiplinave përgjatë tij, që do të thotë se mësimdhënia në një disiplinë mund të fillojë në një nga javët e semestrit dhe të përfundojë pasi të realizohet programi me ngarkesën mësimore përkatëse të leksioneve, seminareve, laboreve apo formave të tjera të mësimdhënies. Semestri i Verës organizohet për t'u krijuar mundësi studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, të rijapin provimet e çdo lënde në të cilat rezultojnë ngelës dhe të atyre lëndëve në të cilat nuk janë paraqitur në provim por nuk kanë detyrime frekuentimi. Regjistrimi i studentëve në kurset semestrit të verës bëhet nëpërmjet Sistemit të Manaxhimit të Informacionit Univlora, vetëm për lëndët në të cilat ata kanë vlerësimin me notën 4 (katër) ose shënimin "NP" (Nuk u paraqit) dhe mund të regjistrohet në kurse deri në 40 kredite. Këto kurse zgjatën një deri tre javë dhe organizohen në formën e konsultimeve ose leksioneve të

permbledhura të mirëpërcaktuara në syllabus dhe vlerësimi bëhet nëpërmjet një provimi të vetëm. Çdo fakultet dhe departament para fillimit të semestrit të verës, duhet të shpallë orarin e kurseve të këtij semestri. Orët mësimore të realizuara në këtë semestër nga çdo pedagog përllorë si pjesë e ngarkesës mësimore vjetore. Në raste të veçanta kur studentët pengohen për t'u diplomuar vetëm për një lëndë të cilën nuk e kanë frekuentuar për arsye të justifikuar, pas vlerësimit të kërkesës së studentëve nga departamenti përkatës, me vendim të Këshillit të Fakultetit, mund të hapet kursi në atë lëndë me jo më pak se 15 studentë, vetëm pas miratimit nga Rektori. Programi i lëndës do të realizohet brenda 5 javëve duke iu përmbajtur syllabuseve. Në periudhën 15 Janar - 31 Janar të çdo viti akademik, përmes një sezoni riprovimesh, të gjithë studentëve të ciklit të parë dhe të dytë u krijohet mundësia të shlyejnë nëpërmjet një provimi të vetëm, secilën nga lëndët në të cilat kanë vlerësimin me notën 4 (katër) ose shënimin "NP" (Nuk u paraqit). Regjistrimi i studentëve në sezonin e riprovimeve të dimrit do të bëhet nëpërmjet Sistemit të Manaxhimit të Informacionit Univlora dhe çdo student mund të regjistrohet në lëndë deri në 25 kredite. Për kurset e semestrit të verës dhe sezonit të riprovimeve në dimër mund të aplikohen tarifa mbi bazë të numrit të krediteve të regjistruara dhe në varësi të rasteve të veçanta, pasi këto tarifa janë aprovuar më parë. Fillimi i vitit akademik shpallet nga Ministri i Arsimit dhe Sportit. Organizimi i vitit akademik, datat fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga Rektori në fillim të vitit akademik.

Neni 46

Struktura e Studimeve

Struktura e studimeve për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve përfshin:

- Disiplina të formimit të përgjithshëm
- Disiplina të formimit karakterizues të programit



- Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese
 - Disiplina formuese të zgjedhura
 - Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike dhe praktika apo stazhe
 - Veprimtari formuese në lidhje me tezën e diplomës
- Çdo fakultet përcakton sipas udhëzimeve të MAS dhe specifikave të veta, veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi.

Neni 47

Disiplinat e detyrueshme dhe me zgjedhje

Disiplinat sipas veçantive të çdo programi, ndahen në:

- Disiplina (kurse) të detyrueshme
- Disiplina (kurse) me zgjedhje

Disiplinat e detyrueshme përfshijnë veprimtari shkencore të fushës përkatëse të diplomimit, të cilat janë të përcaktuara në kurrikulat mësimore. Disiplinat me zgjedhje përfshijnë veprimtari shkencore të fushës përkatëse të diplomimit, të cilat janë të orientuara drejt një specializimi më të ngushtë. Në përshtatje me kurrikulën e çdo programi studimi, përcaktohet një numër i caktuar lëndësh me zgjedhje.

Neni 48

Plani Mësimor

Vëllimi i studimeve përcaktohet në varësi të kurrikulave të çdo programi studimi, të cilat hartohen nga departamentet, miratohen nga Këshilli i Fakultetit dhe në përfundim marrin miratimin e Senatit Akademik. Në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në kurrikulat e programeve të studimit, departamentet hartojnë planin mësimor të vitit, i cili miratohet nga Këshilli i Fakultetit dhe nga Rektori. Për çdo kurs hartohen programet mësimore (syllabus). Për çdo program studimi të ciklit të parë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 22 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një discipline apo veprimtari tjetër formuese,

duke realizuar provime të integruara për më shumë se një disiplinë apo module të koordinuara. Për çdo program studimi të ciklit të dytë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 14 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një discipline apo veprimtari tjetër formuese.

Neni 49

Tekstet mësimore

Tekstet mësimore të rekomandueshme për pjesën teorike dhe të detyrueshme për seminarët, ushtrimet dhe punët laboratorike duhet të miratohen nga departamenti, me propozimin e titullarëve të lëndëve. Këto u bëhen të njohura studentëve me fillimin e vitit akademik.

Neni 50

Elementët e studimeve

Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë format kryesore të punës janë leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare të kursit, esetë dhe temat e diplomës. Departamentet, me miratimin e dekanatit, mund të përcaktojnë edhe forma të tjera të punës mësimore, veçanërisht të kontrollit të dijeve të fituara. Puna mësimore zhvillohet në bazë grupi e kursi, në bazë të normave të punësmësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ndarja e orëve mësimore sipas elementëve të mësipërme të studimit për çdo kurs, përcaktohet bazë të krediteve që i janë caktuar disiplinës (kursit apo lëndës përkatëse) dhe pasqyrohen në planet mësimore.

Neni 51

Orari mësimor

Orari i përgjithshëm i universitetit shpallet përpara fillimit të semestrit. Çdo fakultet ka orar të veçantë. Orari është i detajuar dhe përcakton auditorin, kohën dhe ditët e zhvillimit të mësimin, pedagogët



mësimdhënës, dhe mund të ndryshojë në çdo kohë nga dekani ose përgjegjësi i departamentit, si është përcaktuar në nenet 23 dhe 24 të kësaj rregulloreje. Dekani duhet të njoftojë rektorin për ndryshimet, i cili më tej bën miratimin e tyre. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit e universitetit. Orari mësimor ndërtohet mbi bazën e harmonizimit të elementëve të mësimin dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit. Kjo ngarkesë luhatet nga 20–25 orë në javë. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta.

Neni 52

Ndarja e studentëve në klasa

Ndarja e studentëve në grupe leksionesh dhe seminaresh bëhet nëpërmjet regjistrimit online në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Univlora (SMI-Univlora). Me përfundimin e procesit të regjistrimit listat e studentëve të ndarë në klasa leksionesh, seminaresh apo çdo forme tjetër mbahen nga sekretaritë mësimore. Në regjistrimin e studentëve dhe ndarjen e tyre në grupe leksionesh dhe seminaresh apo çdo forme tjetër të marrjes së dijeve, mund të vendosen kritere akademike, me qëllim ndarjen e niveleve të ndryshme të studentëve, në funksion të cilësisë. Këto kritere miratohen nga Senati Akademik.

Neni 53

Frekuentimi i orëve mësimore dhe detyrimi i paraqitjes në provim

Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%. Çdo pedagog përcakton në syllabusin e kursit detyrimin për frekuentimin e orëve mësimore dhe përgjigjet drejtpërdrejt për saktësinë e informacionit mbi frekuentimin. Listat e studentëve me prezencën në auditor dorëzohen pranë sekretarive mësimore. Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe nuk respekton detyrimet për frekuentimin të përcaktuara në syllabus, atëherë studenti skualifikohet nga mungesat, nuk futet në provim, në

procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet. Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet dhe në procesverbalet e provimeve të pjeshme nëse studenti ka plotësuar mungesat. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e rradhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjeshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundert do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët e të gjithë cikleve nuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore. Sekretaritë mësimore përgjigjen për administrimin e informacionit mbi frekuentimin e studentëve.

Neni 54

Sekretaria mësimore dhe regjistri themeltar

Sekretaritë mësimore të fakulteteve dhe departamenteve duhet të mbajnë regjistër bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme. Sekretaria mësimore e çdo fakulteti apo departamenti përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar (bazë) të shkruar me dorë dhe me kompjuter. Regjistri themeltar plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Në sekretarinë mësimore depozitohen të firmosura nga anëtarët e personelit akademik në kohen e duhur lista e studentëve të regjistruar në kursin përkatës e ndarë në leksione dhe seminare me informacionin për mungesat si dhe



proces-verbalet e vlerësimeve në provimet e pjesshme dhe përfundimtare të kurseve, dhe çdo informacion tjetër që kërkohet për të konfirmuar realizimin e procesit të mësimdhënies, i firmosur ky i fundit nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit. Sekretaret mësimore mbajnë edhe detyrën e sekretares së departamentit dhe ndër të tjera kanë për detyrë të informojnë me shkrim për çdo çështje apo problem, sa herë që u kërkohet me një urdhër me shkrim ose me gojë, nga autoritet drejtuese të çdo niveli. Çdo studenti me regjistrimin fillestar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, i jepet një numër unik matrikullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës, duke respektuar edhe udhëzimet e Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Neni 55 **Drejtoria e Informacionit dhe** **Teknologjisë**

Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë publikon afatet e regjistrimeve, rregullat dhe udhëzimet përkatëse se si do të zhvillohen regjistrimet online në Sistemin e manaxhimit të Informacionit Univlora (SMI- Univlora), duke evidentuar faktin se mospagimi i detyrimeve është penalitet për regjistrimin në kurset e semestrit pasardhës. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë pajis studentët me emrin identifikues dhe fjalëkalimin për të kryer regjistrimin në sistemin online. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë ka në varësi të saj të drejtpërdrejtë sekretaritet mësimore në lidhje me çështjet e regjistrimeve, mbajtjes dhe përditësimit të të dhënave të studentëve ku përfshihen gjeneraliteti dhe notat, hartimin, plotësimin dhe përgatitjen e diplomave. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë varet direkt nga Rektori.

KREU VI:
TRANSFERIMET, EKVIVALENTIMI DHE
NDËRRIMI I FORMËS SË STUDIMEVE

Neni 56 **Transferimet e studimeve**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron mundësi për transferime të studentëve në vite të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë, si dhe transferime nga një formë studimi në një formë tjetër. Këto transferime bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e vendosura. Të gjitha transferimet miratohen nga Rektori. Për procedurat e ripranimeve, transferimeve dhe regjistrimeve në programe të dyta studimi, me vendim të rektoratit ngrihet komisioni përkatës i përhershëm në nivel institucioni. Përbërja e komisionit ndryshohet me vendim të rektorit. Në çdo departament, me urdhër të dekanit ngrihen komisionet e ekuivalentimit dhe vlerësimit të cilat miratohen prej tij. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka të drejtë t'i mohojë të drejtën për transferim çdo studenti mbi kriteret akademike. Procedurat transferuese përfundojnë përpara fillimit të vitit akademik. Të drejtën për transferime studimesh e kanë studentët që kanë siguruar të paktën 30 kredite. Të gjitha llojet e transferimeve bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit duke plotësuar një formular tip. Ky formular publikohet në faqen zyrtare të universitetit së bashku me informacionin e nevojshëm. Kërkesat për transferime pranohen dhe administrohen në Zyrën e Marrëdhënive me Studentet gjatë gjithë vitit akademik deri në 10 Shtator të çdo viti, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga aktet e tjera nenligjore. Më tej, këto kërkesa i përcillen Zyrës Akademike.

Neni 57 **Transferimi për në institucione të tjera**

Kërkesat e studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të cilët duan të transferohen në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën program dhe sistem, nëpërmjet zyrës akademike i përcillet rektoratit jo më vonë se data 15 Shtator e çdo viti. Pas miratimit propozimet u përcillen



universiteteve përkatëse shoqëruar me dokumentacionet e nevojshëm për vlerësim. Pas përgjigjes së pranimit nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit që përmban: detyrimet e shlyera me notat përkatëse, dëftesa e shkollës së mesme, dokumentacioni i bursës dhe çdo dokumentacion tjetër. Studenti i transferuar humbet statusin e studentit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Vendimi i transferimit i përcillet nga Rektorati, Zyrës Akadematike, Zyrës së Regjistrimit, sekretarive mësimore dhe Drejtorisë së IT-së për kryerjen e gjithë veprimeve procedurale të mëtejshme.

Neni 58

Transferimi nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë

Kërkesat dhe dokumentacionin e studentëve që duan të transferohen në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, zyra akademike ua përcjellë fakulteteve përkatëse jo më vonë se data 15 Shtator e çdo viti. Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit, i ngritur pranë çdo departamenti, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studentit, nëse pranohet në atë degë, sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit brenda 3 diteve i përcjell dekanit të fakultetit listën e studentëve të propozuar që plotësojnë kriteret e transferimit. Dekani i përcjell këtë listë zyrës akademike dhe për dijeni Rektorit. Zyra akademike administron gjithë propozimet e njësive kryesore dhe i përcjellë ato Brenda datës 20 Shtator pranë komisionit përkatës të ripranimeve, transferimeve dhe regjistrimeve në programe të dyta studimi, i cili pas shqyrtimit i dërgon propozimet rektorit. Vendimin për pranimin e studentëve të propozuar për transferim e merr Rektori duke patur parasysh mundësitë e kapacitetin e programit dhe ciklit të studimit sipas kuotave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave si dhe rezultatin e ekuivalentimit. Studentët që kanë kryer një pjesë të studimeve në institucione të huaja të arsimit

të lartë, mund të transferohen në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në kërkesën e tyre dhe dokumentacionin që paraqesin. Pasi bëhet verifikimi për saktësinë e dokumentacionit, komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit përcakton detyrimet nëse studentit pranohet. Procedurat e mëtejshme janë të njëjta si në rastin e studentëve që kërkojnë transferim nga universitetet brenda vendit. Vendimi i transferimit i përcillet nga rektorati Zyres Akadematike, Zyrës së Regjistrimit, sekretarive mësimore dhe Drejtorisë së IT-së për kryerjen e gjithë veprimeve procedurale të mëtejshme. Transferimet e studentëve brenda vetë institucionit mund të bëhen vetëm për programe të përafërta studimi. Për këto transferime ndiqet e njëjta procedurë si në rastin e studentëve që kërkojnë transferim nga universitetet brenda vendit, duke patur parasysh mundësitë dhe kapacitetin e programit dhe ciklit të studimit sipas kuotave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave si dhe rezultatin e ekuivalentimit. Të gjitha transferimet bëhen sipas akteve ligjore dhe nenligjore të miratuara nga MAS.

Neni 59

Ndërrimi i formës të studimeve

Kalimi i studentëve nga forma studimeve me kohë të plotë në formën e studimeve me kohë të pjesshme, për profile studimesh që mbulon fakulteti, bëhet me vendim të rektorit, pas propozimit të dekanit të fakultetit përkatës. Kjo lëvizje bëhet me kërkesë të studentit të interesuar, pasi ai të ketë fituar të paktën 30 kredite nga viti paraardhës. Kalimi i studentëve nga forma e studimeve me kohë të pjesshme në formën e studimeve me kohë të plotë, kur ketë mundësi e lejon natyra e fushës përkatëse të diplomimit, bëhet me vendim të Rektoratit, pas propozimit të dekanit të fakultetit përkatës. Kjo bëhet me kërkesë të studentit të interesuar, pasi ai të ketë përfunduar vitin e parë dhe të ketë notë mesatare mbi 7 (shtatë). Në të dy rastet e kalimeve të përmendura më sipër duhet të mos cënohet numri i kuotave të studentëve



në ciklet dhe programet përkatëse i caktuar nga aktet nënligjore përkatëse. Kërkesa për ndërrimin e formes së studimit së bashku me dokumentacionin përkatës, dorëzohen pranë dekanateve në fillim të vitit. Kur procedura ka përfunduar, studenti, i cili ka ndërruar sistemin e studimit nuk ka të drejtë të kthehet më në sistemin e mëparshëm. Njësoj si në rastet e transferimeve vendimi i ndërrimit të formës së studimit i përcillet nga rektorati i zyrës akademike, zyrës së regjistrimit, sekretarive mësimore dhe Drejtoria e IT-së për kryerjen e gjithë veprimeve procedurale të mëtejshme.

KREU VII KONTROLLI I DIJES

Neni 60 **Sistemi i vlerësimit**

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10. Nota më e ulët kaluese është nota 5 (pesë). Në procesverbalet e vlerësimit përfundimtar për studentin jo kalues (ngelës) vendoset nota 4 (katër). Në të gjitha format e kontrollit të dijes përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë.

Neni 61 **Rregullat e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimi**

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet, me shkrim, me gojë ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet dy provimeve të pjesshme, një provimi final si dhe formave të tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. Në ciklin e dytë të studimeve kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet një provimi të vetëm. Orari i provimeve finale duhet të shpallet para përfundimit të semestrit. Për semestrin e verës dhe sezonin e riprovimeve të dimrit

kontrolli i dijeve realizohet vetëm nëpërmjet një provimi final. Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimtar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në note etj, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs. Kur kontrolli i dijeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet dy provimeve të pjesshme, një provimi final si dhe formave të tjera të vlerësimit, pesha (përqindja) e provimit final në çdo rast duhet të jetë më e vogël se pesha (përqindja) që i nevojitet studentit për të marrë notën kaluese 5 (pesë). Jo me shume se 10% e vlerësimit përfundimtar mund të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale, apo forma të tjera të vlerësimeve gjatë vitit, të gjitha së bashku. Në rastin kur studenti nuk merr pjese në një provim, por paraqet dokumentacion ku justifikon arsye të forta si probleme shëndetësore serioze (psh. shtrim në spital, aksident të rëndë), raste të jashtëzakonshme fatkeqësish familjare, apo raste urgjencash publike, vendimin për një mundësi tjetër për dhënien e provimit e merr dekani i fakultetit përkatës, duke u bazuar në kërkesën me shkrim së paraqitur nga studenti. Dekani ka të drejtë të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar mungesën. Kurset janë të gjitha semestrale. Nëse studenti nuk kualifikohet, pra ka shënim mungesë (m) në proceverbalin përfundimtar të kursit, ai ka të drejtën dhe detyrimin ta frekuentojë përsëri atë, në semestrat pasardhës kur kursi ofrohet. Nëse kursi për arsye të ndryshme nuk do të ofrohet më (psh. ndryshimet e mundshme në kurrikula), studenti ka të drejtë të frekuentojë kursin përkatës zëvendësues. Kështu, krahas kurseve të përcaktuara në planet semestrale, studenti ka të drejtë të frekuentojë njëkohësisht edhe kurse të tjera ku figuron mbetës nga semestrat paraardhës, por duke respektuar rregullat e numrit të krediteve të regjistruara në një semestër dhe rregullat e përgjithshme të

regjistrimit. (shih nenin 77) Tezat e provimit në të gjitha kontrollet hartohen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut. Pas përfundimit të çdo provimi apo formave të tjera të kontrollit të dijeve, rezultatet editohen në SMI-Univlora jo më larg se 48 orë nga dita e zhvillimit të tij. Një ditë pas shpalljes së rezultateve, pranohen dhe vlerësohen ankesat e studentëve dhe printohet procesverbali nga SMI-Univlora, firmoset nga lektori dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore në 4 (katër) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje qëndron në sekretarinë e departamentit, 1 (një) kopje në kryesekretarinë e fakultetit, 1(një) kopje në Zyrën e Regjistrimit dhe 1 (një) kopje në Zyrën Akadematike. Në raste paqartësish, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në presence të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim përgjegjësit të departamentit që mbulon kursin përkatës. Kur studenti në provim vlerësohet me notën 4 (katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), ai ka të drejtën të regjistrohet për të shlyer këtë lëndë vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve në dimër dhe në një semestër tjetër vetëm kur është student në ciklin e parë të studimeve dhe ka siguruar të paktën 110 kredite. Regjistrimi në këtë rast do të bëhet sipas rregullit të përgjithshëm të regjistrimit të përcaktuar në nenin 77 të kësaj rregulloreje. Në fund të çdo provimi, testet dhe çdo material i provimit dorëzohet në sekretarinë e departamentit përkatës, mbyllet në një zarf të mbi të cilin të jenë shkruar të gjitha të dhënat e nevojshme dhe firmoset nga lektori. Zarfet me testet e provimeve të arkivuara në sekretarinë e departamentit, mund të hapen dhe të kontrollohen vetëm në rast ankimi ose shihet e arsyeshme nga autoritetet drejtuese. Këto materiale ruhen deri në fund të provimeve të semestrit pasardhës e më pas ato digjen.

Neni 62

Ankimi për rezultatin përfundimtar

Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Ndryshimet në rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin të ri të firmosur nga komisioni i cili i bashkelidhet procesverbalit të mëparshëm dhe në SMI-Univlora.

Neni 63

Përmirësimi i notës

Studentët e ciklit të parë kanë të drejtë të përmirësojnë notën në çdo lëndë, por jo më shumë se katër përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve dhe jo më shumë se dy përmirësime në një vit akademik. Për studentët e ciklit të dytë ky rregull është për jo më shumë se dy përmirësime gjatë gjithë periudhës së studimeve. Përmirësimet e notës bëhen vetëm në semestrin e verës, sezonin e riprovimeve të dimrit si dhe në datat e percaktura nga dekan i fakultetit para mbrojtjes së diplomes, kundrejt një tarife të miratuar. Është detyra e tij të regjistrohet në kurset që do të përmirësojnë notën, pasi më parë ka bërë kërkesën në sekretarinë e departamentit, e cila e përcjell informacionin tek Drejtoria e IT-së për të mundur aksesin e studentit në regjistrimin e kursit. Kërkesa bëhet të paktën 10 ditë para fillimit të semestrit të verës, sezonit të riprovimeve të dimrit dhe mbrojtjes së diplomes. Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës së një lënde jo më shumë se një herë. Studentët duhet të jenë në dijeni se mbetet në fuqi nota e përsëritjes së fundit, e cila do të pasqyrohet në transkriptin e notave që tregojnë ecurinë akademike të studentit, pavarësisht nëse kjo është nota më e lartë apo jo. Nëse nota



e përsëritjes së fundit është 4 (katër) rregullat akademike për shlyerjen e detyrimeve nuk ndryshojnë. Në listën e notave që shoqërojnë diplomën do të pasqyrohen vetëm notat përfundimare kaluese (5,6,7,8,9,10)

Neni 64 Praktika profesionale

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale, kur ajo përfshihet në programin e studimit. Me fillimin e vitit akademik, departamenti u komunikon studentëve kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe shlyerjes së saj. Praktikën profesionale zhvillohen në institucione sipas proflit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studentit përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga pedagogu që e drejton praktikën pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.

KREU VIII: DIPLOMIMI

Neni 65 Mbrojtja e tezës së diplomës

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat e diplomimit janë paraqitur në kurrikulat e çdo programi studimi. Sekretaria mësimore është e detyruar t'i përcjellë me shpresë të veçantë përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit listën e studentëve që kanë plotësuar detyrimet e një program studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar të cilët kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës. Sekretaria mësimore mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave. Përgjegjësi i departamentit pas

marrjes së listës së studentëve ngre një komision ad hoc, i cili verifikon nëse këta studentë kanë plotësuar detyrimet e programit të studimit. Pas verifikimit lista e studentëve që kanë të drejtën e mbrojtjes së tezës së diplomës, e firmosur nga anëtarët e komisionit, i përcillet përgjegjësit të departamentit. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë, për fitimin e diplomës parashikohet përgatitja e një teze diplome ose punimi të pavarur. Për fitimin e diplomave të ciklit të dytë të studimeve parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë krijuese e të pavarur nga studentit. Drejtuesit e temave të diplomës miratohen nga departamenti sipas kritereve të përcaktuara në aktet nënligjore. Mbrojtja e diplomës bëhet e hapur. Procedura e mbrojtjes përfshin një paraqitje të pëmbledhjes së punimit të diplomës, pyetje dhe përgjigje. Në përfundim juria bazuar në vlerësimin e udhëhëqësit dhe punimin e studentit, bën vlerësimin me notë. Juria dhe kryetari i saj miratohet nga dekani i fakultetit me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe përbëhet nga 5(pesë) vetë. Shlyerja e detyrimeve të programit të studimit dhe çdo detyrimi tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit, është kusht paraprak për kryerjes e mbrojtjes së tezës së diplomës. Përgjegjësi i departamentit i përcjellë dekanit të fakultetit listën e studentëve të diplomuar. Dekani nëpërmjet një shkrese e përcjellë këtë listë Zyrës së Regjistrimit për të përgatitur diplomat përkatëse. Diplomimi në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve bëhet gjatë gjithë vitit akademik, datat dhe afatet përcaktohen nga dekani i fakultetit, duke mos krijuar pengesa në kohë për studentët që diplomohen. Kandidati që rrëzohet në mbrojtjen e diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në një datë të caktuar nga dekani i fakultetit në semestrin pasardhës.

Neni 66 Pajisja me diplomë

Studentët që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit



pajisen me diplomë e cila është një document zyrtar. Diplomat e ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës. Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës dhe Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Respektivisht sipas cikleve lëshohen diplomat:

Cikli i parë i studimeve:

1. Diplomë "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer

Cikli i dytë i studimeve:

1. Diplomë "Master Profesional" në fushën e arsimit të kryer

2. Diplomë "Master i Shkencave" në fushën e arsimit të kryer

Cikli i tretë i studimeve:

1. Diplomë për gradën shkencore "Doktor"

Neni 67

Tërheqja e diplomës

Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit është objektivist e pamundur, tërheqjen e diplomës mund t'a bëjë një nga pjesëtarët e familjes, i pajisur me prokurë të posaçme e cila bashkëngjitet në regjistrin e tërheqjes së diplomave, duke paraqitur dhe një dokument identifikimi të tij. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheq atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet ai duke iu bërë i papërdorshëm, universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e listës së

notave të fituara dhe vërtetim me fotografi i cili është ekuivalent me diplomën, pasi nënshkruhet nga Rektori i universitetit, dekani dhe përgjegjësi i zyrës së regjistrimit. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Diploma e plotësuar në mënyrë të parregullt, asgjësohet me një komision të përbërë prej tre anëtarësh të caktuar me urdhër të dekanit me hartimin e procesverbalit përkatës, i cili depozitohet në zyrën e regjistrimit, përpara se i interesuari të pajiset me vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën. Nëse një shtetas i diplomuar në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë rezulton me dy dokumente diplomimi, diplomë origjinale dhe vërtetim me fotografi ekuivalent me diplomën, do të quhet i vlefshëm dokumenti i lëshuar në datën më të vonë. Në Universitetin "Ismail Qemali" e Vlorës dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni të përgjithshme për të gjithë fakultetet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori, në prani të përfaqësuesve të Senatit Akademik, të profesoratit, administratës dhe studentëve.

KREU IX:

STATUSI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTIT

Neni 68

Marrja e statusit të studentit

Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe humbet me marrjen e diplomës ose çertifikatës përkatëse, si dhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen bazuar në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Statut dhe në këtë Rregullore. Nëse nuk regjistrohet në afatin, mënyrën e përcaktuar dhe kriteret e tjera të përcaktuara me udhëzime të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë nuk merr përsipër ruajtjen e të drejtës së studimit.

Neni 69 **Përfundimi dhe heqja e statusit**

Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës. Statusi hiqet me ç'regjistrim në këto raste:

1. Me urdhër të dekanit bazuar në kërkesën e studentit për ç'regjistrim në formën e një deklarate të përpiluar para një noteri publik;
2. Me urdhër të dekanit/ kur vërtetohet se i kanë munguar ose ka humbur kushtet dhe kriteret për të drejtën e studimit;
3. Kur dënohet me burgim për një krim të rëndë, me dashje ose përsëritje;
4. Kur braktis pa shkak studimet dhe pa u ndjekur procedurat për ndërprerjen e studimeve;
5. Me urdhër të dekanit, pas konsultimit me këshillin përkatës të studentëve për shkelje të rëndë ose të përsëritur të kësaj Rregulloreje ose rregulloreve të tjera.

Neni 70 **Të drejtat e studentëve**

Studenti ka të drejtë:

1. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij.
2. Të përdorë pajisjet, bazen materiale dhe laboratorike të universitetit sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën dhe mjediset sportive e kulturore të universitetit.
3. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, si në Senatin Akademik, në Këshillin e Administrimit, në Këshillat e Fakulteteve ku janë të regjistruar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit.
4. Të organizohet në shoqata të ndryshme jopolitike në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse.
5. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit kur plotëson kushtet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare.
6. Të përfitojë shpërblime të veçanta që akordohen nga Universiteti "Ismail Qemali"

Vlorë sipas ligjit dhe kriterëve të caktuara nga Senati Akademik.

7. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit
8. Të ankohet për shkelje të rregullave dhe standarteve akademike nga ana e pedagogëve, të mosrealizimit të procesit të mesimdhënies, të rregullave të zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin e tij të pamërituar.
9. Të ankohet për shkelje të etikës akademike, të konfliktit të interesit dhe të çdo rasti tjetër që cënon integritetin e studentit.
10. Të ndjekë studimet në një degë të dytë, në sistem të ndryshëm nga ai që ndjek, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, në vendimet e Senatit apo në aktet e posaçme të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.
11. Të drejta të tjera të studentëve janë përcaktuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës dhe në këtë Rregullore.

Neni 71 **Detyrat e studentëve**

Studenti është i detyruar:

1. Të njohë me hollësi statutin, rregulloren e universitetit dhe çdo rregullore tjetër e detyrimit që linden për të dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre; në të kundërt, universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
2. Të njohin të gjitha kërkesat e përgjithshme të universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë;
3. Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për arsimin e lartë;

4. Të respektojë Kodin e Etikes së universitetit.
5. Të shlyejë detyrimet e përcaktuara në programin e studimit si dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material ndaj universitetit;
6. Të shlyejë të gjitha detyrimet financiare të parashikuara në ligj.
7. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të universitetit nga ana e tij; dëmet material që ai mund të ketë bërë zhdëmtohet në masën e përlogaritur.
8. Detyra apo përgjegjësi të tjera të studenteve janë përcaktuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës dhe në këtë Rregullore.

Neni 72

Organizimet studentore

Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve në universitet, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këta këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të universitetit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo vit nga votat e studentëve në semestrin e dytë të çdo viti akademik dhe mbështeten në legjisllacionin në fuqi. Këshillat e studentëve organizohen në nivel fakulteti (këshilli i studentëve të fakultetit), në nivel universiteti (Këshilli i Studentëve të UV) dhe në nivel kombëtar (Këshilli Kombëtar i Studentëve). Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në statutin dhe rregulloren e tyre, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe me këtë Rregullore. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të

drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

Neni 73

Veprimtaria jashtë-mësimore

Studentët kryejnë veprimtari jashtëmësimore me karakter kulturor, shkencor, sportiv e zbavitës, në vende, kohë dhe përmbajtje të lejueshme. Veprimtari të tilla nga studentët e një fakulteti në ambjentet e fakultetit mund të kryhen vetëm me lejen e autoritetit drejtues përkatës, ndërsa në nivel universiteti me leje të Rektorit. Aktivitete me karakter demonstrativ ose proteste lejohen vetëm me leje nga Rektori, me kërkesë të shoqatave të tyre, të njohura ligjërisht, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 74

Masat disiplinore për studentët

Shkelje e rregullave të universitetit konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çenojnë personalitetin e personelit akademik, të çdo punonjësi tjetër të universitetit dhe çdo student, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, fyerjet, sharjet, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim;
- paralajmerim për pezullim ose perjashtim nga universiteti;
- pezullimin nga universiteti për një semester ose një vit;
- përjashtim nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë



• përjashtim përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë Vendimin për "Vërejtje me shkrim", "Paralajmërim për pezullim ose përjashtim nga universiteti" dhe "Pezullim nga universiteti për një semester ose një vit" e merr dekanati përkatës. Në raste të veçanta të parashikuara në Kodin e Etikës këto vendime mund të merren nga Rektorati. Vendimin për "Përjashtimin nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë" (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe "Përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëposhme) e merr Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë mbi bazën e propozimit të dekanatit përkatës. Masa disiplinore merret pasi bëhen verifikimet e nevojshme për shkëlqen dhe ndiqen procedurat konform, statutit, kësaj rregulloreje dhe Kodit të Etikës. Masat disiplinore pasqyrohen në regjistrin e studentëve dhe administrohen nga zyra akademike. Studenti konsiderohet i rehabilituar, nëse nuk bën shkelje tjetër me kalimin e tre muajve për vërejtjen, brenda 6 muajve për paralajmërimin dhe një viti për pezullimin.

KREU X RREGULLA DHE PROCEDURA AKADEMIKE

Neni 75 **Sistemi i kurseve dhe i krediteve**

Vlera në kredite për çdo kurs (numri në kllapa që pason titullin e kursit në katalog) përcaktohet në orë semestrale. Një orë semestrale është e barazvlefshme me një total prej 60 minutash mësimdhënieje të programuar për çdo javë plus kohën e kërkuar për përgatitje të pavarur jashtë klase. Shumica e kurseve në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë kanë 8 kredite.

Neni 76 **Pozita e studentit**

Për qëllime regjistrimi dhe pagesash të tarifave, pozita e studentit përcaktohet në bazë të numrit të krediteve. Studenti

konsiderohet në vitin e dytë nëse ka siguruar jo më pak se 30 kredite, dhe konsiderohet në vit të tretë nëse ka siguruar të paktën 90 kredite.

Neni 77 **Rregullat e regjistrimit dhe organizimi i kurseve**

Studentët e çdo programi studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë regjistrohen online nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Univlora (SMI-Univlora) në kurset që i ofrohen sipas planit mësimor të sugjeruar. Regjistrimi mbyllet me përfundimin e javës së dytë të semestrit të vjeshtës ose pranverës. Çdo lëndë apo kurs ka kodin e vet të përbërë nga tre shkronja që tregojnë disiplinën apo fushën e studimit, dhe një numër treshifror që tregon se për studentet e cilit vit janë hartuar këto kurse. Kurset me numra 100-199 janë kurse universitare hyrëse dhe i përkasin lëndëve të programeve të studimit që janë planifikuar për studentë të vitit të parë. Kurset me numra 200-299 janë të hartuara për studentë të vitit të dytë, ndërsa kurset me numra 300-399 janë të hartuara për studentë që janë në vitin e fundit të diplomimit të ciklit të parë. Kurset me numër 400-599 u përkasin lëndëve të programeve të studimit të ciklit të dytë dhe kurset me numer 600 e lart janë lëndët e ciklit të tretë të studimeve të doktoratës. Çdo student në ciklin e parë të studimeve mund të regjistrohet për kurse deri 40 kredite në semestër, pasi më parë të regjistrohet në lëndët që ofrohen në atë sezon në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë. Bazuar në këtë rregull e drejta e plotësimit të krediteve të mundshme të regjistrimit në një semestër, i jepet vetëm për lëndët të cilat në transkript kanë shënimin mungesë (m). Nëse studenti i ciklit të parë ka siguruar gjatë kohës së studimeve të paktën 110 kredite, ai mund të regjistrohet në lëndë sipas rregullit të përgjithshëm (pra të regjistrohet paraprakisht në lëndët e reja, në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë më parë) dhe e



drejta e plotësimit të krediteve të mundshme të regjistrimit në një semestër, i jepet për të gjitha lëndët të cilat në transkript kanë shënimin mungesë (m), notën 4(katër) ose "NP" (Nuk u paraqit). Duke respektuar rregullin e përgjithshëm të regjistrimit të kurseve të përcaktuar në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni, çdo student i ciklit të parë i cili ka siguruar të paktën 30 pikë kredite, ka të drejtën e regjistrimit edhe në kurset me kodet e numrave 200-299 dhe nëse ai ka siguruar të paktën 90 pikë kredite, mund të regjistrohet në të gjitha kurset, përfshië edhe ato të vitit të tretë të studimeve në programin përkatës. Studentët e ciklit të dytë të studimeve regjistrohen në lëndët që ofrohen në atë sezon sipas planit mësimor të sugjeruar, në të cilat nuk është regjistruar asnjëherë më parë. Kur studimet zgjasin përtej kohës normale të tyre, e drejta e plotësimit të krediteve të mundshme të regjistrimit në një semestër i jepet vetëm për lëndët që nuk ka frekuentuar të cilat në transkript kanë shënimin mungesë (m) dhe që ofrohen në atë sezon sipas planit mësimor. Universiteti rezervon të drejtën për ta anuluar një lëndë në të cilin ka regjistrime të pamjaftueshme duke garantuar në të njëjtën kohë që çdo student me opsionet që do t'i ofrohen të ketë mundësi të diplomohet brenda tre vjetësh. Disa kurse janë të ndërthurur (dmth. mbulojnë të njëjtin material) midis departamenteve. Në raste të tilla përshkrimi i kursit ndodhet vetëm tek njëri departament. Shënimi mbi këtë kurs në departamentin tjetër tregon se ky kurs është identik me kursin në departamentin e mëparshëm. Kur të regjistrohen, studentët duhet të zgjedhin kursin tek programi në të cilin ata dëshirojnë të marrin kredite për diplomim. Kodet e lëndëve të reja dhe ndryshimet e kodeve ekzistuese miratohen nga Rektori, mbi bazën e propozimeve të departamentit. Për regjistrimet në kurset të cilat në transkript kanë shënimin mungesë (m), notën 4(katër) ose "NP" (Nuk u paraqit), apo kur studimet zgjasin përtej kohës normale të tyre, mund të aplikohen tarifa mbi bazën të numrit të krediteve të regjistruara dhe në varësi të ciklit të

studimeve dhe rasteve të veçanta, pasi këto tarifa janë aprovuar më parë.

Neni 78

Ndjekja e kurseve jashtë programit të studimit

Çdo student në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë mund të regjistrohet në kurse të cilat nuk janë pjesë e programit të studimit që ai ndjek, vetëm me lejen me shkrim të dekanit të fakultetit përkatës duke respektuar rregullorat e përgjithshme të regjistrimit.

Neni 79

Tërheqja e studentëve nga kursi

Nëse studentët vendosin të tërhiqen nga një lëndë, ata mund të tërhiqen pa penalizim akademik deri në javën e tretë për kurset e semestrit të vjeshtës dhe pranverës, ndërsa deri në javën e parë për kurset e semestrit të verës.

Neni 80

Dëgjimi i kurseve

Një opsion formal dëgjimi është në dispozicion të studentëve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në një kurs jo me qëllim marrje diplome. Me leje të shkruar nga pedagogu i lëndës, pa u regjistruar studentët mund të ndjekin për të dëgjuar një kurs gjatë një semestri.

Neni 81

Përsëritja e kurseve

Studenti është i detyruar të përsërisë një kurs nëse ai nuk e ka frekuentuar atë, dhe shënimi në transkript është mungesë (m). Studenti mund të ripërsërisë kursin sipas rregullit të përgjithshëm të regjistrimit në nenin 77 të kësaj rregulloreje. Studenti nuk është i detyruar të përsërisë një kurs të një lënde me zgjedhje (jo e detyrueshme për diplomim), nëse ka shënim mungese (m) apo nota e fituar në një regjistrim të mëparshëm është 4(katër). Studenti duhet të përsërisë një kurs të një lënde të tillë vetëm nëse nuk ka mundësi tjetër zgjedhje

nga ai grup lëndësh, gjithnjë sipas rregullit të përgjithshëm të regjistrimit. Studentët e transferuar, të cilët kanë ardhur me kredite të transferuara për një kurs të caktuar, nëse e përsërisin këtë kurs me sukses në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, do t'i humbasin kreditet e mëparshme që i kishin të transferuara nga institucioni tjetër.

Neni 82 **Rregullat e sjelljes akademike**

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjellje gjatë provimeve.

2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër duke i konsideruar ato të veta.

3. Mashtrim në raporte laborator duke falsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.

4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

Pedagogët duhet të respektojnë standartet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

1. Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.

2. Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.

3. Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar si jo të ndershme tek dekani për t'u konsideruar me tej nga Zyra Akademike.

4. Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laborator, të fallsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të pandershme akademike prane Zyrës Akademike. Studentët duhet të respektojnë standardet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

1. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.

2. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitohen një paraqitje të keqe të punës.

3. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.

4. Të evitohen aparençën e mashtrimit (të lënit përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikën e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'i përcjellin këtë mesazh përgjegjës të departamentit, dekanit ose t'i drejtohen me ankesë të drejtëpërdrejtë Rektorit. Raste të tilla do të gjykohen dhe vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi.

Neni 83 **Përgjegjësi të tjera të personelit akademik**

Përgjegjësitë e pedagogut përfshijnë ndër të tjera, por pa qenë të kufizuara, dhe këto si më poshtë:

1. Pedagogu duhet t'i zhvillojë orët e mësimi dhe provimet në orën dhe vendin e përcaktuar zyrtarisht.

2. Çdo pedagog duhet të jetë në dispozicion në zyrën e vet në konsultim me studentët për një numër të arsyeshëm orësh çdo javë dhe duhet t'i bëjë të njohura këto orë.

3. Pedagogu duhet të bëjë të njohur në fillim të çdo kursi objektivat dhe natyrën e kursit,

datat e ngjarjeve të rëndësishme (p.sh. testimet, detyra kursi), mënyra dhe sisteme të vlerësimit, frekuentimi i orëve të mësimi, provime, detyra dhe aktivizim në klasë.

4. Pedagogu duhet të sigurohet që përmbajtja e kursit që ai jep të jetë në përputhje me përshkrimin e kursit në katalogun e universitetit.

5. Pedagogu duhet të respektojë rregulloren e e Universitetit në lidhje me të drejtat e studentëve.

6. Pedagogu duhet të frekuentojë takimet e detyruara nga procedurat e njësive akademike në lidhje me ankesat e studentëve.

7. Pedagogët duhet të mos përdorin auditorin me studentë për veprimtari që nuk lidhen me mësimdhënien dhe të mos përcjellin mesazhe personale për kolegët dhe autoritetet drejtuese.

Neni 84

Përgjegjësi të tjera të studentëve

Përgjegjësitë e studentit përfshijnë ndër të tjera, por pa qenë të kufizuara, dhe këto si më poshtë:

1. Studenti duhet të dijë dhe të zbatojë politikat e pedagogut në lidhje me frekuentimin, testimet, detyrat e kursit dhe aktivizimin në klasë.

2. Studenti duhet t'i drejtojë ankesat akademike në lidhje me një orë mësimi në kanalet e sipërpërmenduar.

3. Me kërkesën e pedagogut të vet, studentit duhet të konsultohet me pedagogun në një kohë të përshtatshme për të dyja palët.

4. Studenti duhet të marrë pjesë në takimet e detyruara nga procedurat e njësive akademike në lidhje me ankesat.

Neni 85

Këshillimi akademik

Roli dhe misioni i udhëheqjes profesionale dhe akademike në fakultetet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është të këshilloi studentët, ndërsa këta të fundit përipiqen të arrijnë qëllime akademike, synime të jetës apo të karrierës si dhe përpilojnë plane për t'i arritur këto synime. Ky është një proces i

vazhdueshëm zbulimi, qartësimi dhe vlerësimi, në të cilin udhëheqësit akademikë i ndihmojnë studentët të dallojnë mundësitë e paraqitura, duke vlerësuar alternativat e mundshme, si dhe duke peshuar pasojat e vendimeve të caktuara. Këshilltarët akademikë të fakultetit janë në dispozicion në çdo departament. Për ndihmë në të kuptuarit të kërkesave të universitetit dhe të programit studimit studentët duhet të konsultohen me këshilltarët akademikë të fakultetit. Ndërsa studentët marrin ndihmë gjatë këshillimit orientues fillestar ata duhen nxitur që të kërkojnë ndihmë individuale sa më herët që të jetë e mundur në programet e tyre, si dhe që nga ai moment të shkojnë e të takohen rregullisht me këshilltarët e tyre akademik. Këshilltarët akademikë mund t'i ndihmojnë studentët të përpilojnë planin e tyre të studimit, si dhe të verifikojnë që të gjitha detyrimet e kursit të shlyhen në kohën e duhur apo t'i orientojnë për zgjidhjen e çdo problemi tjetër akademik.

Neni 86

Vlerësimi dhe Anketimi

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është i përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve të veta përmes një procesi të pandërprerë vetëvlerësimi të lidhur me hapa konkrete drejt përmirësimit. Ky proces vlerësimi përfshin pyetësorë, para dhe post-teste, grupe fokusi dhe intervista. Formulari i anketimit hartohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe miratohet nga Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies realizohet edhe përmes vlerësimit të marrjes së dijeve të studentit. Të gjitha programet e diplomimit kanë një strukturë të posaçme synimesh dhe objektivash të cilat studentët duhet të arrijnë në përfundim të programit. Përcaktimi deri në ç'masë studentët po i arrijnë objektivat e programit të tyre kryhet përmes aktiviteteve vlerësimi të zhvilluara përgjatë gjithë vitit akademik. Rezultatet e aktiviteteve të vlerësimit përdoren për të përmirësuar programet dhe për të bërë ndryshime në kurrikula në



mënyrë që të maksimizohet marrja e dijeve nga ana e studentit. Rezultatet e vlerësimeve shërbejnë për të informuar departamentet deri në ç'masë kurrikulumi i tyre aktual (kurset, kushtet për diplomim, si dhe të tjera aktivitete të ofruara nga programi) i pajisë studentët me mjetet e nevojshme për të pasur sukses në profilin e tyre. Vlerësimi shërben gjithashtu edhe për të matur aftësinë e kurseve të formimit të përgjithshëm dhe të aktiviteteve të tjera për t'i dhënë studentit një shumëllojshmëri të gjerë njohurish të përgjithshme dhe mjeshtërisht të domosdoshme për sukses në çdo karrierë gjatë gjithë jetës. Aktivitetet e ndryshme të vlerësimit krijojnë mundësinë që njësitë përkatese të përcaktojnë e të krahasojnë cilësinë e programeve të tyre nga viti në vit, si dhe të masin suksesin e ndryshimeve kurrikulare që hartohen për të pëmirësuar cilësinë e programit. Rezultatet e vlerësimit përdoren edhe për të identifikuar nevojat e programit, si dhe për të mbështetur kërkesa për burime shtesë. Studenti do të marrë pjesë herë pas here në aktivitete vlerësimi si pjesë e kërkesave të programit të diplomimit. Disa aktivitete vlerësimi mund të përfshijnë: pyetësorë për studentët, provime, vlerësime detyrash e projektsh kursit, intervista hyrjeje dhe daljeje, si dhe dosje të punës së studentit gjatë programit të diplomimit. Aktivitetet që zhvillohen janë të ndryshme për çdo program diplomimi, pasi secili program ka një strukturë të veçantë synimesh e objektivash. Këto aktivitete janë hartuar në mënyrë që të masin arritjen e objektivave të programit në mënyrën më të mirë të mundshme.

Neni 87

Probleme akademike dhe zgjidhja e tyre

Çdo njësi akademike duhet të respektojë procedurat për zgjidhjen e ankesave, në lidhje me vlerësimin, standartin dhe cilësinë e mësimdhënies, situatat brenda në klasë dhe çdo problem tjetër akademik. Për rastet e ankesave në lidhje me vlerësimin, ndihet ajo procedurë e përcaktuar në nenin 62

të kësaj rregulloreje. Për rastet që kanë lidhje me standardin dhe cilësinë e mësimdhënies, shkeljen e rregullave akademike, situata brenda në klasë dhe probleme të tjera akademike, studentët duhet t'ia paraqesin ankesën e tyre përgjegjesit të departamentit, dekanit dhe Rektorit. Në referencë të ankesës autoritetet drejtuese analizojnë dhe vlerësojnë rastin në fjalë dhe marrin masat organizative dhe disiplinore.

Neni 88

Probleme joakademike

Personeli i universitetit dhe studentët mund të hasin situata problematike gjatë kohës së punës apo të studimeve në universitetin "Ismail Qemali" Vlorë në të cilat mund të përfshihen rastet e fyerjeve, sharjeve, konfrontimeve fizike, qëndrimi diskriminues apo ngacmimi seksual, sharjet apo fyerjet raciale, sharjet për orintim seksual, ngjyrës, fesë, bindjes, origjinës kombëtare apo prejardhjes, gjendjes martesore, gjendjes familjare etj, janë specifike, kërkojnë vëmendje të veçantë në zgjidhjen e tyre.

KREU XI

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETIT

Neni 89

Mbrojtja e të dhënave

Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti bëhen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Udhëzimin nr. 07, datë 09.06.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit". Të dhënat personale mbahen në mënyrë manuale nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Regjistrimit si dhe në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit nga punonjësit përkatës të Drejtorisë së IT-së. Në rast se të dhënat personale do të mbahen nga persona të tjerë përgjegjës, ata do të përcaktohen me shkresë të vecantë.

Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, regjistrimin, ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave personale të subjekteve punëmarrës, personelit akademik dhe administrativ. Ky informacion në regjistrin përkatës përmban të dhënat për emrin, mbiemrin, atësinë, mëmësinë, datëlindjen, vendlindjen, vendbanimin, arsimin, profesionin, gradën apo titullin akademik, kombësinë, shtetësinë, gjendjen civile, numrin e sigurimit shoqëror, foto, numrin personal të kartës së identifikimit, aktiviteti profesional, CV-në etj. Në rastet e humbjes, shkatërrimit, fshirjes së këtyre të dhënave personi përgjegjës i zyrës ngarkohet me përgjegjësi. Zyra e Burimeve Njerëzore varet direkt nga Rektori dhe kryen veprimtarine e vet conform ligjit. Detyrat kryesore te Zyres se Burimeve Njerëzore përveç atyre të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore janë:

1. Realizon plotësimin e vendeve të punës në universitet.
2. Kryen procedurat standarte të konkurseve për marrjen në punë të personelit akademik dhe joakademik konform Statutit dhe Rregullores.
3. Ndjek ndryshimin e numrit të personelit akademik dhe administrativ, ndryshimet e pagave përkatëse dhe realizimin e tyre.
4. Ndjek procedurat ligjore të realizimit të specializimeve, kualifikimeve, të vitit sabbatik të punonjësve mësimor shkencor jashtë shtetit dhe mban dokumentacionin përkatës.
5. Ndjek daljet në pension të personelit të UV-së, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe të Sigurimeve Shoqërore në RSH dhe bën veprimet përkatëse.
6. Ndjek zbatimin e Kodit të Punës në RSH si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të Qeverisë për kohën e punës dhe të pushimit
7. Mban dokumentacion e plotë e të rregullt mbi të dhënat biografike, të kualifikimit të personelit të UV-së dhe në bazë të këtyre të dhënave bën propozime për sigurimin e burimeve njerëzore në institucion.
8. Harton planin e lejeve të zakonshme të personelit dhe ndjek zbatimin e tij.

9. Protokollon dhe mban të gjitha Vendimet e Rektorit të Universitetit të Vlorës.

10. Ndjek çdo ditë mbarëvajtjen në punë të punonjësve të administratës, kontrollojnë disiplinën në punë, mungesat, raportet mjekësore dhe koordinon punën me strukturat e tjera.

Zyra e Regjistrimit dhe sekretaritë mësimore të çdo njësie bazë dhe kryesore janë përgjegjëse për mbledhjen,

regjistrimin, ruajtjen, përditësimin dhe arkivimin e të dhënave personale të studentëve në mënyre manuale. Në Zyrën e Regjistrimit dhe sekretaritë mësimore ruhen në mënyre manuale të dhënat e studentëve:

- emri, atësia, mbiemri
- data dhe vendi i lindjes
- gjinia
- numri unik i matrikullimit
- kombësia dhe vendbanimi
- adresa
- kontaktet (numrat e telefonit, adresa e e-mail)
- zona e banimit të përhershëm
- referenca akademike
- të dhënat sensitive
- përparimi dhe statusi aktual
- rezultatet përfundimtare
- fotografi e studentit
- edukime apo kualifikime të tjera
- informacione demografike
- financimet, bursat dhe tarifat
- të dhënat mbi pagesat dhe të dhëna të tjera

Në rastet e humbjes, shkatërrimit, fshirjes së këtyre të dhënave personat e zyrës që kanë akses në këto të dhëna ngarkohen me përgjegjësi.

Detyrat kryesore të Zyres së Regjistrimit dhe sekretarive mësimore përveç atyre të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore, Statut dhe Rregullore, ndër të tjera:

1. Kryejnë procedurat e transferimeve të studentëve dhe çregjistrimit të tyre.
2. Adiministrojnë gjithë databazën e studentëve në formë të shkruar dhe elektronike dhe përgatisin diplomat dhe listat e notave.
3. Koordinojnë punën e vet me strukturat e tjera për realizimin e detyrave dhe objektiva në punë.

Drejtoria e IT-së është përgjegjëse për mbledhjen, regjistrimin, ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave personale të studenteve në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Univlora. Qëllimi primar i sistemit është menaxhimi i të dhënave të studentëve dhe përmirësimi i proceseve administrative dhe akademike të institucionit. Sistemi është pronësi e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe që nga muaji Shtator 2011 sistemi është në përdorim nga stafi akademik dhe administrativ si dhe nga studentët e Universtitetit. Sistemi është një sistem i integruar me arkitekturë modulare duke krijuar mundësi e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave të Universitetit dhe duke e bërë atë unik në përdorimin e tij për qëllimet tona. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka përcaktuar një person përgjegjës i cili menaxhon databazën e programit kompjuterik të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Univlora. Ai ka akses të plotë në këtë databazë dhe është personi përgjegjës për procese të tilla si: grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi i të dhënave personale që bëhen nëpërmjet këtij program kompjuterik. Në rastet e humbjes, shkatërrimit, bllokimit, fshirjes së këtyre të dhënave personale personi përgjegjës që ka akses në këto të dhëna ngarkohet me përgjegjësi. Çdo dokumentacion i bazuar në të dhënat e SMI Univlora, verifikohet me databazën në hardcopy (regjistrat e ndryshëm apo dokumenta të tjera) dhe merr formë ligjore kur nënshkruhet nga personi përgjegjës. Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë janë përcaktuar personat të cilët kanë akses në të dhënat personale manuale dhe ato në sistemin kompjuterik. Të gjithë personat që kanë akses në këto të dhëna kanë detyrë për të drejtat dhe detyrat e tyre në lidhje me këtë akses në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Udhëzimin nr. 07, datë 09.06.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit". Në Universitetin "Ismail

Qemali" Vlorë personat të cilët kanë të drejtë të përdorin SMI Univlora, ata që kanë akses në të dhënat, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre janë si më poshtë:

1. Rektori është njëkohësisht Administrator i Përgjithshëm i SMI Univlora dhe ka të drejtën e aksesit mbi të gjitha të dhënat në sistemin vetëm në formën e pandryshueshme pa të drejtën e editimit.
2. Dekani i fakultetit ka të drejtën e aksesit mbi të gjitha të dhënat e studentëve dhe kurseve të mësimdhënies të fakultetit përkatës vetëm në formën e pandryshueshme me të drejtën e editimit të orarit mësimor dhe të rasteve të tjera të parashikuara në këtë udhëzim.
3. Përgjegjësi i departamentit ka të drejtën e aksesit mbi të gjitha të dhënat e studentëve dhe kurseve të mësimdhënies të departamentit përkatës vetëm në formën e pandryshueshme, me të drejtën e editimit të orarit mësimor dhe të rasteve të tjera të parashikuara në këtë udhëzim.
4. Personeli akademik fiton të drejtën e përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit vetëm pas miratimit nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani i fakultetit. Kjo listë emërore i dërgohet personit përgjegjës. Ky personel akademik ka të drejtën e aksesit vetëm në formën e pandryshueshme të konstatimit të emrave, mbiemrave, atësive, matrikullave të listës së studentëve të kursit të vet sipas orarit mësimor të miratuar dhe kryen pjesën e procesit të vlerësimit periodik të studentëve si dhe e pasqyron këtë në sistemin, dhe në këtë formë akseson dhe editon vetëm rezultatet e provimeve dhe notës përfundimtare. Për sa më sipër çdo person i punësuar si personel akademik ka akses dhe mban përgjegjësi për të gjitha proceset më sipër në trajtimin e të dhënave, ruajtjen dhe menaxhimin e tyre. Personeli akademik që nuk respekton rregullin për editimin e rezultateve të provimeve apo notat përfundimtare brenda 48 orëve nga zhvillimi i provimit i hiqet aksesin për editim në SIM Univlora. Në këto raste apo të ngjashme me të, është detyra e përgjegjësit të departamentit dhe dekanit të fakultetit të vlerësojnë situatën dhe të marrin të gjitha

masat për mbarëvajtjen normale të procesit të mësimdhënies dhe kontrollit të dijes. Personelit akademik i hiqet aksesit i përdorimit të SIM Univlora ose i editimit në të, dhe kur konstatohet se me veprimet e tij shkel rregullat dhe standartet akademike, cënon zhvillimin normal të procesit të mësimdhënies dhe krijon problematike në regjistrimin në kohë të studentëve në kurset e semestrit pasardhës, abuzon dhe apo nuk zbaton urdhrat e autoriteve drejtuese në lidhje me mësimdhënien dhe disiplinën në punë, kur mungon në punë për arsye të justikuara ose jo dhe nuk përmbush detyrimin e hedhjes në kohë rezultateve të provimeve si dhe kur largohet nga universiteti. Për sa më sipër është detyra e autoriteteve drejtuese të njesisë bazë dhe kryesore të marrin masat me qëllim, ndreqjen e pasojave dhe zhvillimin normal të gjithë procesit.

5. Akses specifik në SIM Univlora ka çdo pedagog i caktuar nga dekani i fakultetit ose përgjegjësi i departamentit për editimin e rezultateve ose notave të studentëve bazuar në procesverbalin e rivlerësimit të provimeve nga komisioni i ngritur në departament referuar ankesës së studentit për rishikimin e pikëve apo notës. Kjo vlen dhe në rastet kur pedagogu i lëndës ka pamundësinë e editimit të rezultateve për arsye të justifikuar ose jo, si dhe për rastet e përmendura në pikën d më sipër.

6. Sekretaritetë mësimore kryejnë pjesën e procesit të hapjes së aksesit për studentët e rinj në SMI Univlora, duke krijuar atyre profilin e tyre brenda SMI Univlora me të dhënat e dokumentave zyrtare të dorëzuara pranë sekretarive gjatë procesit të regjistrimit, si dhe kanë akses mbi të gjithë informacionin e studentëve, rezultatet e studimit dhe ecurinë akademike të tyre në çdo kohë, editojnë pagesat e tarifës së shkollimit për çdo student. Sekretaritetë mësimore kanë akses të regjistrojnë pas miratimit nga dekani të gjithë studentët që kanë probleme të regjistrimit në sistem. Sekretaritetë mësimore kanë akses për editime apo regjistrime për të gjitha rastet e paparashikuara, por vetëm pasi më parë të jetë marrë miratimi i përgjegjësit të

departamentit dhe dekanit me procedura transparente të evidentura me provecverbale shoqëruese. Për sa më sipër çdo person i punësuar si sekretar/e mësimore ka akses dhe mban përgjegjësi për të gjitha proceset në trajtimin e të dhënave, ruajtjen dhe manaxhimin e tyre. Aksesit hiqet për veprime abuzive dhe në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore.

7. Zyra e Regjistrimit ka akses mbi të gjitha të dhënat e studentëve që ndjekin studimet dhe atyre të diplomuar vetëm në formën e pandryshueshme mban përgjegjësi për të gjitha proceset sa më sipër në trajtimin e të dhënave, ruajtjen dhe manaxhimin e tyre. Aksesit hiqet për veprime abuzive dhe në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore.

8. Studentët e rinj dhe çdo student tjetër i universitetit që nuk ka detyrime fitojnë të drejtën e përdorimit të SMI Univlora. Studentët kryejnë pjesën e procesit të regjistrimit në lëndë, si dhe shikojnë të dhëna të tjera mbi pedagogët, sallat, orarin e leksioneve dhe formave të tjera të mësimdhënies, editojnë dhe plotësojnë saktësisht profilin e tyre brenda SMI Univlora, në pjesët që janë të editueshme nga vet ata (si numri i kontaktit, adresa e banimit, etj.) të cilat janë lënë të ndryshueshme për shkak të dinamikës së këtyre të dhënave. Për sa më sipër çdo person i cili ka statusin e studentit ka akses dhe mban përgjegjësi për të gjitha proceset më sipër në trajtimin e të dhënave, saktësinë, ruajtjen dhe manaxhimin e tyre. Aksesit hiqet për veprime abuzive dhe në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore. Në rastet e humbjes, shkatërrimit, bllokimit, fshirjes së këtyre të dhënave personale, personat e mësipërm që kanë akses në këto të dhëna ngarkohen me përgjegjësi. Gjithë punonjësit administrativë që kanë të drejtën e përdorimit të SMI Univlora, duhet të plotësojnë një formular mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë dhe protokollohet. Ky formular përgatitet nga Drejtoria e IT-së. Zyra e Regjistrimit, sekretaritetë mësimore, Drejtoria e IT-së, Zyra e Burimeve Njerëzore, Dega e Financës dhe e Buxhetit, Zyra e Protokoll-Arkivës apo edhe zyra të tjera në universitet që

disponojnë dokumentacione, informacione ose marrin dijeni në lidhje me të dhënat personale të stafit akademik, administrativ dhe studentëve janë të detyruara t'i mbrojnë këto të dhëna personale dhe të ruajnë konfidencialitetin e këtyre të dhënave, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Udhëzimin nr. 07, datë 9.6.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit", si dhe ligje apo udhëzime të tjera që veprojnë në mbrojtje të të dhënave personale. Thyerja e detyrimit të konfidencialitetit përbën vepër penale të parashikuar nga Kodi Penal (neni 123).

Neni 90 Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale

Të dhënat personale të personelit akademik, administrativ dhe studentëve duhet:

1. Të përdoren vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunimi të bëhet në përputhje me këto qëllime;
2. Të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
3. Të saktësohen nga ana faktike dhe kur është e nevojshme, të bëhet përditësimi e kryerja e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
4. Të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për njëkohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.
5. Personat që kanë akses në të dhënat manual dhe ato në sistemin kompjuterik duhet të marrin masat e duhura të sigurisë kundër aksesit të paautorizuar, ndaj zbulimit apo shkatërrimit të të dhënave, si dhe për humbjen aksidentale të tyre.
6. Përpunimi i të gjitha të dhënave, duhet të jetë rreptësisht i kontrolluar. Të dhënat personale sensitive duhen trajtuar me kujdes të veçantë dhe përpunimi i tyre bëhet

sipas kritereve të parashikuara në nenin 7 të ligjit nr.9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

7. Mbështetur në nenin 6 të ligjit nr.9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" parashikohet se të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin ("Pëlqim" është deklarata specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij.).

8. Rastet përjashtimore kur përpunimi i të dhënave mund të bëhet pa pëlqimin e personit janë, por me miratimin e titullarit:

- Kur personeli universitar ka nevojë për informacion për mësimdhënie, veprime administrative, apo qëllime vlerësimi etj.
- Kur gjykata, policia dhe prokuroria merren me parandalimin e krimit apo funksionimin dhe zbatimin e ligjit.
- Për urgjencat spitalore.

9. Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

10. Në të gjitha rastet, kjo nënkupton që ata nuk duhet t'i bëjnë me dije ndonjë personi të paautorizuar të dhëna personale, të cilat ata i shohin apo që i mësojnë gjatë punës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zgjat pambarimisht. Detyrimi nuk mbaron kur personat nuk ushtrojnë më funksionet e tyre. Thyerja e detyrimit të konfidencialitetit përbën vepër penale të parashikuar nga Kodi Penal (neni 123).

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Shtetet me nivel të mjaftueshëm parashikohen në VKM nr.934, datë 02.09.2009 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale". Lejohet transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, në një shtet tjetër, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, vetëm në rastet e



parashikuara nga Udhezimi nr. 01, date 20.02.2010 "Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale", i nxjerrë nga Zyra e Komisionerit.

KREU XII PROCEDURA E ANKIMIT KUNDËR DISKRIMINIMIT DHE MASAT PËRKATËSE

Neni 91 **Hartimi i ankimit**

Ankimi shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

1. eprorin drejt të cilit drejtohet ankimi, përgjegjës departamenti, zv/dekan, dekan, zv/rector, rector.
2. emër, mbiemër, pozicioni i punës, adresën e saktë të ankuesit;
3. përcaktimi i objektit të ankimit;
4. tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe të së drejtës mbi të cilët mbështetet ankimi;
5. kërkimin e ankuesit.

Neni 92 **Paraqitja e ankimit**

Ankimi së bashku me dokumenta të tjera që e shoqërojnë paraqitet pranë sekretarisë së fakultetit përkatës të ankuesit. Sekretaria, ankimin dhe dokumentat që e shoqërojnë ja përcjell eprorit, të cilit i drejtohet ky ankim.

Neni 93 **Eprori, të cilit i drejtohet ankimi**

Në rastin se ankuesi është pjesë e stafit akademik dhe ngre një çështje diskriminimi në lidhje me një punëmarrës tjetër atëherë ankimi i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Në rastin se ankuesi ngre një çështje diskriminimi në lidhje Përgjegjësën e Departamentit apo Zëvendësdekanin e Fakultetit përkatës, atëherë ankimi i drejtohet Dekanit të Fakultetit përkatës. Në rastin se ankuesi

ngre një çështje diskriminimi në lidhje me Dekanin e Fakultetit përkatës, atëherë ankimi i drejtohet zv/Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali". Në rastin se ankuesi ngre një çështje diskriminimi në lidhje me Zëvendësrektorin e Universitetit "Ismail Qemali", atëherë ankimi i drejtohet Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali".

Neni 94 **Shqyrtimi i ankimit**

Pasi Përgjegjësi i Departamentit merr në dorëzim ankimin me dokumentat bashkëngjitur duhet t'i kthejë përgjigje ankuesit brenda një afati prej 30 ditësh. Në rastin se ankuesi nuk është dakord me përgjigjen e marrë, atëherë ngre një ankim drejtuar zv/Dekanit të Fakultetit përkatës. Ky i fundit duhet t'i kthejë përgjigje ankuesit brenda afatit prej 30 ditësh. Në rastin se ankuesi përsëri nuk është dakord me përgjigjen e marrë, procedura e mëtejshme vazhdon me ankimin drejtuar Dekanit të Fakultetit përkatës, i cili duhet t'i kthejë përgjigje brenda afatit prej 30 ditësh. Më tej ankuesi mund të ankohet tek Zëvendësrektori i Universitetit "Ismail Qemali", që përsëri brenda afatit prej 30 ditësh duhet t'i kthejë përgjigje dhe më pas te Rektori i Universitetit "Ismail Qemali". Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", brenda afatit prej 30 ditësh i kërkon Dekanit të Fakultetit përkatës që të rishqyrtojë ankimin dhe nëse është rasti ta trajtojë ankimin dhe në Këshillin e Fakultetit. Pas ezaurimit të të gjithë kësaj procedure dhe në rast të ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Fakultetit, vendimin përfundimtar e merr Rektori i Universitetit "Ismail Qemali". Ndaj vendimit të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", mund të bëhet ankim te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi referuar ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Neni 95 **Masat ndaj moszbatimit të detyrave**

Në rastin se eprori përkatës, të cilit i drejtohet një çështje diskriminimi nuk zbaton



procedurën brenda afatave të përcaktuara dhe nuk i kthen përgjigje ankuesit atëherë, nga eprori më i lartë nëpërmjet urdhërit detyrohet që të rimarë në shqyrtim rastin në fjalë dhe t'i kthejë përgjigje ankuesit. Në rast se edhe pas urdhërit të eprorit më të lartë, eprori përkatës nuk merr në shqyrtim rastin në fjalë dhe nuk i kthen përgjigje ankuesit atëherë ndaj tij do të merret masë disiplinore referuar nenit 50 të statutit të universitetit dhe referuar nenit 34 të rregullores së universitetit.

Neni 96
Masat ndaj diskriminimit

Masat ndaj punonjësve që kanë shkaktuar diskriminim qoftë punëmarrës apo epror do të jenë masa disiplinore referuar nenit 50 të statutit të universitetit dhe referuar nenit 34 të rregullores së universitetit.

KREU XIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 97

Për aspekte të veçanta administrative, ekonomike dhe financiare Senati Akademik miraton rregullore të veçantë.

Neni 98

Rregulloret e fakulteteve dhe aktet e tjera të tyre, sipas specifikës përkatëse, duhet të harmonizohen me dispozitat e kësaj Rregulloreje, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e saj.

Neni 99

Kjo rregullore shfuqizon rregulloren e mëparshme dhe shtrin efektet me miratimin nga Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 100

Të drejtën e patjetërsueshme në interpretimin e kësaj Rregulloreje, e ka Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Ndryshimet në rregullore hyjnë në fuqi menjëherë pas vendimit të Senatit Akademik për këto ndryshime. Miratuar me Vendimin nr. 09, date 15.02.2013 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i ndryshuar me Vendimin nr. 36, datë 06.11.2013, Vendimin nr. 02, date 07.01.2014, Vendimin nr. 18, datë 11.04.2014 dhe Vendimin nr. 27, datë 06.10.2014.

KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. Albert Qarri

Të Drejtat dhe Detyrat e Studentit

Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe e humbet me marrjen e diplomës ose çertifikatës përkatëse si edhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij.

Studentët janë të detyruar:

- ☞ Të njohë me hollesi rregullat e shkollës dhe detyrimet e tij dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt, shkolla nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
- ☞ Të zbatojnë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit, nga rregullorja dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për Arsimin e Lartë;
- ☞ Të ndjekin kurset e plota të leksioneve, seminareve, laboratoreve, praktikave mësimore, etj sipas syllabus-it të pedagogut;
- ☞ T'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në të gjitha veprimtaritë akademike;
- ☞ Të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofron institucioni brenda afateve;
- ☞ Të rrespektojnë kodin e etikës, dhe rregulloren e univerisitetit;
- ☞ Të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë;

Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre. Për çdo shkelje nga ana e studenteve në rregulloren e institucionit përcaktohen masat disiplinore.

Shkelje të rregullave të shkollës konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e mësimdhënësit dhe të çdo



punonjësi tjetër të shkollës, normat etiko-morale të shoqërisë, si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugacërise, të vjedhjes, etj.

Studentët kanë këto të drejta:

- ☞ Të përfaqësohen në Këshillat e Fakulteteve, në Këshillin e Administrimit dhe në Senatin Akademik;
- ☞ Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga universiteti;
- ☞ Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit;
- ☞ Të ndjekin një degë të dytë studimesh kur plotësojnë kushtet akademike;
- ☞ Të rregjistrohen për çdo lëndë që ju ofrohet në universitet duke rrespektuar procedurat e përcaktuara në rregullore;
- ☞ Të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
- ☞ Të organizohen në shoqata studentore jopolitike duke iu



GUIDA E STUDENTIT 2015-2016

përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

Studenti ka të drejte të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, ankesa paraqitet në dekanat. Dekani i Fakultetit, pasi verifikon shkeljet e reklamuar me

Përgjegjësia e Departamentit dhe me komisionin e provimit, merr vendim të formës së prerë. Në rast se ankesa është e drejtë, Dekani vendos anulimin e provimit dhe ribërjen e tij në një datë të vecantë.

Rregjistrimi ne uniVlora

Për ta bërë më të lehtë regjistrimin në UniVlora, në bazë të datave të përcaktuara me vendim të këshillit të ministrave studentët vijnë regjistrohen në sekretariatë mësimore përkatëse ku dorëzojnë dokumentat e mëposhtëme:

- pagesa e taksës së regjistrimit per ketë vit ka vlerën 1600 lek
- dokumentat që nevojiten janë si më poshte:
- a) fotokopje e kartës së identitetit
 - b) 2 fotografi
 - c) 1 formular te cilin e shpërndajmë ne për të plotësuar të dhënat e tyre
 - d) njëkohësisht firmosin në 2 rregjistra të cilat nisen në ministri

(këto dokumenta ndryshojnë nga viti në vit,vijnë të percaktuar nga VKM e MASH) Qëllimi është që nga viti ne vit studentët të mos ndeshen me veshitirsite e regjistrimit, të cilat kanë qenë të mundimshme në vite. Sekretarite janë vendi ku studentët duhet, dhe mund të gjejnë zgjidhje për problemet e regjistrimit,dhe informimit.


Sekretaritë mësimore kanë detyrimin të mundësojnë hapjen e userave te studentëve ne ums, dhe cdo student si user ka ID e maturës dhe mund të tërheqi passwordin ne sekretari. Për çdo vit akademik tarifat dhe kuotat vijnë nga ministria.

Per vitin akademik 2014/2015 është zbatuar Vendim Nr. 517, datë 1.8.2014


Për të regjistruar në sistemin online të Universitetit mund të veproni si më poshtë.

GUIDË PËR RREGJISTRIMIN ONLINE NË SISTEMIN INFORMATIV TË UNIVERSITETIT:


1. Klikoni në web: www.univlora.edu.al
2. Më pas hyni tek: ums.univlora.edu.al



- Shkoni tek hapësira juaj duke vendosur Userin, Passwordin dhe kodin që shfaqet poshtë kësaj platforme;




- Shkoni tek hapësira rregjistrohu:




- Në krahun e djathtë shfaqen lëndët nga të cilat duhet të zgjidhni si më poshtë:




GUIDA E STUDENTIT 2015-2016




6. Pasi të jeni rregjistruar në leksion duhet të zgjidhni edhe seminarin (*shikoni që orari i leksioneve dhe seminareve të zgjedhura të mos jenë në të njëjtën orë pasi nuk mund t'i frekuentoni*)





7. Pasi të keni përfunduar rregjistrimin (ju mund të rregjistroheni në 5 lëndë ose jo më shumë se 40 kredite në total) duhet të shkoni tek platforma logout për t'u larguar nga sistemi. Nëse nuk dilni nëpërmjet logout rrezikoni që dikush tjetër të hyj në adresën tuaj dhe mund t'ju ndryshoj edhe passwordi.



Tarifat dhe kuotat e Studimit ne Bachelor dhe Master

V E N D I M

P Ë R

KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, SI EDHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2015 – 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, e të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2015 - 2016, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, janë 20 211 të ndara, si më poshtë vijojnë:

- Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, për programet e studimeve jo universitare profesionale, si dhe për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë 19 651;
- Kuota për program të dytë studimi 200;
- Kuota për transferim studimesh 300;
- Kuota për shtetasit e huaj 60.

2. Kuotat e pranimeve të reja, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij vendimi, përbëhen nga:

- Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit 18 986;
- Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit 600;
- Kuotat për të verbrit 15;
- Kuotat për romët dhe ballkano-egjiptianët 20;
- Kuotat për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë 15;
- Kuotat për jetimët 15.

3. Kuotat e pranimit në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, sipas shkronjës "a", të pikës 2, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimit për programet e studimeve të ciklit të parë, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, si Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Këto kuota shpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se data e parashikuar për fillimin e vitit akademik 2015-2016.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe nga Prefektura e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Kriteret e vlerësimit dhe të pranimit të tyre në këto programe studimi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe bëhen të njohura në median e shkruar dhe atë elektronike për të gjithë kandidatët e interesuar. Procedurat për procesin e përzgjedhjes dhe regjistrimit të kandidatëve fitues duhet të përfundojnë përpara fillimit të vitit akademik 2015-2016.

5. Kuotat e pranimit për të verbrit, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, për romët dhe ballkano-egjiptianët, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 2, të këtij vendimi, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij vendimi, dhe për jetimët, të përcaktuara në shkronjën “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve me statusin përkatës nga një komision me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të përbashkët, si dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

6. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nga personat e interesuar.

7. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, të vitit akademik 2015 -2016, pasqyrohen në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Përrjashtëmi apo reduktimi i tarifës së shkollimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet.

9. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, në vitin akademik 2015- 2016, 3 (tre) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë - preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Përrjashtëmi bën Universiteti i Arteve të Tiranës, në të cilin tre studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë–preferencë) në nivel fakulteti, nuk paguajnë tarifën vjetore të shkollimit.

10. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, si edhe kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, mbështetur dhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

11. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit bëhen sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

12. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

13. Kandidatët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi,

brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi.

14. Kandidatët, të cilët aplikojnë për një program të parë studimi në vitin akademik 2015 -2016, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë në: Universitetin e Arteve Tiranë, Universitetin e Sporteve të Tiranës, universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan (programi i studimit "Edukim fizik dhe sporte"), universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër (programet e studimit "Edukim fizik dhe sporte", "Pedagogji muzikore" dhe "Pikturë e grafikë"), si dhe në universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës (programet e studimeve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën, FASTIP), duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta (përfshirë këtu konkurset e pranimit), të vendosura nga vetë këto institucione publike të arsimit të lartë.

Kriteret e veçanta për këto programe studimi duhet t'i plotësojnë edhe kandidatët që kërkojnë të studiojnë në një program të dytë studimi.

15. Studentët, që vijojnë një program të dytë studimi, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit, të përcaktuar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

16. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në programet respektive të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare shtetërore janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

17. Pranimi i studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet nëpërmjet parimit Meritë - Preferencë dhe kryhet në dy runde (aplikimi me dy formularët, A2 dhe A3).

17.1 Shpërndarja e fituesve në programe të ndryshme studimi, të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në mënyrë të informatizuar, duke u

mbështetur në rezultatet e shkollës së mesme, të Maturës Shtetërore (merita), si dhe të përzgjedhjes së programeve të studimit (preferenca), të bërë nga vetë kandidati/ja. Raundi i parë (aplikimi me formularin A2) zhvillohet në dy faza: Faza I regjistrimi on-line dhe Faza II regjistrimi me dokumentacionet e kërkuara sipas udhëzimit përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit në sekretaritë e fakulteteve pranë institucioneve të arsimit të lartë publik, ku janë shpallur fitues.

17.2 Kuotat, që mbeten të porealizuara për çdo program studimi pas aplikimit me formularin A2, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bazë të propozimeve të institucioneve publike të arsimit të lartë.

17.2.1 Në raundin e dytë kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë maturantët kandidatë që kanë konkurruar në raundin e parë me të njëjtën renditje preferencash të atij raundi, me përjashtim të:

- a) fituesve të preferencës së parë të cilët janë regjistruar në këtë program studimi;
- b) maturantëve/kandidatëve të cilët nuk kanë kërkuar vazhdimin e konkurimit për preferenca më të larta gjatë regjistrimit on-line dhe që rezultojnë të regjistruar në programin e studimit të preferuar.

17.2.2 Formulari A3 përfshin programet e studimit të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë me kuotat respektive të paplotësuara, të rishpërndara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët:

- a) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2;
- b) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e dytë 2015;
- c) kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë Republikës së Shqipërisë dhe u janë ekuivalentuar rezultatet e shkollës së mesme dhe provimet e Maturës Shtetërore;
- ç) kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë dhe rezultojnë kalues në provimet me zgjedhje.



18. Kuotat, që mbeten të porealizuara edhe pas regjistrimit të fituesve të shpallur nga aplikimi në raundin e fundit, nuk rishpallen.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, njësitë arsimore vendore (Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore) dhe

institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

EMËRTIMI I UNIVERSITETIT	ID_PROGRAMIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	Kuota për program të parë studimi	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifa vjetore për program të dytë
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	192	Matematikë	25	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	193	Fizikë	25	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	194	Shkenca Kompjuterike	55	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	195	Teknologji Informacioni	55	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	196	Informatikë	75	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	197	Inxhinieri Navale	45	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	198	Inxhinieri Mekanike	70	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	199	Navigacion	30	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	200	Kimi	15	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	201	Biologji	70	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	202	Inxhinieri Elektrike	40	20,000	203,690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	203	Administrim Biznesi	120	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	204	Menaxhim Turizmi	80	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	205	Ekonomiks	100	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	206	Financë	190	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	207	Kontabilitet	50	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	208	Marketing	50	20,000	86,374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	209	Mësuesi për Arsimin Fillor	75	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	210	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	65	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	211	Pedagogji e Specializuar	20	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	212	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	95	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	213	Gjuhë Angleze	100	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	214	Gjuhë Italiane	20	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	215	Histori - Gjeografi	70	20,000	135,730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	216	Drejtësi	140	20,000	100,446
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	217	Infermieri e Përgjithshme	160	20,000	233,916
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	218	Infermier Mami	60	20,000	233,916

Bursat

Studentët e vitit të parë mund ta aplikojnë për Bursën në Bashkinë e Vlorës. Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë, 9400. info@vlora.gov.al. Dokumentat që duhet të paraqiten për akomodimin e bursës së shtetit:

- Vërtetim nga universiteti ku është bërë regjistrimi dhe ku studenti vazhdon vitin e parë;
- Çertifikate familjare + Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- Dokumenta që vërtetojnë të ardhurat e trungut familjar:
 - o Vërtetim page mujore,
 - o Nëse nuk janë në marrëdhënie pune, vërtetim nga zyra e perkrahjes sociale per ndihmen sociale.
 - o Vërtetim nga zyra e punësimit,
 - o Në rast se prindërit janë në pension, vërtetim nga dega e sigurimeve shoqërore duke përcaktuar pensionin dhe shtesat e tjera,
 - o Vërtetim nga Kadastra,
 - o Vërtetim nga zyra e tatim-taksave,
 - o Për pjestaret e tjerë të familjes që janë në marrëdhënie shkolle, vërtetim nga shkolla që ndjekin studimet,
 - o Deklarata personale,
 - o Vërtetim nga rajoni ku banon.

Nga viti i dytë ka mundësi për të fituar një bursë nga UniVlora.

Ne vitin akademik 2014-2015 një student që ka fituar bursën e plotë mer cdo muaj 8900 lek (gjate vitit akademik) pasi Zyra e Financës mer konfirmim nga sekretaria përkatëse për frekuentim të rregullt.

Studenti i cili ka përfituar gjysmen e bursës mer 4450 lek.

DOKUMENTAT E APLIKIMIT PËR BURSË PËR VITIN II DHE III

Për studentët qe vijne nga Bashkite:

- Vërtetim studenti per aplikantin.
- Çertifikatë familjare.
- Vërtetim page për cdo të punësuar në familje.
- Vërtetim papunësie për të papunët nga Zyra e Punes.
- Vërtetim shkolle për pjestarët e familjes që vazhdojnë shkollën dhe vërtetim nëse marrin bursë ose jo).
- Vërtetim nga Sig.Shoqërore nëse familja përfiton pensione të ndryshme.
- Vërtetim nga Zyra e Tatim –Taksave për veprimtari private te familjes.
- Vërtetim nga Kadastra për tokë në pronësi të familjes.
- Vërtetim nga Zyra e Ndhmës Ekonomike nëse familja merr ndihma ekonomike nga shteti.
- Studentët kryefamiljarë ,me fëmije duhet të paraqesin edhe vërtetimin e banimit në konvikt publik.
- Fotokopje e kartes së identitetit të studentit.
- Deklaratë e të ardhurave.

Për studentët që vijnë nga Komunat:

- Vërtetim studenti per aplikantin .
- Certifikatë familjare
- Vërtetim për masën e ndihmës ekonomike që përfiton familja.
- Vërtetim për tokën e familjes.
- Fotokopje e kartës së identitetit të studentit.



- Deklaratë e të ardhurave.

Jashtë kriterit ekonomik mund të fitojnë bursë:

- Studentë që kanë perfituar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10(dhjeta).
- Studentet që ndjekin studimet në degën Matematike e Fizikë ,viti II e lart dhe kanë mbaruar vitin pararendës me mesatare mbi 8.

- Femijët e punonjësve të policisë së Shtetit, Gardes, Policisë së Burgjeve, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri, Sherbimit Informativ Shtetëror që kanë humbur jetën në detyrë.

Studentët aplikojnë për bursë në fillim të vitit akademik dhe afati i miratimit të tyre përcaktohet nga VKM që del çdo vit.

V.K.M. për bursat e nxënësve dhe studentëve, për vitin akademik 2014-2015

V E N D I M

P Ë R

KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2014 - 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28, të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të nenit 57, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënien ndihme të menjëhershme familjeve të

punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardes së Republikës, të Sherbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Sherbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 29, të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin

e jetimit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR).

2. Përfitojnë bursë nxënësit dhe studentët brenda kuotave dhe këtyre kriterëve:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë)



- a) Nxënësit/studentët që vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i tyre dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Nxënësit që banojnë në fshat, që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km e që akomodohen në konvikte publike;
- c) Nxënësit/studentët që kanë përfituar statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik;
- ç) Nxënësit/studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë, dhe që plotësojnë kriterin ekonomik;
- d) Secili nga studentët bashkëshort me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik dhe që akomodohet në konvikt publik;
- dh) Fëmijët, nxënës apo studentë, që gëzojnë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë)

- a) Nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta);
- b) Nxënësit që vazhdojnë studimet në shkollat profesionale në drejtimet mësimore: Bujqësi, Veterinari, Pyje, Ndërtim, Peshkim, Gjeologji-Miniera dhe Shpim e Shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit, në vitet e dyta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë);
- c) Studentët e regjistruar në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga MAS më të mirët e Maturës Shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit, të realizuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Për vitin akademik 2014-2015, numri i tyre do të jetë 25 (njëzet e pesë) studentë. Kjo kategori studentësh përfiton bursë kur ata vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin akademik 2014-2015;
- ç) Studentët që kanë përfunduar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta);

- d) Studentët që vazhdojnë studimet në programet e studimit

Matematikë dhe Fizikë, në vitin e dytë e lart, dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë)

Fëmijët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

Në fillim të çdo viti akademik, (por jo më vonë se data 15 dhjetor 2014), Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ Shtetëror duhet të dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë listën edhe për këtë kategori nxënësish/studentësh.

2.4 Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit (nxënës)

- a) Nxënësit e shkollave profesionale që ndjekin drejtimet mësimore: Bujqësi, Veterinari, Pyje, Ndërtim, Peshkim, Gjeologji-Miniera dhe Shpim e Shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit;
- b) Nxënësit e shkollave profesionale me vendbanim të përhershëm në zonat Verilindore dhe Juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Pogradec, Skrapar dhe Tepelenë.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë, ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj, kur:

- a) janë ndarë nga trangu familjar;
- b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;



- c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit harton planin e shpërndarjes së bursave për drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), për studentët që regjistrohen dhe ndjekin vitin e parë akademik 2014-2015, sipas kuotave të miratuara (për studentë). DAR/ZA-të, pas këshillimit me njësitë bazë të qeverisjes vendore, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave dhe e dërgojnë atë në njësitë bazë të qeverisjes vendore (bashki/komunë), në përshtatje me kërkesat e paraqitura paraprakisht prej tyre, për kategoritë sipas pikës 2.1, të këtij vendimi.

5. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, pas këshillimit me njësitë bazë të qeverisjes vendore ku ndodhen shkollat profesionale, harton planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e shkollave profesionale që regjistrohen dhe ndjekin vitin e parë akademik 2014-2015 dhe ua dërgon për miratim njësitë bazë të qeverisjes vendore (bashki/komunë), në përputhje me vendndodhjen territoriale të shkollës profesionale.

6. Njësitë bazë të qeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar për to, vendosin, me këshillat e tyre, dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve/studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë, për kushte të barabarta në trajtimin me bursë, prioritet kanë nxënëset vajza. Njësitë bazë të qeverisjes vendore, në pamundësi trajtimi me bursë të plotë, brenda planit të miratuar, mund të trajtojnë/ miratojnë dhe 1/2 (gjysmë) burse.

6.1 Njësitë bazë të qeverisjes vendore, detyrimisht, duhet t'u dërgojnë zyrtarisht, jo më vonë se data 31.12.2014, institucioneve publike të arsimit të lartë, njësitë bazë të

qeverisjes vendore, drejtorive arsimore rajonale apo zyrate arsimore përkatëse vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

6.2 DAR/ZA-të duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, si dhe bashkive/komunave që menaxhojnë konviktet, listën emërore të nxënësve dhe të studentëve përfitues të bursës, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe të këshillave të komunave. Një kopje e listës emërore të nxënësve dhe studentëve të trajtuar me bursë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, jo më vonë se data 15 Janar 2015.

6.3 DAR/ZA-të dhe Drejtoritë e Shkollave Profesionale, për nxënësit që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor 2014-2015, në degët: Bujqësi, Veterinari, Pyjore, Ndërtim, Peshkim, Gjeologji-Miniera dhe Shpim e Shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit, u dërgojnë informacion njësitë bazë të qeverisjes vendore jo më vonë se data 30.10.2014.

6.4 Njësitë bazë të qeverisjes vendore vendosin për dhënien e bursave, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave profesionale dhe konvikteve në të cilat janë vendosur nxënësit, mbështetur në numrin e nxënësve të regjistruar në këto degë, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2014-2015. Njësitë arsimore vendore DAR/ZA dhe Drejtoritë e Shkollave Profesionale menjëherë, me mbarimin e regjistrimit në këto degë, dërgojnë informacion në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR).

7. Bursat e nxënësve, për vitin e dytë e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit, nga këshilli i bashkisë/komunës, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave profesionale dhe konvikteve ku

janë vendosur nxënësit përfitues të bursës/kuotës ushqimore.

Drejtoritë Arsimore Rajonale/Drejtoritë e Shkollave Profesionale paraqesin/dërgojnë zyrtarisht, në njësitë vendore, kërkesat për miratim burse për nxënësit që përfitojnë bursë sipas pikave 2.2, shkronja “a”, 2.2, shkronja “b” dhe 2.2, shkronja “c”, të këtij vendimi.

Nxënësit që kanë përfituar bursë vitin e parë, me vendim të këshillit të bashkisë/komunës ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

Nxënësit e viteve të III-ta të shkollave të mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër dhe “Havzi Nela”, Kukës, të cilët transferojnë programet e nivelit të dytë në shkollat e mesme profesionale Shkodër, (pra nga njësitë vendore Bashkia Peshkopi dhe Bashkia Kukës në njësinë vendore Bashkia Shkodër), njëkohësisht transferojnë, zyrtarisht, në Bashkinë Shkodër, numrin e bursave (listën e nxënësve) që kanë përfituar bursë për vitin shkollor 2014-2015.

Për nxënësit e tjerë të viteve të III-ta të shkollave së mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër dhe “Havzi Nela”, Kukës, që plotësojnë kriteret ekonomike dhe kriterin e largësisë nga vendbanimi, sipas pikës 2.1, kërkesat e tyre shqyrtohen dhe trajtohen me bursë nga njësia e qeverisjes vendore Bashkia Shkodër.

7.1 Nxënësit që kanë përfituar bursë e përfitojnë atë edhe gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale. Bursa jepet në formën e kuotës ushqimore, nga njësia bazë e qeverisjes vendore gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.

Nxënësve të klasës së 13-të të shkollave profesionale, të drejtimit Termohidraulikë, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale, të miratuar për vitin akademik 2014-2015, që nuk kanë përfituar bursë me vendim të këshillave të njësive të qeverisjes vendore, u

akordohet/miratohet bursë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, mbështetur në kërkesën e Drejtorisë Arsimore Rajonale.

Bursat e akorduara/miratuara nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë u dërgohen zyrtarisht njësive bazë të qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit që zhvillojnë praktikën profesionale. Nxënësit e përfitojnë bursën në formën e kuotës ushqimore.

Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive bazë të qeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale, për nxënësit që përfitojnë bursë.

8. Bursat e studentëve, për vitin e II-të e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët e vitit II e lart, që nuk kanë përfituar bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuara sipas këtij vendimi.

Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët që përfitojnë bursë, sipas pikës 2.2, është deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë), në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2014-2015. Institucionet publike të arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit kërkesat për studentët që përfitojnë bursë sipas pikave 2.2, shkronja “ç”, 2.2 shkronja “d”, dhe 2.2 shkronja “dh”, të këtij vendimi.

MAS-i harton planin e shpërndarjes dhe e dërgon për ekzekutim në institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët, të cilë kanë përfituar bursë vitin e parë, me vendim të këshillit të bashkisë/komunës ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

9. Nga plani i bursave të miratuara për vitin akademik 2014-2015 bashkisë së Tiranës i jepen deri në 10 (dhjetë) bursa për



studentët të cilët, pavarësisht nga kriteri i vendbanimit apo kriterëve ekonomike, kanë statusin ligjor të jetimit si dhe statusin invalid paraplegjik apo tetraplegjik, ndërsa bashkive të tjera, të cilat në vendndodhjen e tyre territoriale kanë institucione të arsimit të lartë publik, për këtë kategori studentësh, u jepen deri në 3 (tri) bursa.

10. Nxënësit dhe studentët që kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme që ofrojnë shkollat.

10.1 Nxënësve dhe studentëve që kanë përfituar statusin ligjor të jetimit u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës, të kartës shëndetësore si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

10.2 Nxënësit jetimë, që vazhdojnë shkollat e mesme ose institucionet publike të arsimit të lartë, trajtohen me pagesë suplementare edhe për periudhën e pushimeve verore, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, si dhe vetëm një vit, kur humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jo kaluese, nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.

10.3 Fëmijët/nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psiko-sociale, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti, me një kuotë ushqimore (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

11. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët, administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Bursa

përlllogaritet si shpenzim mesatar, lekë në ditë, dhe paguhet çdo muaj me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti. Drejtuesit e fakulteteve dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njërive/departamentit të financës, frekuentimin e shkollës për studentët që përfitojnë bursë.

11.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit, administrohen nga bashkia/komuna, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore, në konvikt.

11.2 Nxënësve që përfitojnë bursë jashtë kriterit ekonomik, sipas rezultateve të arritura, sipas degëve parësore për zhvillimin e ekonomisë si dhe nxënësve që përfitojnë bursë jashtë kriterit ekonomik, të cilët janë akomoduar ose jo në konvikte, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet, çdo muaj, nga bashkia/komuna, në llogarinë bankare të nxënësit/prindit përfitues, pranë bankave të nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njërive bazë të qeverisjes vendore, informacion mbi ndjekjen/frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

12. Niveli/masa e bursës për nxënësit dhe studentët jepet sipas pasqyrave nr.2 e nr.3 dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr. 4 e nr.5, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

13. Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin e ri akademik 2014-2015, të japë 1850 (një mijë e tetëqind e pesëdhjetë) bursa për nxënësit dhe 1800 (një mijë e tetëqind) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi.



14. Efektet financiare të vitit akademik 2014-2015 të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për vitin 2014, për pjesën e vitit 2014 si dhe nga fondet e buxhetit të shtetit që do të miratohet për vitin 2015, për pjesën e vitit 2015.

15. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 31 dhjetor 2014, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitin e dytë e lart është data 15 nëntor 2014. Vendimet e miratuara nga këshillat bashkiake apo këshillat e komunës, jashtë këtij afati, janë të pavlefshme.

16. Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për raste të veçanta, kur vendimet e këshillave të

njësive bazë të qeverisjes vendore janë miratuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 14, të këtij vendimi, por dërgohen jashtë afatit të përcaktuar, kanë të drejtë të shqyrtojnë dhe të rivendosin në afat përfitimin e bursës për nxënësin/studentin.

17. Vendimet e njësive bazë të qeverisjes vendore dhe ato të institucioneve publike të arsimit të lartë bëhen publike për komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore.

18. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore (DAR/ZA-të), institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë bazë të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

Akomodimi i Studentëve

Qyteza Studenti Vlore

Lagja Isa Boletini, Rruga Sulejman Delvina
Vlora, Vlorë, Albania

Studentët me qëndër banimi jashtë qytetit të Vlorës, mund të akomodohen në konviktin e Universitetit. Qyteza Studenti Vlorë është pozicionuar në qëndër të qytetit të Vlorës, pranë Prefekturës së Qarkut, Pranë godinës B të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Konvikti ka filluar të funksionojë si i tillë për Universitetin në vitin 1994, pasi më parë ka shërbyer për nxënësit e shkollës së mesme mjeksore "Jani Minga".

Hotel Qytetza Studenti ka një kapacitet prej 650 shtretër. Është i ndarë në dy godina. Godina dy katëshe dhe godina katër katëshe. Godina 2 katëshe ka një kapacitet prej 45 dhomash gjithsej, nga të cilat 18 janë dyshe, 6 treshe, 21 janë katërshe. Godina 4 kateshe ka një kapacitet prej 107 dhomash, nga të cilat 3 janë dyshe, 87 janë katërshe dhe 17 janë gjashtë vendëshe. Godinat janë të pajisura me dushe dhe me ambjente dhe pajisje për larjen e teshave. Gjithashtu në shërbim të tyre është edhe një lavanteri.

Perreth këtyre godinave ka ambjente të gjelbëruara dhe të përshtatura për shpłodhje si dhe terrene sportive.


Gjithashtu për studentët funksionon edhe mensa me kapacitet 100 vende që u ofron atyre ushqim të bollshëm, të shumëllojshëm, të pastër dhe të shërbyer me cilësi.

Cmimi i akomodimit për person është 300 lek/nata. Ndërsa tarifa vjetore (për vitin akademik) për studentët është 31.000 leke.

QS
VLORE

QYTEZA STUDENTI
VLORE

Tel: 033 224 440 / 033 408 121
Website: www.qsvlore.com
Email: trajtimi.studentit.vlore@gmail.com



Pershkrimi i Fakultetit

Çfarë ofron Fakulteti i Shkencave Humane?

Ky Fakultet ofron programe mësimore bashkëkohore me nivel të lartë shkencor, të përafuar me ato europiane për të përgatitur kryesisht mësues për : Cikël i Ulët, Cikël i Ulët Parashkollor, Pedagogji e Specializuar, Gjuhë-Letërsi, Gjuhë Angleze dhe Gjuhë Italiane, Histori-Gjeografi, Drejtësi. I përfshirë në hapësirën shqiptare dhe europiane të Arsimit të Lartë ky Fakultet ofron në fund të ciklit të parë 3-vjecar të studimeve Diploma të Nivelit Bachelor në të gjithë programet e mësipërme si dhe programe për Master Profesional për mësuesi në Gjuhë Italiane dhe Gjuhë Angleze, Mësuesi në cikël të ulët me profil minor parashkollor dhe Master Profesional në shkenca administrative.

Gjithashtu pranë këtij fakulteti ofrohen edhe programet e studimit në Master i Shkencave në degët Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Drejtësi, Edukim dhe Gjuhë të huaj.

Eshtë Fakultet i preferuar dhe më i madhi në Universitet prandaj i ftojmë maturantët e Vlorës, rreth Vlorës si dhe nga gjithë vendi për të aplikuar për studime në degët e këtij Fakulteti. Një staf i kualifikuar dhe me përvojë do t'ju transmetojë dijet e nevojshme. Fakulteti është i paisur me kabinete, laboratore dhe teknologji bashkëkohore të mesimdhënies të cilat do të fuqizohen edhe më tej. Nje strategji ambicioze por reale ka për zhvillimin e këtij Fakulteti.

Aktualisht në përbërje të FSHH funksionojnë departamentet e mëposhtme:

Departamenti i Drejtësisë

Ky departament ofron mundësi për të nxjerrë një produkt pozitiv nga bankat e tij qe përmbledhet në një koncept: qasja analitike. Në thelb qasja analitike do të thotë aftësimi i studentit apo studentes për të analizuar fenomene, ngjarje, koncepte, ligje

apo politika të caktuara. Në këtë mënyrë niveli universitar i studimeve arrin të parapërgatisë studentët për t'u përshtatur mirë dhe shpejt në pozicione bazë në tregun e punës. Njëkohësisht ai krijon premisa të mira për vazhdimin e studimeve master, përmes njohurive lehtësisht të transferueshme në disiplina të përafërta.

Departamenti i Drejtësisë, si njësi akademike e arsimit të lartë mësimor-shkencor, është i hapur për të gjithë studentët që dëshirojnë të studiojnë.

Departamenti i Drejtësisë ofron programe studimesh në dy cikle:

- Bachelor Master Profesional “ E Drejtë Administrative”
- Master Shkencor “Marrëdhënie Ndërkombëtare”

Misioni i këtij departamenti është që juristët e ardhshëm do të profesionalizohen në Departamentin e Drejtësisë, të jenë të aftë të marrin pozita dhe të zënë vende pune në organet e jurisprudencës, organet gjyqësore, prokurori, avokaturë, administratën shtetërore, institucionet dhe organet e ndryshme të pushtetit shtetëror dhe në sektorin privat.

Ky departament synon:

1. Dijen, shkencën dhe arsimimin e brezave të rinj
2. Aftësimin e studentit të gjykojë në mënyrë kritike dhe analitike
3. Aftësimin e studentit për të analizuar fenomene, ngjarje, koncepte, ligje apo politika të caktuara.

Programet e Departamentit të Drejtësisë janë të hartuara në mënyrë të tillë, që t'i vijjnë në ndihmë reformimit të sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe organeve të administratës publike në mënyrë të veçantë. Stafi akademik i këtij departamenti të kualifikuar dhe me përvojë ka si qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe në veçanti përsosjen e nivelit të mesimdhënies dhe kërkimit shkencor, të cilat arrihen nëpërmjet



komunikimeve të vazhdueshme dhe të frytshme me studentët. Prandaj ky departament është promotor i elitës studentore, të cilën e ndihmon me forma nga më të ndryshmet, duke nxitur edhe funksionimin e mirë të përfaqësive studentore, që studentët, si një nga grupet kryesore të interesit në arsimin e lartë, të jenë pjesë e proçesit të vendim-marrjes.

Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

është themeluar në vitin 2005. Synimi ynë është zhvillimi dhe përditësimi i albanologjisë në një botë gjithnjë e më të ndërlikur.

Departamenti i Gjuhë - Letërsisë punon t'u pergjigjet kushteve të një tregu të punës që sa vjen e liberalizohet, shumëllojshmerise së interesimeve të publikut, kapërcimit të skemave të vjetra të të menduarit që kanë prodhuar inflacion diplomash, larg dobishmërisë individuale e shoqërore.

Plani ynë akademik ofron:

1. Diploma Bachelor në Gjuhë Shqipe e Letërsi
2. Programin e Shkrimit, i pari program i këtij lloji i iniciuar ndër universitetet shqiptare
3. Programin e Masterit Profesional në mësimdhënien e gjuhës shqipe e letërsisë
4. Programin e Masterit në Editori e Arkivistikë
5. Programin e Masterit Shkencor në Studime të Trashëgimisë Kulturore Shqiptar

Departamenti i Gjuheve te Huaja

është një nga departamentet më të mëdha dhe më të rëndësishme në Fakultetin e Shkencave Humane. Departamenti i Gjuhëve të Huaja ofron dy diploma të ciklit të parë të studimeve, DNP (Diplomë e Nivelit të Parë), në gjuhën angleze dhe gjuhën italiane, si dhe dy diploma të ciklit të dytë të studimeve, MNP (Master i Nivelit të Parë), në Mësuesi në Gjuhën angleze dhe

Gjuhën italiane, si edhe MSC (Master Shkencor) në Përkthim dhe Interpretim.

Diplomat e ciklit të parë të studimeve synojnë t'u japin studentëve një formim gjuhësor dhe shkencor me drejtim human, me qëllimin që ata të jenë në gjendje të ndjekin kurse më të përparuara studimi apo të marrin një drejtim në ato fusha ku aftësia për të përdorur gjuhën e huaj me efikasitet dhe ndjeshmëri është thelbësore. Diplomat e ciklit të dytë të studimeve synojnë përgatitjen e mësuesve të ardhshëm të gjuhës së huaj për ciklin e lartë të arsimit bazë (CLAB)

Gjithashtu, departamenti ofron kurse të nivelit fillestar dhe mesatar në gjuhën angleze, italiane, frënge, gjermane, greke dhe latine për të gjithë studentët e UV-së. Shtrirja e këtyre kurseve të larmishme në programet e UV-së përbën dhe një nga risitë e vitit të fundit akademik.

Në Departamentin e Gjuhëve të Huaja do të gjeni një personel akademik me përvojë, i cili është i përkushtuar në procesin e mësimdhënies dhe i gatshëm t'u shërbejë nevojave të studentëve.

Departamenti i Edukimit

Ne krijojmë kushte që studentët tanë të marrin njohuri dhe të aftësohen si mësimdhënës me grupmosha të ndryshme dhe me grupe speciale fëmijësh.

Plani ynë akademik ofron:

- 1) Diplomë e Ciklit të Parë të Studimeve:

- Bsc ne Histori gjeografi
- Bsc ne mesuesi per arsimin fillor
- Bsc ne mesuesi per arsimin parashkollor
- Bsc ne pedagogjine e specializuar

- 2) Diploma të Ciklit të Dytë të Studimeve:



- MP ne mesuesi per arsimin fillor me drejtim minor parashkollor, MS në Edukim, Ms ne Pedagogji e Specializuar Sociale

Cili është misioni dhe vizioni i Fakultetit të Shkencave Humane?

Fakulteti i Shkencave Humane është i përkushtuar për formimin profesional e të përgjithshëm të specialistëve (mesues, juriste, historiane) që ata të jenë plotësisht kompetentë për të përmbushur nevojat që parashtron profesioni i tyre, në një mjedis dinamik. Qëllimi ynë madhor është të vazhdojmë të jemi një fakultet dinjitozë me njohje dhe reputacion ndërkombëtar, në mënyrë që diplomat që ne japim të vazhdojnë të njihen nga tregu ndërkombëtar i punës.

Përse duhet të zgjidhni Fakultetin e Shkencave Humane?

Ne ftojmë të gjithë maturanët e rrethit Vlorë, rajonit të jugut dhe të gjithë Shqipërisë të ndjekin degët që ofron fakulteti i shkencave humane. Janë degë që ofrojnë specialitete të veçanta si dhe për vet fushën e studimit.

Sa të kërkuara janë nga tregu i punës profilet e degëve që ju ofroni?

Degët që ofron fakulteti ynë janë nga më të kërkuarat në tregun e punës, për vet specialitetin që permbajnë këto degë si ato të profilit në fushën e mësimdhënies dhe në atë të drejtësisë.

Sa i kualifikuar është stafi akademik i Fakultetit tuaj?

Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Humane përbëhet nga anëtarë, nga të cilët janë 8 docentë, 9 janë doktor shkencash, 2 Profesor, 1 Profesor i Asociuar dhe pjesa tjetër e stafit me Master Shkencore.

Cilat janë objektivat afatgjata të Fakultetit tuaj?

Fakulteti ynë ka si objektiv afatgjatë përgatitjen e mësuesve të ardhshëm si dhe pronë fushën e drejtësisë të kualifikuar për trajtimin e problematikave të arsimit dhe drejtësisë. Fakulteti i Shkencave Humane ofron mundësi të reja për zgjerimin sasior dhe cilësor të programeve akademike që do të ofrohen në vazhdimësi, si master e doktoraturë në të cilat do të diplomohen jo vetëm mesues, historianë e juristë, por edhe specialistë të ketyre fushave.



DEPARTAMENTI I GJUHEVE TE HUAJA

Diplomë e Ciklit të Parë të Studimeve

BSC NË GJUHE ANGLEZE

Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredite	Tot. orë / semestër brenda & jasht auditorit	Tot. orë / semestër në auditorit	Totali orë / javë në auditorit		Totali orë jashtë auditorit
							lex	sem	
Viti 1	Sem. I	ALB 148	Gjuhë Shqipe	8	200	90	3	3	110
		ENG 144	Moduli gjuhë angleze e avancuar: Gjuhë Angleze e Avancuar 1	8	200	75	3	2	125
		ENG 170	Arti i të shkruari për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	110
		ITA 131	Moduli Italisht fillestare: Gjuhë Italiane 1	6	200	60	2	2	90
	TOTALI				30	750	315	11	10



	Sem. II	ENG 151	Gramatikë e Gjuhës Angleze	8	200	90	3	3	110	
		ENG 193	Fonologji e Gjuhës Angleze	8	200	90	3	3	110	
		ITA 132	Moduli Italisht fillestare:Gjuhë Italiane 2	8	200	60	2	2	140	
		CSH 130	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	6	150	60	2	2	90	
	TOTALI				30	750	300	10	10	450
Viti 2	Sem. I	ENG 255	Hyrje në gjuhësi për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	110	
		ENG 245	Moduli gjuhë angleze e avancuar: Gjuhë Angleze e Avancuar 2	8	200	75	3	2	125	
		ENG 280	Hyrje në Teorinë e Letërsise për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	110	
		ENG 264	Stilistikë për gjuhën angleze	6	150	60	2	2	90	
	TOTALI				30	750	300	10	10	450
	Sem. II	ENG 260	Kulturë anglofone	8	200	90	3	3	110	
		ENG 282	Letërsi Angleze	8	200	90	3	3	110	
		ENG 241	Semantikë e gjuhës angleze	8	200	90	3	3	110	
		ENG 256/ ENG 265	Zgjidh një nga: Linguistikë e Aplikuar për gjuhën angleze/ Histori e Gjuhës Angleze	6	150	60	2	2	90	
TOTALI				30	750	330	11	11	420	



Viti 3	Sem. I	ENG 346	Gjuhë Angleze e Avancuar 3	8	200	75	3	2	125	
		ENG 381	Letërsi Amerikane	8	200	90	3	3	110	
		ITA 344	Gjuhë italiane e avancuar 1	8	200	90	3	3	110	
		ENG 332/ ENG 358/ENG 342	Zgjidh një nga: Gjuhësi Teksti/Sociolinguistikë për gjuhën angleze /Studime të Komunikimit për gjuhën angleze	6	150	60	2	2	90	
	TOTALI				30	750	315	10	11	435
	Sem. II	ENG 356	Gjuhësi e Përgjithëshme për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	120	
		ENG 376	Teknika të përkthimit për gjuhën angleze	8	200	90	3	3	120	
		ENG 341	Metodat e mësimdhënies në gjuhën angleze	7	175	60	3	1	115	
		ENG 398	Projekti Final (Teza e Diplomës)	7	175	0	0	0	175	
	TOTALI				30	750	240	9	7	510



ALB 148 GJUHË SHQIPE

Kredite: 8

Orë leksioni për 15 javë: 45

Orë seminari për 15 javë: 45

Orë laboratori për 15 javë: 0

Qëllimi i kursit

Lënda *Gjuhë shqipe për gjuhët e huaja* është ndërtuar mbi bazën e dy moduleve. Moduli I synon të pajisë studentët me njohuri nga morfologjia, si: ç'është fjalëformimi, klasat e fjalëve dhe kategoritë gramatikore. Në këtë modul studentet do të marrin njohuri për trajtëformimin, format e ndryshme që marrin fjalët e lakueshme dhe fjalët e zgjedhueshme, do të studiojnë kuptimet e këtyre formave zhvillimet e morfologjisë sot dhe mendimin ndryshe në disa gramatika të hartuara. Moduli II synon të pajisë studentët me njohuri nga sintaksa: për gjymtyrët e fjalisë, llojet e saj, periudhën dhe ligjëratat. Do të studiohen marrëdhëniet që vendosen midis njësive sintaksore të formuara në ligjërim, për fjalinë e mëvetësishme dhe në përbërje të njësive më të mëdha, bashkimet funksionale që formohen si dhe teoritë e ndryshme sintaksore dhe mendimet alternative në gramatika të tjera.

Përmbajtja e kursit

KREU I: Objekti i morfologjisë së shqipes standarde.

KREU II: Struktura morfologjike e fjalës dhe tipat e fjalëformimit.

KREU III: Emri. Kategoritë gramatikore.

KREU IV: Mbiemri dhe numërori. Kategoritë gramatikore të tyre.

KREU V: Përemri. Kategoritë gramatikore.

Roli i mësimit dhe zotërimit të gjuhës amtare në shkollë është parësor dhe në qendër të edukimit të nxënësve, për të ardhmen, jetën dhe veprimtarinë e tyre në të. Si e tillë Gjuha Amtare është lëndë që bën të mundur zhvillimin e aftësive komunikative për qëllime të gjithanshme, ajo jep mundësi për zhvillimin dhe formimin intelektual, etik, estetik dhe qytetar të nxënësve. E parë në këtë këndvështrim, realizimi i këtij programi mesimor do të arrihet nëpërmjet riorganizimit funksional të përbërësve të lëndës së Gjuhës Amtare në linjën "Të lexojmë" (kulturës së të dëgjuarit, të të folurit). Mësimdhënia në Letërsi si lëndë në nivelin universitar synon të aftësojë profesionalisht studentët e profilit të mësuesisë duke i përgatitur ata për profesionin e tyre të ardhshëm. Mësimdhënia në Letërsi synon t'u japë studentëve, mësues të ardhshëm çelësat e përdorimit të profesionit në kuadër të njohjes dhe përdorimit të parimeve, kritereve, metodave, teknikave dhe strategjive që lidhen me mësimdhënien të të nxënësve dhe vlerësimin e nxënësve. Njëkohësisht kjo lëndë synon t'u qartësojë studentëve, mësues të ardhshëm, disa specifika në letërsi që lidhen me njohjen dhe përdorimin e saj si lëndë mësimore në arsimin e detyruar nëntëvjeçar. Duke patur parasysh këto synime dhe drejtime duhet të përgatiten mësues me një formim të gjithanshëm kulturor dhe shkencor, si zotërues deri në qelizë të lëndës, po ashtu, si një planifikues dhe menazhues i shkathët i orës së mësimit.

Permbajtja e kursit

- Mësimdhënia në letërsi. Kriteret e ndërtimit të programit.
- Dokumentacioni shkollor i gjuhës shqipe.
- Ora e mësimit – si njësi themelore e mësimdhënies.
- Objektivat e përmbajtjes dhe të arritjes
- Taksonomia dhe programi lëndor
- Degëzimi i objektivitetit të përgjithshëm në lëndën e leximit letrar, kërkesë për realizimin e standardeve të arritjes. Integrimi i mësimit të gjuhës me leximin letrar, hap i rëndësishëm në

përmbajtjen dhe strukturën e mësimit të gjuhës shqipe, leximit e leximit letrar në shkollë/Koncepti.

- Metodologjia e mësimdhënies në letërsinë C. U.
- Mësimdhënia me në qendër nxënësin; terma dhe koncepte.
- Metoda dhe teknika që zhvillojnë të menduarit krijues dhe kritik.
- Modele mësimdhënie në letërsi për realizimin e objektivave për linjën "Të lexojmë".
- Mësimdhënia e integruar dhe të mësuarit me tema.
- Roli, marrëdhëniet, komunikimi dhe ndërveprimi mësues-nxënës, nxënës-nxënës dhe mësues-nxënës në mësimdhënien e integruar.
- Strategji të mësimdhënies dhe të nxënësve në letërsi.
- Probleme të metodologjisë së mësimdhënies me klasa kolektive
- Linja "Të lexojmë". Elementët e leximit shprehës dhe teknika e recitimit.
- Kriteret e zgjedhjes së pjesëve për interpretim të tekstit.
- Vendi dhe rëndësia e pjesëve me teme nga folklori.
- Mësimdhënia në pjesët letrare dhe joletrare.
- Leximi jashtë klase
- Linja "Të flasim dhe të dëgjojmë" Planifikimi dhe realizimi
- Vlerësimi, Mësimdhënia dhe mësimnxënia
- Standardet në lëndën e gjuhës shqipe Tiparet dhe përbërësit, standardet lëndore dhe të arritjes. Standardet dhe marrëdhëniet ndër-institucionale në arsim.
- Standardet për mësuesit dhe standardet për nxënësit

EDU 425 Mësimdhënia e gjeografisë dhe historisë

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 45

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit



Nëpërmjet zhvillimit të këtij kursi studentët njohin dhe përvetësojnë objektin e studimit, detyrat, metodat e studimit të metodikës së mësimdhënies së kësaj lënde në moshën e re shkollore. Të aftësohen në fushën e mësimdhënies së këtyre lëndëve duke ju përgjigjur kërkesave që shtrohen sot në fushën e arsimit. Teorikisht përvetësojnë një material të bollshëm për strategjinë, teknikat, metodat e mësimdhënies së kësaj lënde, duke qenë të përgatitur për t'i zbatuar ato në praktikë.

Përmbajtja e kursit

- Objekti, përmbajtja dhe detyrat e metodikës së Gjeografisë për klasat I-IV të Ciklit 9-vjeçar.
- Të mësuarit e gjeografisë në vitet e para të shkollimit si unitet njohurish, shkathtësisht e shprehish dhe bazat psikologjike të tij.
- Kurrikulumi i Gjeografisë në Ciklin Fillor të shkollës 9-vjeçare. Parimet dhe kriteret bashkëkohore të kurrikulës së Gjeografisë.
- Shtrirja dhe përmbajtja e lëndës së gjeografisë në arsimin e detyruar. Programi i ri i lëndës së gjeografisë në klasën V.
- Ora e mësimin në gjeografi si forma kryesore e procesit mësimor.
- Tipi i mësimin hyrës, tipi i mësimin për spjegimin e materialit të ri mësimor dhe përsëritës përgjithësues, procedimi metodik.
- Tipi i mësimin të kombinuar, për kontrollin e dijeve dhe testimi, procedimi metodik.
- Kuptimi mbi strategjinë. Metodatat dhe teknkat e të mësuarit. Klasifikimi i tyre.
- Disa metoda mësimore në Gjeografi. Spjegimi, Biseda, Demonstrimi, Kallëzimi si metoda tradicionale në mësimdhënien e gjeografisë.
- Teknikat dhe metodatat e punës në grup: Diskutimi, diskutimi që zgjidh problemin dhe puna në grupe.
- Teknikat dhe metodatat e hulumtimit: Vrojtimi, Ekskursioni dhe mësimi zbulues.

- Metoda, teknka e strategji që zhvillojnë të menduarit krijues dhe kritik: Braistorming (stuhi mendimesh), rrjeti i diskutimit; Inserti dhe tabela e koncepteve si metoda të zhvillimit të aftësive lexuese; Kllasteri dhe Diagrama e Venit, metoda të të zhvillimit të aftësive shkruese.
- Formimi i koncepteve në Gjeografi; Njohja dhe klasifikimi i koncepteve.
- Disa kërkesa metodike për formimin e koncepteve.
- Grupimi i nxënësve për punë të pavarur: Puna me gjithë klasën, me grupe, me çifte dhe individuale.
- Veprimtaritë jashtë klase në mësimin e Gjeografisë: Leximet gjeografike, biseda gjeografike, filmi dhe emisionet televizive, veprimtari me karakter krijues, ekskursionet gjeografike, konkursi gjeografik.
- Të pyeturit në mësimin e Gjeografisë; Roli dhe vendi i të pyeturit. Koncepti didaktik i të pyeturit. Funkcionet dhe nivelet e të pyeturit.
- Dimensionet e të pyeturit. Teknikat e hartimit të pyetjeve. Nxitja e nxënësve për të bërë pyetje në mësimin e Gjeografisë.
- Llojet e pyetjeve, tipat e pyetjeve dhe roli i të pyeturit në nxitjen e të menduarit kritik të nxënësve.
- Metodatat dhe teknkat e punës me tekstin e Gjeografisë.
- Klasifikimi dhe përdorimi i mjeteve mësimore.
- Lidhjet ndërlëndore të Shkencës së Gjeografisë.
- Vlerësimi si pjesë përbërëse e mësimin, etapat dhe kategoritë e tij.
- Roli i mësuesit në vlerësim. Vlerësimi me teste përmbledhëse në Gjeografi.
- Objekti dhe perspektiva e të mësuarit të Historisë. Mësuesi dhe problemet e mësimdhënies. Kurrikulimi dhe kurrikula e historise.
- Program i Ri i lëndës së Historisë klasa e IV.
- Kriteret për hartimin e tekstit të historisë për Klasen e IV të Ciklit Fillor.
- Ora e mësimin dhe modernizimi i saj Shkencor – Pedagogjik.
- Kuptimi dhe metodatat e të mësuarit të Historisë.



- Formimi i koncepteve historike në moshën e Re Shkollore. Grupimi i nxënësve për punë të pavarur.
- Veprimtaritë jashtë klase në mësimin e Historisë.
- Teknikat e hartimit dhe të drejtimit të pyetjeve.
- Dimensionet e pyetjeve.
- Klasifikimi dhe përdorimi i mjeteve mësimore.
- E vërteta Historike. Kohët e Historisë.
- Historia si aktualitet i shkruar dhe regjistrimi i saj. Autoriteti dhe elementet përbërës të tij.
- Historia si shkencë.
- Metoda në histori, kuptimi dhe përdorimi.
- Ç'kuptojmë me burime historike, kriteret e klasifikimit të tyre.
- Kriteret e autenticitetit të burimeve.
- Analiza e burimeve historike. Marrja e shënimeve.
- Mënyrat e kërkimit historik.
- Analogjia dhe përgjithësimi. Statistikat.
- Hipotezat dhe koniunkturat në studimet historike. Debati.
- Shkrimi i historisë. Kategoritë e shkrimeve historike.

ENG 550 Gjuha angleze

Kredite 6

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Ky kurs ka për qëllim aftësimin e nxënësve që të mësojnë dhe të përdorin gjuhën angleze. Studentët do të jenë të angazhuar në aktivitete, që të bëjnë të mundur të katër aftësitë e gjuhës: të dëgjuarit, të folurit, leximin dhe shkrimin për të zhvilluar në mënyrë sistematike dhe të integrohen përmes detyrave të lidhura. Mësimi i gjuhës angleze ka katër objektiva të zhvillojë katër aftësitë :

Të zhvillojnë aftësi të të folurit ,

Të zhvillojnë aftësi të lexuarit ,
Të zhvillojë aftësi të të shkruarit ,
Të zhvillojnë aftësi të dëgjuarit ,
Të mundësojë studentëve të analizuar elementin e gjuhës

Ushtrimet leksikore kanë tendencë për të pasuruar fjalorin në fusha të ndryshme të aktiviteteve të jetës.

Seksione të tilla si kultura, sporti, vendet, historia mundësojnë studentëve jo vetëm për të zhvilluar aftësitë e tyre gjuhësore, por edhe të zgjerojnë njohuritë e tyre në lidhje me vendet që flasin anglisht, kulturën dhe historinë e tyre, e cila konsiderohet si një mundësi për të nxitur ndjenjën e interkulturalizmit dhe të mësuarit e vlerave të reja të nxënësit.

Permbajtja e kursit

- Vocabulary/sports, hobbies-Speaking skills. Grammar-*Present simple*
- Vocabulary-family-Discussion. *Adverbs of frequency*
- Vocabulary-areas of study/Discussion. Grammar. *Past simple, regular verbs*
- Vocabulary-story types/Discussion. Grammar. *Past simple, irregular verbs*
- Vocabulary-food and drinks. Grammar-*Countable/ Uncountable nouns*
- Writing skills. Communication-Writing. Present simple and present continuous
- Vocabulary materials. Comparative adjectives –vocabulary
- Listening skills. Asking for, giving and refusing permission
- Communication. Grammar-going to for future intentions – functions
- Discussion. Superlative adjectives –Questions with which and who,
- Words phrases related to shopping. Vocabulary, Communication,
- Developing skills. Word order and paragraphing



- Words related to jobs. Dialogues between people
- Making requests and offers, asking for and giving directions
- Making comparisons, expressing preference

BIO 510 Metodika e shkencave te natyres

Ngarkesa:

Leksione	2 ore
Seminare	2 ore
Detyra Kursi	1
Pune Laboratori	0

PERSHKRIMI I LENDES

Dituria e natyrës si lëndë e integruar. Objekti, detyrat dhe qellimi i zhvillimit të saj. Veçoritë në trajtimin e kësaj lënde në funksion të moshës së nxënësve.

Ne pjesen e pare trajtohen plotesime lendore per tematikat e meposhtme:

Koncepti mbi jeten. Energjia. Nevojat e gjallesave per energji. Levizshmeria, çvendosja, ndryshueshmeria, anekembimi, ciklet natyrore dhe jetesore dhe vlerat e tyre ne determinimin e jetes. Rregulli ne organizimin e jetes dhe natyres ne pergjithesi. Menyrat e riprodhimit te gjallesave te ndryshme. Kalkulimet dhe interpretimi i te dhenave biologjike. Matja me menyra te thjesht. Ciklet ne natyre. Kafshe te dobishme dhe kafshe te demshme. Kafshe te buta dhe te egra.

Pjesa e dyte trajton tematikat e meposhtme:

Aspekte metodike në lidhje me mësimdhënien. Konceptimi i ri mbi mësimdhënien

Mësimdhënia dhe të nxënësve. Koncepti mbi të mësuarit me në qëndër nxënësve ne lenden dituri natyre.

Karakteristika të mësimdhënies ndërvepruese. Kuptimi teorik dhe zbatimi praktik i teknikave e metodave të të mësuarit në lëndën "Dituri Natyre".. Teknika dhe metoda të të mësuarit me në qëndër nxënësve. Përgatitja e mjeteve mësimore nga nxënësve. Konceptet kryesore në lëndën "Dituri Natyre" ,ku nxënësve vihet ne qëndër të të mësuarit. Shembuj të teknikave, metodave, mjeteve që vënë nxënësve në qëndër të të mësuarit.

Praktika të mësimdhënies në lëndën "Dituri Natyre" në arsimin fillor. Praktikë e mësimdhënies sipas modelit "Mësim i integruar". Praktikë e mësimdhënies sipas teknikave të "Mendimit kritik". Praktikë e mësimdhënies sipas medelit "Hap pas hapi". Praktikë e mësimdhënies sipas medelit "A-94"

Vlerësimi i njohurive

Metodat kryesore të trajtimit të lëndës "Dituri Natyre"

Ora e mësimit, planifikimi, kërkesat themelore didaktike të organizimit të procesit mesimorë në lëndën " Dituri Natyre".

Modulime temash, demonstrimesh, eksperimentesh dhe teste të ndryshme.



DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Diplomë e Ciklit të Parë të Studimeve

BSC NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredi	Tot. orë / semestër brenda & jasht auditorit	Tot. orë / semest ër në auditori t	Totali orë / javë në auditorit			Totali orë jashtë auditori t
							lex	se m	lab	
Viti 1	Sem. I	HUM 131	Hyrje ne psikologji	8	200	75	3	2	0	125
		ALB 148	Gjuha Shqipe 1	8	200	75	3	2	0	125
		MAT 134	Matematike	8	200	75	3	2	0	125
		EDU155	Letersi per femije	8	200	75	3	2	0	125
TOTALI				32	800	300	12	8	0	500



Sem. II	PS 118	Tipet e handikapit	8	200	90	3	3	0	125
	ENG,ITA,FR 131H	Gjuhe e huaj	6	150	60	2	2	0	90
	EDU 150	Edukate qytetare	6	150	75	3	2	0	75
	EDU 135	Edukim artistik	8	200	75	2	3	0	125
	TOTALI			28	700	300	10	10	0
Sem. I	EDU 225	Pedagogji	8	200	75	3	2	0	125
	HUM 230	Psikologji zhvillimi	8	200	75	3	2	0	125
	EDU 257	Didaktike e gjuhes shqipe dhe leximit	8	200	75	2	3	0	125
	EDU253	Didaktika e matematikes	8	200	75	2	3	0	125
	TOTALI			32	800	300	10	10	0
Sem. II	EDU 233	Psikologji edukimi	8	200	75	3	2	0	125
	HUM 250	Histori kombetare	8	200	75	3	2	0	125
	EDU240	Edukim muzikor dhe didaktike	5	125	75	2	3	0	65
	EDU 265/EDU235	Zgjidh 1.Psikologji sociale/psikologji loje	7	175	75	3	2	0	100
	TOTALI			28	700	300	11	9	0



Viti 3											
Viti 3	Sem. I	EDU 349	Pedagogji familjare	8	200	90	3	3	0	110	
		EDU 325	Filozofi dhe Sociologji Edukimi	8	200	90	3	3	0	110	
		EDU337	Psikologji grupi	8	200	90	3	3	0	110	
		EDU334	Bazat eKomunikimit	8	200	75	3	2	0	125	
	TOTALI				32	800	345	12	11	0	455
	Sem. II	EDU 335	Higjiene	6	150	42	3	3	0	108	
		EDU 370	Praktike pedagogjike	16	400	320	0	5	0	80	
		EDU 398	Teza e diplomës	6	150	12	0	0	0	138	
TOTALI				28	700	374	3	8	0	326	



HUM 131 Hyrje ne psikologji

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Psikologjia e përgjithshme është një kurs teorik që trajton konceptet bazë të shkencës së psikologjisë. Lënda përshin çështje të ndryshme që lidhen me nëndegët e psikologjisë, shkollat e saj, çështje të zhvillimit njerëzor, personaliteti, inteligjenca, stresi, proceset e kujtesës, perceptimi, të mësuarit, motivimi, ëndrrat dhe përjetimi emocional. Kursi mbështetet në këndvështrime të ndryshme duke prekur orientimet e shumta aktuale të shkencës së psikologjisë. Synon të ndihmojë studentët për të krijuar një bazë njohurish të nevojshme në lidhje me objektin e studimit të psikologjisë dhe me argumentat e provuara shkencërisht që i referohen proceseve konjitive, emocionale, të personalitetit dhe të sjelljes normale dhe anormale.

Përmbajtja e kursit

- Psikologjia, objekti, nëndegët
- Zhvillimi i psikologjisë. Metodatat e kërkimit shkencor në psikologji
- Biologjia e sjelljes
- Zhvillimi
- Ndjimi dhe Perceptimi
- Gjumi dhe Ndërgjegja
- Të mësuarit
- Kujtesa njerëzore
- Gjuha dhe Inteligjenca
- Motivacioni
- Emocioni

- Personaliteti
- Stresi dhe përshtatja
- Sjellja Anormale
- Psikologjia Sociale
- Psikologjia e zbatuar

EDU 230 Psikologji zhvillimi

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Fokusi i këtij kursi do të jetë zhvillimi i individit nga konceptimi në adoleshencë, duke qenë se ai është përgatitur për studentët e edukimit parashkollor dhe fillor. Megjithatë, edhe karakteristikat e zhvillimit në moshën e rritur do të trajtohen shkurtimisht. Për çdo stad zhvillimi do të trajtohen karakteristikat kryesore të zhvillimit biologjik/ fizik, kognitiv, social e emocional të individit. Do t'u kushtohet rëndësi teorive të njohura të zhvillimit kognitiv, psiko-social, moral, për të hedhur më shumë dritë në botën e fëmijëve dhe adoleshentëve. Psikologjia e fëmijës është e rëndësishme për shumë arsye, një nga të cilat është aftësia për të kuptuar dhe parashikuar normat e zhvillimit të fëmijës. Një disiplinë e përshtatshme në klasë, stilet e mësimdhënies, stilet e komunikimit në klasë, nuk mund të mos mbështeten tek psikologjia e fëmijës e cila ndryshon dhe zhvillohet me kalimin e kohës.

Përmbajtja e kursit

- Objekti dhe historia e shkurtër e psikologjisë së zhvillimit
- Teoritë për zhvillimin njerëzor
- Bazat biologjike dhe zhvillimi
- Zhvillimi prenatal dhe lindja



- I sapolinduri
- Zhvillimi fizik dhe kognitiv ne foshnjëri
- Zhvillimi psikosocial në foshnjëri
- Zhvillimi fizik, kognitiv dhe gjuhësor në moshën parashkollore
- Zhvillimi psikosocial në moshën parashkollore
- Zhvillimi fizik dhe kognitiv në fëmijërinë e mesme
- Zhvillimi psikosocial në fëmijërinë e mesme
- Zhvillimi fizik dhe kognitiv në adoleshencë
- Zhvillimi psikosocial në adoleshencë
- Moshë e rritur e hershme, e mesme dhe e vonë

EDU233 PSIKOLOGJI EDUKIMI

Kredite 8:

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Në fund të kursit synohet të jetë arritur:

Përftimi i njohurive mbi zhvillimin e individit, duke përfshirë këtu teoritë e Erikson, Piaget dhe Kohlberg.

Të kuptuarit e parimeve dhe teorive mbi motivimin dhe të mësuarit, të lidhura këto me sjelljen, kognicionin dhe procesimin e informacionit.

Përftimi i njohurive mbi teknikat e menaxhimit të klasës si dhe metodave për t'u përballur me probleme të sjelljes.

Njohja me çështjet bashkëkohore të lidhura me edukimin.

Zhvillimi i mendimit kritik i studentëve nëpërmjet diskutimeve ne grup gjatë seancave të seminareve

Permbajtja e kursit

- Hyrje ne psikologjinë e edukimit
- Zhvillimi kognitiv dhe gjuhësor

- Zhvillimi personal dhe moral
- Të nxënët bihejviorist
- Të nxënët kognitiv
- Zhvillimi i shprehive të të menduarit
- Motivimi në klasë
- Marrëdhënia mësues-nxënës
- Menaxhimi i klasës dhe komunikimi
- Përcaktimi i objektivave dhe planifikimi i mësimt
- Mësimdhënia
- Testimi dhe vlerësimi

EDU 325 FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI EDUKIMI

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Kursi do te perfshije leksione te filozofise dhe sociologjise se edukimit. Aty do te trajtohen principet dhe njohurite baze mbi filozofine dhe sociologjiine e edukimit, problemet kryesore qe kane shqetesuar dhe shqetesojne njerezimin mbi procesin e edukimit. Ky kurs do t'iu vije ne ndihme studenteve per t'u pajisur me njohuri mbi zhvillimin e edukimit, te historise se shkolles, e sjelle nga filozofet me te medhenj te edukimit, si kane evoluar kuptimet filozofike mbi edukimin dhe shkollimin, cilat jane vlerat kryesore qe ndajme ne edukim, cilat jane institucionet e edukimit, cilat jane qellimet dhe funksionet e tyre. Cila eshte hierarkia e autoritetit ne kete proces dhe cfare rezervon e ardhmja mbi edukimin. Kursi gjithashtu do te sjelle edhe kontributet me te shquara te sociologjise se edukimit, nderthurjen e koncepteve te kultures, familjes, shoqerise, komunikimit, te perkatesise gjinore, socializimit, stratifikimit sociale, institucioneve sociale, me konceptet baze te edukimit etj. Mendimi socio-filozofik do t'i ndihmoje studentet te kuptojne vetveten



dhe pozicionin e tyre; do të zgjeroje imagjinatën e tyre në lidhje me zhvillimin e problemeve të mesipërme në bote dhe Shqipëri.

Permbajtja e kursit

- Historia e mendimit filozofik në edukim
- Qëllimi i edukimit dhe institucionet e edukimit
- Sistemi i edukimit në Shqipëri, krahasime me sisteme të tjera
- Vlerat Baze në edukim
- Sociologjia e edukimit në mes të shkencave të tjera
- Metodologjia dhe metodat e studimit
- Zhvillimi i teorisë sociologjike
- Kultura, individ dhe ndërveprimi social (Kultura dhe Shoqëria; Shoqërimi dhe periudhat e jetës;
- Ndërveprimi social dhe jeta e përditshme; Konformizmi dhe shmangia; Gjinia dhe seksualiteti)
- Strukturat sociale (Stratifikimi dhe strukturat klasore; Etnia dhe raca; Grupet dhe organizatat)
- Institucionet sociale (Familja; Edukimi, komunikimi dhe media)

MAT 134 Matematikë

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Në këto lende do të shohim një përshkrim të përgjithshëm mbi njohuritë themelore të bazës së matematikës. Këtu mund të përmendim:

Një përshkrim mbi bashkësitë dhe veprimet midis tyre (prerja, bashkimi, prodhimi kartezian, etj).

Një përshkrim mbi relacione dhe funksionet (vetite e funksioneve, menyrat e paraqitjes, kompozimi i funksioneve, etj)

Një përshkrim mbi limitin, vazhdueshmerinë, derivatin dhe integralin e funksioneve.

Një përshkrim mbi zgjidhjen e ekuacioneve dhe sistemeve të ekuacioneve

Permbajtja e kursit

- Bashkësitë dhe veprimet midis tyre
- Bashkësia e numrave natyror, të plotë, racional dhe irracional.
- Plotëpjestueshmëria, SHVP PMP
- Elemente të logjikës matematike
- Relacionet dhe funksionet
- Kompozimi i funksioneve
- Limiti dhe vazhdueshmeria
- Derivati dhe Integrali, Monotonia
- Zgjidhja e sistemit të ekuacioneve lineare

ALB 148 Gjuhë shqipe

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Paraprin njohuritë e reja gjuhësore që jepen në klasat I-VI për arsimin nëntëvjeçar. Për 45 leksionet e paraqitura jemi mbështetur në literaturë të gjerë bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj. Literatura e paraqitur veçanërisht për çdo leksion është një mundësi tjetër për zgjerimin e njohurive gjuhësore. Njohuritë e dhëna jepen të përpunuara nga ana didaktike për të rritur më tej nivelin e të mësuarit. Synon të pajisë studentët me njohuri gjuhësore, kulturë të folurit, kulturë drejtshkrimore. Të pajisë studentët me njohuri nga morfologjia si: ç'është fjalëformimi, klasat e fjalëve dhe kategoritë gramatikore.



Permbajtja e kursit

- Prejardhja e gjuhës
- Gjuha standarde
- Të folurit dhe rregullat kulturore
- Arti i të shkruarit
- Parimet e drejtshkrimit të shqipes
- Drejtshkrimi i zanoreve
- Vështrim për morfologjinë
- Emri
- Mbiemri
- Përemri
- Folja
- Parafjala
- Lidhëza.
- Pjesëza
- Pasthirma

EDU 155 Letersia shqipe per femije

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit:

Studentet te përvetesojne elementet e para te bazes teorike te letersise per femije, veçantite stilistike, kërkesat ne lidhje me subjektin, karakteret letrare, pershkrimet etj. Në këto cikël leksionesh synohet që studentët e Degës Cikli i Ulët të përftojnë njohuri mbi traditën dhe zhvillimin e krijimtarisë letrare për fëmijë, e cila, krahas letërsisë për të rritur, në vendin tonë ka nisur të zhvillohet qysh me letërsinë didaktike në shekullin XVIII. Duke qenë se kjo lëndë zhvillohet me studentët që

përgatiten për mësues në ciklin e ulët dhe parashkollor, nëpërmjet leksioneve trajtohen edhe probleme që kanë të bëjnë me grupmoshat dhe botën psikologjike të fëmijërisë për këtë pasuri letrare.

Aftesimi i studenteve per analizen ideoartistike te pjeseve qe permbajne tekstet e pjeseve letrare, si dhe te veprave letrare qe u jepen nxenesve per lexime jashteklase.

Permbajtja e kursit

- Koncepti dhe objekti i letersise per femije: Ndarja e saj ne grupmosha.
- Kërkesa pedagogjike e psikologjike ndaj letersise per femije. Karakteri zbavitës i nje vepre letrare, karakteri edukativ, si dhe karakteri njohës-arsimor i saj.
- Vecanti psikike te grupmoshave dhe pershtatja sipas tyre e letersise per femije.
- Veçanti te stilit ne letersine per femije. Fabula dhe subjekti ne krijimet letrare per
- te vegjelit. Karakteret, peizazhi, portreti, emrat e personazheve.
- Veçanti te gjuhes ne krijimet per femije.
- Veçanti te figurave stilistike ne krijimet per femije. Figurat me te perdorshme ne letersine per femije: krahasimi, epiteti, animizimi, personifikimi, onomatopeja, hiperbola.
- Veçanti tematike ne letersine per femije. Flora dhe fauna ne krijimet per te vegjelit.
- Letersia dhe leximi per femije ne bote gjer ne shekullin XVI.
- Leximi per femije ne boten e lashte dhe ne mesjete. Krijimtaria e Ezopit ne Greqine e lashte, krijimtaria e Fedrit, Krillovit, La Fontenit dhe vendi i tij ne leximet e femijeve shqiptare.
- Lindja e letersise se posaçme per femije. Charl Pero dhe vepra e tij "Maçoku me çizme". Daniel Defo ne vepren e tij "Robinson Kruzo".
- Letersia boterore per femije ne shekullin XIX. Letersia sentimentale, aventureske dhe letersia realiste demokratike. Vellezerit Grim dhe ndihmesa e tyre ne mbledhjen e



- perpunimin e perrallave gjermane, Andersen dhe ndihmesa e madhe ne zhvillimin e perralles letrare per femije.
- Levis Kerell dhe vepra e tij “*Liza ne boten e çudirave*” Edmondo de Amicis ne vepren “*Zemer*”, Mark Tuein dhe ndihmesa e tij artistike ne vepren “*Aventurat e Tom Sojerit*”.
 - Zhyl Verni dhe pikepamjet e tij per letersine fantastiko-shkencore, analize e vepres “*Dy vjet pushime*”.
 - Selma Lagerleft dhe analize e romanit te saj “*Udhetim i mrekullueshem i Nils Holgersonit*”.
 - Feliks Salten dhe vepra e tij *Bambi*.
 - Astrid Lindgren me romanin fantastik “*Pipi Corapegjata*”.
 - Aziz Nesin dhe romani i tij “*Femijet e sotem*”.
 - Xhoane Rouling dhe vepra e saj “*Harri Poter dhe Guri Filozofal*”.
 - Problemi i periodizimit te historise se letersise sone per femije.
 - Burimet e letersise shqiptare per femije.(2 ore).
 - Folklori per te vegjelit.
 - Lindja e letersise se shkruar shkollore shqiptare, letersia didaktike-fetare.
 - Letersia per femije e Rilindjes Kombetare. Kristoforidhi dhe ndihmesa e tij me tregimin “*Gjahu i malesoreve*”.
 - Naim Frasheri si themelues i letersise artistike shqiptare per te vegjelit. (*Proza dhe poezia per femije (Porosia e madhe-Rexhep Qosja)*).
 - Cajupi ne perkthimin e fabulave per femije (*fabulat e La Fontenit*).
 - Mjeda dhe ndihmesa e tij ne krijimin e poezise realiste per te vegjelit.
 - Letersia per femije ne fillim te shekullit XX (*Xanoni, Mjeda, Gurakuqi, Asdreni, Bageri, Fishta, Konica, Mithat Frasheri*).
 - Letersia moderne shqiptare per femije. Letersia per femije e viteve 30, revista per femije “*Vatra e rinise*” e Vasil Xhaçkes.
 - Milto Sotir Gurra dhe revista e tij *Mituria* – Migjeni (*Luli i vocerr*).
 - Krijimet e para per femije gjate Luftes Antifashiste. Letersia per femije pas Luftes se Dyte Boterore. E ashtuquajtura letersi “e realizmit socialist” per femije. Shkrimtare te pare te pasçlirimit: Qamil Guranjakut e “*Xixellonjat e vogla*” dhe Teufik Gjyli.
 - Krijimtaria e Zihni Sakos ne fushen e letersise per femije. Spiro Comorra - (*Poezi te zgjedhura per femije*)
 - Krijimtaria per femije e Mark Krasniqit e frymezuar nga fabulat, perrallat dhe rrefimet popullore.
 - Krijimtaria per femije e Petro Markos. Analize: “*Shpella e pirateve*”.Bedri Dedja – Pedagogu, studiuesi dhe shkrimtari per femije.
 - Analize e romanit “*Kalamajte e pallatit tim*” – analiza e poemes “*Shkolla e pyllit*”.
 - Odhise Grillo, Levrues i madh i letersise moderne shqipe per femije.
 - Skender Hasko, Levrues i te gjitha llojeve e zhanreve te humorit e satires.
 - Bota poetike per femije e Vehbi Kikaj per femije.
 - Analize e romanit “*Sarajet e bardha*”.
 - Poeti e prozatori i shquar i letersise per femije ne Kosove, Rifat Kukaj. Analize e romanit “*Droja*”.
 - I Humori dhe satira ne krijimtarine per femije te Tasim Gjokutaj. Analize e poemes humoristike “*Kush e hengri akulloren*”. Xhevat Beqaraj - Poeti i shprehjes moderne te poezise per femije (*Pse hena nuk ka fustan, Era vizaton, Letrat e vjeshtes*).
 - Ndihmesa e Ferhat Cakerri ne letersine shqipe per femije.Gaqo Bushaka dhe cikli i tij i romaneve per Cufon. Prozatori i humorit te holle dhe aventurave per femije.Adelina Mamaqi dhe magjia poetike e saj per boten feminare.
 - Bota detare ne krijimtarine per femije te Hajro Ulqinakut.
 - Krijimtaria per femije e Astrit Bishqemit.Analize: “*Udhetim i jashtezakonshem*”.
 - Studime ne letersine tone per femije

EDU 135 Edukim artistik

Kredite 8



Ore leksioni për 15 javë : 30
 Orë seminari për 15 javë : 45
 Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Lënda edukim artistik ka për qëllim formimin e përshkallëzuar të studentit me artin pamor; për të njohur, krijuar dhe analizuar vepra artistike; për të komunikuar ide duke përdorur forma të ndryshme arti, dhe për të lidhur artin me veprimtarinë jetësore. Studenti të njohë parimet dhe elementët e artit për t'i patur një armë të fortë në duart e tij në transmetimin metodik dhe interpretimin shkencor tek fëmijët. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët aftësohen për të interpretuar në mënyrë krijuese dukuritë e realitetit, të njohin ligjet e së bukurës me të gjitha format e ekzistencës së saj. Ka disa faktorë që kontrollojnë mësimdhënien e kësaj lënde, që janë të aplikuarit e mësimdhënies jo si krijim i thatë shprehish dhe shkathësisht nëpërmjet imitimit dhe kopjimit, por të aplikohet si një aktivitet që përmbledh katër role fundamentale.(Arti si i bukur, Arti si krijimtari, Arti si mjet komunikimi, Arti si mjet zbatimës.)

Permbajtja e kursit

- Kurrikula e re e artit pamor
- Arti i të vegjëleve
- Arti në lashtësi
- Arritjet dhe pengesat, kushtet e zhvillimit të artit shqiptar në të kaluarën, përmbajtja dhe forma e shprehjes artistike
- Rilindja Evropiane
- Metodika e Artit Vizual
- Planifikimi i mësimdhënies së Artit Pamor
- Dimensioni i tretë. Vështrimi i hapsirave negative, të ngjyrave “të ngrohta” dhe “të ftohta” në paletë dhe ushtrime për përzierjen e grive
- Krijimi i dritëhijeve

- Vështrim i ngjyrave plotësuese në hije
- Kuptimi i kontrastit dhe çelësit në një pikturë. Variacione të kontrastit
- Ngjyra bazë dhe përdorimi i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta për të dhënë dritë dhe
- Reflektimi i dritës në hije
- Kompozimi i një pikturë

EDU 150 Edukata qytetare

Kredit 7

Ore leksioni për 15 javë : 30
 Orë seminari për 15 javë : 45
 Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Kjo lëndë u jep studentëve njohuri e aftësi për të kupuar rolin e tyre në një shoqëri si në nivel lokal, kombëtarë e ndërkombëtar. Kjo lëndë u jep mundësi që ata të jenë të informuar, të arsyeshëm dhe të përgjegjshëm për të drejtat dhe detyrat e tyre në një shoqëri pluraliste. Kjo lëndë u nxit atyre zhvillimin shpirtëror, moral, shoqëror e kulturor. Kjo i bën ata që nesër si edukatore të inkurajojnë nxënësit e tyre për të marrë pjesë aktive në problemet e shkollës. Studentët i mëson për rregullat e reja të lojës në komunitet dhe mjedisin që i rrethon. Ajo i njeh me disa rregulla ekonomike, për institucionet demokratike e vlerat që ato mbartin në një shoqëri pluraliste. Studentët mësohen të njohin dhe të respektojnë identitete të ndryshme kombëtare, fetare dhe etnike duke marrë pjesë edhe në debate që bëhen në media dhe në shtypin e shkruar. -Shoqet e tij t'i konsiderojë si motrat e tij, duke i mbështetur e përkrahur pa rezerva. -Të njohin dy betimet e mësuesit: **R.Dottres**(Europë) dhe **E.Boyer-it**(SH.B.A.).

Permbajtja e kursit



- Parimet bazë të edukimit të qytetarëve demokratë
- Objektivat e edukimit qytetar demokratik
- Njohuritë dhe vlerat e edukimit qytetar demokrat
- Arsimimi qytetar demokratik
- Qytetaria , edukimi qytetar dhe pjesëmarrja qytetare.
- Respektimi I të drejtave të njeriut, pjesë të edukimit qytetar demokratik
- Qëllime specifike të edukimit demokratik qytetar
- Rëndësia e edukimit qytetar demokratik
- Konceptet politike globale për edukimin qytetar demokratik
- Ligji dhe edukimi qytetar në shkollë
- Paketa e plotë e mjeteve për sistemin ekonomik
- Perspektivat sociale në edukimin për qytetari dhe konteksti social i edukimit për qytetari të shekullit XXI
- Konteksti social i edukimit qytetar
- Shoqërizimi dhe edukimi qytetar
- Vlerat, etika dhe edukimi qytetar
- Demokracia dhe edukimi. Edukimi i mësuesve në një shoqëri demokratike.
- Paqartësia mbi demokracinë dhe mungesa e shprehive demokratike .
- Keqkuptimi dhe keqtrajtim i mosmarreveshjeve dhe i konfliktit në demokraci
- Kurrikula e edukimit qytetar demokratik
- Termi “Globalizëm. Sfidat e globalizmit
- Edukimi për Paqe:
- Shikimi i të drejtave të njeriut nga perspektiva e ndieshme gjinore
- Metodologji, mësimdhënie e “Edukatës Qytetare”.

EDU 253 Didaktika e matematikës

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 30

Orë seminari për 15 javë : 45

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Aftësimin e studenteve për tu bërë mesimdhënës të mirë të matematikës në ciklin fillor. Të aftësojë studentet në njohjen dhe transmetimin të nxenesit të kuptimeve kryesore matematikore përmes modeleve formateve metodave dhe teknikave me të përshtatshme dhe të efektshme të mesimdhënjes dhe mesimnxënjes. -Të aftësojë studentet në përdorimin e formave të ndryshme të vlerësimit të nxenesve për ta bërë matematikën lende të dashur për nxenesit. Të aftësojë studentet në krijimin dhe përdorimin e mjeteve mesimore të domosdoshme për mesimin e matematikës. Studenteve për tu bërë mesimdhënës të mirë të matematikës në ciklin fillor. Të aftësojë studentet në krijimin dhe përdorimin e mjeteve mesimore të domosdoshme për mesimin e matematikës .

Permbajtja e kursit

- Didaktika ,veshtrim i përgjithshëm.
- Konceptet didaktike ,program mesimor,plan mesimor,tekst shkollor.
- Programi I matematikës 1- 2.Kuptimet kryesore.
- Programi I matematikës 3 -5 .Kuptimet kryesore
- Mledhja e numurave,faktet e mbledhjes. **.(2ore)**
- Zbritja e numurave ,faktet e zbritjes. **.(2ore)**
- Shumezimi .ne matematikën 1-4 **.(2ore)**
- Pjestimi në programin e matematikës 1 - 5.**(2ore)**
- Numuri racional në matematikën 1-4 **.(2ore)**
- Kuptimi I funksionit ,ekuacionit ,inekuacionit,
- Kuptimet gjeometrike. **.(2ore)**
- Problemat, problemat tip. **.(2ore)**
- Ndertimi I lendes se matematikës
- Tekstet e matematikës 1-5
- Fletet e punës dhe literatura ndihmëse në përvetësimin e



- koncepteve Matematike ne klasat 1 – 5 .
- Metododat kryesore qe perdoren ne mesimin e matematikes 1-4 .**(2ore)**
- Percaktimi I objektivave per oren e mesimit. .**(2ore)**
- Finalitetet
- Qellimet
- Objektivat e pergjithshme.**(2ore)**
- Objektivat specifike. .**(2ore)**
- Formati ,tradicional i pergatitjes ditore
- Formati A-94 i pergatitjes ditore
- Metodologjia,Hap pas hapi me ne qender nxenesin
- Perdorimi I MKLSH dhe teknikave te tij ne mesimdhienien e Matematikes .**(2ore)**
- Vleresimi dhe format qe perdor mesuesi ne lenden e matematikes se ciklit fillor.
- Standartet e permbajtjes te Matematikes 1-4 .**(2ore)**
- Standartet e arritjeve ne matematiken 1-4 .Ku dhe si i perdor mesuesi per te rritur efektivitetin e punes se tij me nxenesit ne klase. .**(2ore)**
- Puna e diferencuar ne klase me nxenesit e talentuar ,per pergatitjen dhe pjesmarrje ne olimpiada ne shkollë dhe ne shkalle rrethi
- Puna e diferencuar me nxenesit me veshtiresi ne pervehtesimin e programit te Matematikes 1 - 5
- Testimi si forme kryesore e matjes se njohurive per vleresimin e nxenesve ne lenden e Matematikes.
- pergjithesuese ,per probleme te ndryshme te dala gjate zhvillimit te kursit

EDU 257 Didaktike e gjuhes shqipe dhe e letersise

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit:

Roli i mësimi dhe zotërimit të gjuhës amtare në shkollë është parësor dhe në qendër të edukimit të nxënësve, për të ardhmen, jetën dhe veprimtarinë e tyre në të. Si e tillë Gjuha Amtare është lënda që bën të mundur zhvillimin e aftësive komunikative për qëllime të gjithanshme, ajo jep mundësi për zhvillimin dhe formimin intelektual, etik, estetik dhe qytetar të nxënësve. E parë në këtë këndvështrim, realizimi i këtij programi mesimor do të arrihet nëpërmjet riorganizimit funksional të përbërësve të lëndës së Gjuhës Amtare; kulturës së të dëgjuarit, të të folurit, të shkruarit e strukturuar me drejtshkrim e pikësim. Metodika e gjuhes shqipe si lende ne nivelin universitar synon te aftesoje profesionalisht studentet e profilit te mesuesise duke i pergatitur ata per profesionin e tyre te ardhshem. Metodika e gjuhes shqipe synon t'u jape studenteve mesues te ardhshem çelsat e perdorimit te profesionit ne kuader te njohjes dhe perdorimit te parimeve, kritereve, metodave, teknikave dhe strategjive qe lidhen me mesimdhienien te te nxenit dhe vleresimin e nxenesve. Njekohehisht metodika e gjuhes shqipe synon t'u qartesoje studenteve, mesues te ardhshem, disa specifika te gjuhes shqipe qe lidhen me njohjen dhe perdorimin e saj si lende mesimore ne arsimin e detyruar nentevjeçar. Duke patur parasysh këto qellime dhe drejtime duhet të përgatiten mësues me një formim të gjithanshëm kulturor dhe shkencor, si zotërues deri në qelizë i lëndës, po ashtu, si një planifikues dhe menazhues i shkathët i orës së mësimi.

Permbajtja e kursit

- Arritje te gjuhesise shqiptare ne fushen e mesimit te gjuhes shqipe ne shkollë. Zhvillime te sotme
- Objekti e Didaktikes se gjuhes shqipe. Objekti i mesimit te gjuhes shqipe me shkencat e tjera.
- Gjuha amtare dhe mesuesi i Ciklit fillor. Parime te pergjithshme metodike. Kendveshtrim i ri programit te gjuhes amtare.



- Dokumentacioni shkollor i gjuhës shqipe. Plani, programi lendor dhe tekstet shkollore. Materialet ndihmese.
- Programi i gjuhës amtare në C. U. Linjat dhe nënlinjat
- Vizioni i sotem kurrikular për mesimin e gjuhës shqipe.
- Objektivat e përmbajtjes dhe të arritjes. Objektivat dhe veprimtaritë
- Metodologjia e mësimdhënies në lëndën e gjuhës amtare në C. U.
- Për një mesimdhënie ndryshe në Ciklin e ulet. Metodologjite e mesimdhënies.
- Puna me Abetaren Lexim-shkrimi dhe puna me abetaren
- Poçedurat didaktike për elementet fillestare të të lexuarit dhe të shkruarit.
- Mesimdhënia me ne qender nxenesin; terma dhe koncepte.
- Me shume të nxene bashkeveprues. Të nxenet gjate gjithë jetes
- Modeli i mesimdhënies me ne qender nxenesin. Komunikim dhe nderveprimi në klase
- Metoda dhe teknika që zhvillojnë të menduarit krijues dhe kritik.
- Të pyeturit në mesimdhënien me ne qender nxenesin. Koncepti didaktik i të pyeturit
- Mesimdhënia me ne qender nxenesin përmes zhvillimit të menduarit kritik dhe krijues
- Të shnderrojnë mesimdhënien nga profili tradicional në mesimdhënie ndervepruese, ku nxenesit janë në qender.
- Mesimdhënia me ne qender nxenesin mbështetur në parimet e edukimit global.
- Roli i mesuesit në edukimin global. Roli i nxenesit në edukimin global.
- Mesimdhënia e integruar dhe të mesuarit me tema.
- Roli, marrëdhëniet, komunikimi dhe nderveprimi mesues-nxenes, nxenes-nxenes dhe mesues-nxenes në mesimdhënien e integruar.
- Mesimdhënia e bazuar në projekte (mbështetur edhe në multimedia).

- Disa probleme që lidhen me mesimdhënien e bazuar në projekte.
- Linja “Të lexojmë”. Elementët e leximit shprehës.
- Vendi dhe rëndësia e pjesëve me teme nga folklori.
- Mësimdhënia në pjesët letrare dhe joletrare.
- Modele mesimi për linjen “Të lexojmë”.
- Plani organizativ në linjën “Të njohim gjuhën tonë”.
- Morfologji, Sintaksë. Drejtshkrim.
- Model mesimi për linjën “Të njohim gjuhën tonë”.
- Metodika e punës për rubrikën “Të shkruajmë”.
- Fazat e realizimit të procesit të të shkruarit.
- i për rubrikën “Të shkruajmë”. Duke dhënë variante të ndryshme orë mesimi me metoda dhe teknika.
- Linja “Të flasim dhe të dëgjojmë”. Planifikimi dhe realizimi
- Organizimi dhe menaxhimi i orës në linjën “Të dëgjojmë”.
- Pasurimi i fjalorit të nxenesve.
- Punët me shkrim në Ciklin Fillor
- Vlerësimi, Mësimdhënia dhe mësimnxënia
- Vlerësimi me dosje standardet në lëndën e gjuhës shqipe
- Standardet për mësuesit dhe standardet për nxënësit.
- *Probleme të metodologjisë së mësimdhënies me klasa kolektive në lëndën e gjuhës shqipe*

HUM 250 Histori kombetare

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Ore seminari për 15 javë : 30

Ore lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Programi synon të pajisë studentët me një rreth të caktuar njohurish nga historia jonë kombëtare, tu paraqesë momentet dhe ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë që nga lashtësia deri në ditët tona.



Programi u jep mundesi studentëve të analizojnë dhe mbajnë qëndrim për probleme të ndryshme historike. Studenti të arrijë të përvetësojë koncepte të reja mbi historinë dhe ti shpalosë ato në jetë. Studentit me larminë e metodave të kuptojë se çdo gjë është e arritshme në demokraci vetëm duhet vullnet dhe këmbëngulje si dhe besim në vetvete. Si mësues i ardhshëm të di të futet në komunitet për të shmangur konfliktet dhe të mundohet të zgjidhë mosmarrëveshjet me dialog, takt e durim. Të jetë përhapës i të resë në lagjen, rajonin e komunën ku ai banon ose punon. Studenti do kuptojë hapur politikat rajonale e globale si dhe influencën që kanë ato mbi Shqipërinë. Të edukojmë mësues atdhetarë larg nacionalizmave ekstremë dhe miqësorë me të gjitha etnitë

Permbajtja e kursit

- Objekti, burimet dhe periodizimi i historisë së popullit shqiptar
- Formimi i popullsisë llires
- Vendosija e mënyrës skllavopronare të prodhimit në Iliri
- Shteti i Epirit.
- Iliria nën sundimin romak
- Gjenezja e popullit shqiptar
- Vendosija e marrëdhënieve feudale në tokat shqiptare
- Pushtimet e huaja dhe qëndresa e shqiptarëve në shek. VIII-XIV.
- Formacionet feudale shqiptare në mesjetë
- Pushtimi osman dhe qëndresa e shqiptarëve
- Formimi i shtetit të përqëndruar nën udhëheqjen e Skënderbeut
- Vendosija e sistemit të Timarit. Zhvillimi i qyteteve shek. XVI- Fillimi shek. XIX
- Pashallëqet Shqiptare
- Rilindja Kombëtare Shqiptare. Situatat pas rënies së L.S.H.P
- Shpallja e Pavarësisë. Shqipëria gjatë LPB dhe në vitet 1918-1920
- Shqipëria në vitet 1920-1945. Shqipëria në vitet 1945 - 1990
- Mesimdhënia e Historisë në ciklin 9 vjeçar

EDU 337 Psikologji grupi

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Kursi i leksioneve do të përfshijë njohuri mbi funksionimin e grupit të para këto nga këndvështrimi psikologjik, aplikimin që gjejnë teorinë dhe parimet e psikologjisë në dinamikën e grupit. Në përmbajtjen e lëndës do të përfshihen përkrahjet sesi mund të përdoren teoritë dhe parimet mbi dinamikën e grupit për të pasur sa më shumë rezultate nga puna e zhvilluar në grup, përparësitë dhe vështirësitë që paraqet ajo.

Permbajtja e kursit

- Prezantim me lëndën, objekti i menaxhimit të grupit
- Metodën e studimit të grupit:
- Individit dhe grupit
- Formimi dhe struktura e grupit
- Dinamikën e grupit, formimi dhe zhvillimi i tij
- Socializimi
- Të bëhesh pjesë e një grupi; aventura e të sapoardhurit
- Refuzimi social
- Dimensionet ndërpersonale në grupet e vogla
- Ndikimi social
- Ndikimi i grupit tek anëtarët e tij, performanca e grupit
- Pushteti në grup
- Vendimarrja në grup
- Lideri i grupit; kush do të jetë lider? Karakteristikat e liderit
- Aftësitë e nevojshme të liderit
- Marrëdhëniet ndërpersonale; pse lindin konfliktet në grup?



- Komunikimi në grup
- Të mësuarit bashkëpunues dhe arritjet në grup
- Rritja e kohezionit në grup
- Kreativiteti në grup
- Vështirësitë e menaxhimit të grupit
- Përdorimi i ushtrimeve dhe lojrave në grup
- Përmbledhje e leksioneve. Diskutim mbi leksionet e trajtuar.

EDU 349 Pedagogji familjare

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Studentët nëpërmjet këtij kursi do të njihen me objektin e studimit të pedagogjisë, evoluimin e kësaj shkence deri në ditët e sotme. Studentët do të njihen më konkretisht: konceptin e familjes, llojet e familjes, konfliktet në familje, konfliktet midis brezave, familja në ditët e sotme. Të aftësohen si mësues dhe edukatorë me një formim solid shkencor për problemet e shoqërisë së sotme në përgjithësi dhe ato të familjes në kohët moderne. Qëllimi është që të mundësojnë gjetjen e rrugëve dhe strategjive për ta bërë komunikimin me familjen pjesë organike e partneritetit shkollë familje, mësues - prindër.

Përmbajtja e kursit

- Pedagogjia është shkencë që merret me edukimin e njeriut.
- Identiteti i familjes.
- Zgjedhja e bashkëshortit.
- Konfliktet bashkëshortore.
- Mekanizmi i brendshëm psikologjik i edukimit.
- Moshë e fëmijërisë.

- Veçoritë e fëmijëve 6-7 vjeç
- Adoleshenca.
- Konflikti midis brezave.
- Stresi i fëmijëve.
- Shembulli i prindërve.
- Takti pedagogjik.
- Autoriteti i prindërve.
- Sa më shumë dashuri dhe respekt aq edhe kërkesa.
- A duhen dënuar fëmijët.

EDU 225 Pedagogji

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Studentët nëpërmjet këtij kursi do të njihen me objektin e studimit të pedagogjisë, evoluimin e kësaj shkence nga lashtësia në ditët e sotme. Të njihen me burimet e dijes pedagogjike, filozofitë arsimore, sistemet, institucionet, psikologjitë dhe metodat e mësimdhënies. Të aftësohen për të gjetur forma dhe strategji të reja në praktikën shoqërore për pasurimin e shkencës së pedagogjisë dhe në veçanti të elementëve të saj; edukimi, arsimit dhe procesi i të mësuarit.

Përmbajtja e kursit

- Pedagogjia si shkencë
- Historia e zhvillimit të edukimit dhe mendimit pedagogjik
- Metodologjia e studimit shkencor pedagogjik
- Personaliteti
- Edukata kategori e përherëshme individuale dhe shoqërore
- Sistemi arsimor



- Parimet themelore te veprimit edukativ
- Marrëdhëniet edukative
- Objektivat në edukim
- Metodatat në edukim
- Didaktika teoria e të mësuarit
- Kurrikula
- Pedagogjia moderne e informacionit
- Vlerësimi ne edukim

PS 118 Tipet e handikapit

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Të ndihmojë studentët të krijojnë një bazë njohurish të nevojshme në lidhje me objektin e studimit të njohjes mbi aftësinë e kufizuar. Njohjen e studentëve me tipet e ndryshme të handikapit, historikun, trajtimin të tyre terapeutik dhe edukativ. Te pajisë studentet me njohuritë baze dhe të thelluara mbi tipet e handikapit. Te pajisë studentet me mjetet kryesore për të njohur, diagnostifikuar dhe vlerësuar personat me tipe të ndryshme handikapi. Te pajisë studentet me mjetet kryesore për të punuar me personat me tipe të ndryshme paaftesish. Te nxisë studentet të diskutojnë rreth rasteve të personave me aftësi të kufizuar.

Permbajtja e kursit

- Handikapi ne antikitet
- Vonesa mendore
- Handikapi shqisor
- Handikapi auditiv
- Handikapi vizual

- Handikapet motore
- Handikapet motore me origjine cerebrale
- Metodatat e rehabilitimit neuromotor
- Crregullimet ne te folur, komunikim dhe disa crregullime te sjelljes

EDU 335 HIGJENE

NGARKESA:

Leksione 27 orë

Seminare 18 orë

Praktikë mësimore 6 javë

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË LËNDËS

Programi i lëndës Higjenë synon njohjen e studentëve të kësaj dege me njohuritë mbi trupin e njeriut, anatominë e sistemeve dhe të aparateve, dhe funksionimin e tyre si një e tërë. Gjithashtu ky program synon dhënien e njohurive mbi higjenën e këtyre organeve dhe të sistemit të organeve si higjena e sistemit kockor, puna dhe higjena e muskujve, higjena e gojës dhe e organeve të tjera të tretjes, higjena e të ushqyerit, e mjedisit, kujdesi për organet e shqisave etj. Studentët marrin njohuri mbi sëmundjet e organeve të vecanta, sëmundjet ngjitëse dhe kryesisht sëmundjet e moshës shkollë, që lidhen me higjenën veti dhe kolektive.

EDU 334 Komunikimi

Kredite 8

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit



Kursi do të trajtojë çështje bazë të psikologjisë së komunikimit. Si degë e psikologjisë, psikologjia e komunikimit ka në fokusin e saj individin dhe mënyrën se si personi ndërton marrëdhënit me të tjerët përmes procesit të komunikimit. Duke qënë se lënda Komunikim i drejtohet studentëve të programit Bachelor Parashkollor, rëndësi do i jepen koncepteve dhe njohurive mbi komunikimin e fëmijëve që nga lindja deri në moshën 5 vjeç. Të pajisë studentët me konceptet shkencore bazë të zhvillimit të komunikimit. Të nxisë studentët drejt reflektimit mbi rolin e adultit (prindër, edukator, mësues) mbi zhvillimin normal të gjuhës tek fëmijët parashkollor. T'ju ofroj studentëve strumente efikase mbi llojin e komunikimit me fëmijët e grup - moshës 2-5 vjeç në profesionin e tyre të ardhshëm si edukator.

Përmbajtja e kursit

- Gjuha
- Të folurit dhe komunikimi
- Zhvillimi i të folurit
- Foshnja dhe kontekstet komunikuese
- Proçesi i formimit të gjuhës
- Të folurit me fëmijët e vegjël
- Televizioni për një fëmijë
- Përvetësimi i aftësive gjuhësore të fëmijëve
- Çfarë do të thotë të komunikosh?
- Komunikimi para të folurit
- Komunikimi dhe të folurit
- Shpjegimi, diskutimi, tregimi
- Vlerësimi i zhvillimit të gjuhës
- Shpjegimi i zhvillimit të gjuhës

ENG 131 Gjuhe e huaj (Anglisht)

Kredite 6

Ore leksioni për 15 javë : 30

Orë seminari për 15 javë : 30

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit

Ky është një kurs ndër-kurrikular (ndërfakultetor) i pasur me një material stimulues ngushtësisht i lidhur me interesin e studentëve dhe që synon t'i pajis ata aftësi të mira në leximin dhe të folurin e gjuhës angleze në nivelin A2-B1. Gramatika paraqitet përmes teksteve dhe dialogëve angazhues. Praktika e kontrolluar të çon më tej në aktivitetet që synojnë rrjedhshmërinë në të folur ku studentët aplikojnë gramatikën në situata komunikuese. Një program i mirëorganizuar detyrash zhvillon aftësitë e të shkruarit të studentëve.

Përmbajtja e kursit

- Koha e tashme e thjeshtë: folja ndihmëse "be" dhe foljet e plota
- Prezantimi i vetes dhe i tjetrit- Të flasim për gjendje dhe rutina
- E tashmja e thjeshtë & e vazhduar: situatat e përhershme dhe të përkohëshme
- Shprehja e pronësisë- Përemrat pronorë dhe forma pronore e emrit
- Të përshkruajmë dhe të krahasojmë. Shkallët krahasore të mbiemrit
- Të flasim për preferencat: Struktura folje + gerund
- E shkuara e thjeshtë & e vazhduar- Të lexojmë dhe të flasim për ndodhi të të shkuarës
- Shprehja e të ardhmes në anglisht: oraret, organizimet, planet dhe parashikimet
- Emrat e numërueshëm dhe të panumërueshëm: Të shprehim sasinë
- Foljet modale: must(n't), can, could, have to
- Strukturat foljore: like + gerund, would like + to-inf, I'd rather, infinitivi i qëllimit
- Fjalitë kushtore (Tipi 1): Marrëdhënia shkak-pasojë
- Fjalitë me nënrenditje kohore: lidhëzat *when, after, before*



- Pyetjet e fragmentuara me foljen ndihmëse *be* dhe *do*
- Ushtrime përsëritëse para provimit final

ENGH 132 Gjuhe e huaj II

Kredite: 6

Ore leksioni për 15 javë : 45

Orë seminari për 15 javë : 15

Orë lab. për 15 javë : 0

Qëllimi i kursit:

12	ALB 281	<p style="text-align: center;">Folklor shqiptar</p> <p>Kursi synon paraqitjen e fondit etnokulturor të vlerave artistike e shpirtërore, të normave dhe marrëdhënieve, praktikave, besimeve, dokeve e zakoneve, shenjë e idenditetit kombëtar, e aftësisë krijuese, e psikës estetike të shqiptarët, si themel e pikënisje nga mund të shpjegohen disa dukuri e prirje karakteristike për letërsinë shqipe. Ligjëratat zhvillojnë çështje të strukturës së brendshme të folklorit shqiptar (epika historike, muzikologjia, etnografia, kostumologjia, ritet dhe këngët e motmotit, këngët e dasmës, vajet, proverbat dhe gjëgjëzat) dhe të funksionit të tij artistik, lëndor e metodologjik krijues në marrëdhënie me letërsinë e kultivuar.</p>	8
13	ALB 268	<p style="text-align: center;">Sintaksë e gjuhës shqipe</p> <p>Kursi përmes një sistemi koncetrik-linear jep njohuri shkencore, përshkruan dhe shpjegon struktura sintaksore të shqipes së sotme, si edhe trajton nocionet themelore të sintaksës mbi të cilat mbështetet analiza dhe shtjellimi i lëndës. Gjatë shtjellimit të lëndës synohet të shpjegohen kategoritë e ndryshme sintaksore, të përshkruhen në</p>	8



		<p>mënyrë sa më të plotë funksionet e ndryshme të gjymtyrëve të fjalisë, të fjalisë dhe të periudhës, si edhe të vihen në dukje format dhe mjetet e shprehjes së këtyre funksioneve. Studentët pajisen teorikisht me njohuritë e nevojshme shkencore për strukturën sintaksore të shqipes së sotme, nocionet themelore të sintaksës, kategoritë e ndryshme sintaksore, funksionet e ndryshme të gjymtyrëve të fjalisë, të fjalisë dhe të periudhës, si edhe format dhe mjetet e shprehjes së këtyre funksioneve.</p>	
14	ALB 230	<p style="text-align: center;">Stilistikë e pragmatikë</p> <p>Stilistika ka si objekt të saj nivelin stilistik të gjuhës, ajo studion organizimin gjuhësor dytësor, përdorimin e gjuhës dhe variacionin e saj gjuhësor, të shprehur në tekste ligjërimore. Ajo sheh se cilat janë veçoritë dhe sjellja e mjeteve dhe e ndërtimeve gjuhësore në këtë organizim për të kryer sa më me efektshmëri komunikimin dhe për kërkesat e tjera plotësuese, në përshtatje me qëllimet e ligjëruesit dhe metraditën shoqërore dhe kulturore. Pragmatika është një drejtim i ri i gjuhësisë, një disiplinë e re, e cila qartëson dhe analizon përbërësin veprim në gjuhë. Ajo studion marrëdhëniet e shenjave me interpretuesit, ose, me fjalë të tjera, përdorimin e gjuhës dhe efikasitetin apo ndikimin mbi dëgjuesin. Objekti i saj i studimit është një botë përdoruesish ose subjektësh, si edhe kushtesh në të cilat ata veprojnë.</p>	6
15/1	Moduli i Prakti kumit Kerki mor (1) ALB 304	<p style="text-align: center;">Kerkim akademik</p> <p>Kursi synon përgatitjen teoriko-praktike metodologjike të studentit për të kryer studim e kërkim. Në varësi të natyrës së objektit kërkohet të formësohen stereotipe të caktuara të të sjellurit studimor, procedë të kërkimit shkencor. Një pjesë e rëndësishme e kursit është aftësimi i drejtpërdrejtë i studentëve për të kryer hulumtim filologjik në mjedis, mbi platforma pune konkrete, përmes komunikimit, regjistrimit, anketimit, shqyrtimit</p>	8



		të frytshëm të skedarëve e të katalogëve a të materialeve të tjera parësore e ndihmëse, deri te analiza, interpretimi, e përcaktimi i barazpeshuar i përfundimeve	
16	ALB 355	<p style="text-align: center;">Teori e letersise</p> <p>Kursi i Teorisë së letërsisë ofron në pikëpamje konceptuale e metodike, nje organon qendrimesh mbi studimin e letërsisë, natyrën e funksionin e saj, studimin e jashtëm, mënyrën e ekzistencës së vepres letrare në marrëdhënie me konceptin e normës fenomenologjike sipas Wellek e Warren. Përgjithësisht ky program u përmbahet qëndrimeve të gjithëpranuara teorike mbi problematikën e qëndrimeve pozitiviste e deterministe, fenomenologjike, hermeneutike, etj., mbi veprën letrare e mbi studimin e saj. Në diakroni e sinkroni programi përpiqet të vendosë raporte të përshtatshme e koherente mes pikëpamjeve të ndryshme teorike, për të mbërritur në një qëndrim sistematik të përfunduar.</p>	8
17	ALB 311	<p style="text-align: center;">Hyrje ne historine e gjuhes dhe fonetike historike e shqipes</p> <p>Kursi ndërtohet kryesisht mbi tezat e prof. Cabejt, por mbështetet edhe në punët e prof. Demiraj, I. Ajetit, J. Kastratit, Sh. Sejdiut, B. Baliut etj. Ligjëratat janë një sistem arsyetimi e provash të ndërthurrura, prej hulumtimeve mbi historinë e gjuhës shqipe si gjuhë indoeuropiane. Kërkohet vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indo-evropiane, shqyrtohet struktura e konkordancave të shqipes me burime të ndryshme ilire, trake, baltike, mesapike, analizohen elemente gjuhësore të toponomastikës e etnografisë së shqipes në kontekstin ballkanik, përcaktohen marrëdhëniet historike të shqipes me latinishten, greqishten, sllavishten, turqishten, rumanishten, kqyret struktura dialektore e shqipes dhe historia e shqipes së shkruar. Kursi synon të informojë edhe mbi kërkimet e sotme në disa fusha edhe nga autorë të ndryshëm për autoktoninë e</p>	8



		shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe	
18	ALB 365	<p style="text-align: center;">Letersi boterore III</p> <p>Kursi zhvillon në një pjesë të parë procesin e lindjes së letërsisë moderne të shekullit XX, si mohim estetik dhe artistik i realizëm - pozitivizmit dhe natyralizmit dhe si kalim nga realizëm-natyralizmi në letërsinë moderne. Shqyrtohen nocione ideologjike e artistike/zhanrore si: rënia e mitit të “rendit” dhe “ligjit”, poetika moderne dhe “poeti i mallkuar”, i menduari dhe rrëfimi modernist, drama dhe teatri modern. Ky modul ndalet veçanërisht në përvijimin e veçorive konceptuale të letërsisë moderne të lidhura me botëperceptimin mbi “krizën totale”, freudizmin, intuitivizmin, marrëdhënien mes kohës dhe traditës, gjuhën, shenjën, formën, “qendrën absolute”. Komentohet marrëdhënia mes Modernizmit dhe Avangardës, dallimet përkatëse, paraqiten disa nga lëvizjet, shkollat dhe rrymat e artit modernist: simbolizmi, akmeizmi, impresionizmi; paraqiten karakteristikat dhe procedimet artistike të Avangardës (avangardizmi) XX: futurizmi, dadaizmi, surrealizmi, ekspresionizmi gjerman, imazhinizmi. Pjesa e dytë kryen përshkrimin e prirjeve filozofike-estetike e letrare globaliste pas L. II B, përkatësisht të strukturalizmit dhe postmodernizmit, poezisë hermetike, neorealizmit, neoromanit, romanit të realizmit magjik, romanit eksperimental, romanit minimalist, të letërsisë masive, dukuri të shfaqura në letërsi të ndryshme.</p>	8
19	ALB 336	<p style="text-align: center;">Letersi shqipe III</p> <p>Kursi i letërsisë bashkëkohore shqipe ka si objekt letërsinë shqipe të gjysmës së dytë të shek. XX dhe fillet e saj në shek. XXI. Kursi orientohet mbi kritere të nderthurrura gjinore/kronologjike/tematike. Kryhen përshkrime, analiza, interpretime e vlerësime në rendin kronologjik, mbi dukuritë dhe prirjet zotëruese apo kategoritë e veçanta</p>	8



		përkatese të periudhës, përkatesisht mbi formacionin ideo-stilistik e estetik të Realizimit Socialist dhe mbi Letërsinë postsocrealiste e fillimet e Modernitetit të dytë ('91 e vijim) në Letërsinë Shqipe.	
15/2	Moduli i Praktikut Kerki mor (2) CSH	<p style="text-align: center;">Teknologji informacioni e komunikimi</p> <p>Kursi shtjellon disa njohuri bazike të metodologjive formale të zbatuara në teknologjinë e informacionit, tipat e të dhënave, organizimin e përpunimin e të dhënave, strukturat e kontrollit etj.</p>	6
21 (1)	ALB 225	<p style="text-align: center;">Sociolinguistike (Z)</p> <p>Kursi zhvillon të dhëna mbi objektin, fushat e zbatimit dhe marrëdhëniet e sociolinguistikës me shkencat e tjera. Jepen disa përkufizime dhe vlerësime të përgjithshme të bashkësisë shoqërore dhe asaj gjuhësore, nivelet e analizës sociolinguistike etj., marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare standarde, përkundrime sociolinguistike të shndërrimeve semantike të fjalëve për motive jashtëgjuhësore etj.</p>	6
21 (2)	ALB 236	<p style="text-align: center;">Histori e gjuhes standarde (Z)</p> <p>Lënda synon të bëjë një histori të shkurtër të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe nga fillimet e shkrimit të saj (shek. XV) e deri në ditët tona. Qëllimi është jo vetëm të jepet historia e shkrimit të shqipes, por edhe historia e standardizimit në një fazë më të lartë të shkrimit e zhvillimit të saj. Vëmendja përqendrohet edhe në konceptin gjuhë letrare.</p>	



		Rendesi i kushtohet paraqitjes se ndërtimit te sistemit të shqipes së sotme (standarde) në raport me dialektet, gjendja e normës letrare dhe veçoritë e saj strukturore, funksionale, prirjet e zhvillimit të mëtejshëm dhe detyrat për përsosjen e standardit sot e në të ardhmen.	
22 (1)	ALB 312 (Z)	Gramatike historike e shqipes (Z) Kursi i ligjëratave synon përshkrimin e përimtuar të dukurive që lidhen me strukturat themelore karakteristike të gjuhës shqipe në rendin historik. Është synuar paraqitja e vecorive tipologjike të shqipes në qarkun indoeuropian, pikëpamjet e ndryshme mbi gjenezën e saj, klasifikimi përkatës mbi kualifikimet gramatikore, shqyrtimi i proceseve të kodifikimit standartizues të shqipes mbi realitetet e evoluimit historik-linguistik, gjendja e saj sot.	
22 (2)	ALB 320 (Z)	Estetike (Z) Kursi është kuptuar si paraqitje e sistemuar e filozofisë mbi artin. Përimtohen çështje të objektit estetik dhe të strukturës shkencore të hulumtimit estetik, të lidhura me metodën e studimit, me marrëdhëniet e estetikës me sistemin e dijes e të përvojës mbi artin, historinë e shoqërinë, me klasifikimin e arteve, kategoritë estetike, vlerësimin estetik. Synohet që struktura e brendshme e kësaj disipline të studimit të zbulohet në dinamikën e vet në kronologji, përmes shqyrtimit të doktrinae estetike kryesore e përmes paraqitjes së perfaqësuesve kryesorë të mendimit estetik.	8
22 (3)	ALB 370 (Z)	Gjuhesi e tekstit (Z) Kursi përmban njohuritë bazë mbi metodat e analizat studimore që në fokusin e tyre kane tekstin e studimin e tij në tërësinë e vet, si shenja parësore që njeriu përdor në të	



		<p>folur e në të shkruar. Kursi përqëndrohet në organizimin e brendshëm të tekstit, kriteret e parimet e tekstualitetit si dhe tipologjinë e teksteve e të mënyrave të ndryshme të analizës së tyre, organizimin e masave të mëdha ligjërimore, zbulimin dhe intepretimin e stileve të një grupi tekstesh me autorë të ngjashëm, i teksteve që rrokin një periudhë të caktuar etj.</p>	
22(4)	ALB 357 (Z)	<p style="text-align: center;">Histori e kritikes letrare dhe historiografise letrare shqipe</p> <p>Kursi synon hulumtimin e procesit të kritikes letrare e historiografisë letrare në Shqiperi, në kontekstin e kontinuitetit të ideve, të çështjeve të shtruara në kohe të ndryshme për letërsinë e për disiplinat e studimit të saj. Interesimi për mendimin kritike historiografik letrar të tradites ndriçon çështje të funksionimit dhe të vlefshmërisë së tij në ditët tona. Është ndjekur shqyrtimi diakronik në katër periudha të mëdha sipas kronologjisë së Rugovës: Fillimet e mendimit kritik e historiografik në Letërsine e Vjetër; gjatë Rilindjes; gjatë viteve '12-'44; Bashkëkohësia.</p>	



TEZË E DIPLOMËS

Udhëzimi nr. 15, datë 04. 04. 2008 'Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë' - kreu VIII, pika 4 - përcakton që, për fitimin e diplomës së nivelit të parë (DNP), 'parashikohet përgatitja e një teze diplome, pa kërkesa për origjinalitet të veçantë'.

Në frymën e disiplinave të ndjekura nga studentët, teza e diplomës këshillohet që të zhvillojë kërkesat e zhanrit të reçencës bibliografike, pa përjashtuar ndonjë zhanër tjetër të shkrimit, i gjykuar si i përshtatshëm (analitik, interpretativ, etj). Teza përgatitet nën drejtimin e këshillimit të një pedagogu pranë departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.

Struktura tematike e tezave për diplomim miratohet në departament, jo më vonë se fundi i muajit të parë të vitit akademik. Studentët informohen mbi katalogun tematik dhe mbi drejtuesit e mundshëm të tezave për diplomim, në fillim të vitit akademik, menjëherë pas miratimit të tyre në departament. Tezat zgjidhen pas kërkesës së studentëve dhe rregjistrohen jo më vonë se 3 muaj nga data e parashikuar e dorëzimit të tyre për vlerësim. Drejtuesit e tezave miratohen në departament.

Teza e diplomës dorëzohet në departament jo më vonë se dy javë nga data e caktuar për mbrojtje. Mbrojtja e tezës së diplomës bëhet e hapur.

Mbrojtja e tezës së diplomës organizohet sipas kësaj procedure :

- Studenti prezanton tezën e vet para komisionit.
- Komisioni bën pyetje rreth tezës së diplomës, kandidati përgjigjet.
- Në prani të kandidatit dhe të të gjithë anëtarëve të komisionit, kryetari shpall vendimin mbi vlerësimin e diplomantit.

Teza e diplomës nuk mund të jetë më pak se 10 (dhjetë) faqe A4 - (font 12, Times New Roman, hapësirë 1,5) - dhe më shumë se 40 (dyzete). Kriteret grafike mbi tezën, të përcaktuara në departament, janë të detyrueshme po aq sa kërkesat e rendit shkencor e logjik dhe përcaktohen në mënyrë standarte për të gjithë diplomantët.

23

ALB
398

6



DEPARTAMENTI I GJUHES SHQIPE DHE LETERSISE

Diplomë të Ciklit të Dytë të Studimeve

**MS NE MESIMDHENIEN E GJUHES SHQIPE DHE
LETERSISE**



Viti I	Semestri	Kodi	Lënda	Kredi	Tot. orë / semestër brenda & jashtë auditorit	Shuma. orë / semestër në auditor	Totali orë / javë në auditor			Totali orë jashtë auditorit	
							Lex.	Sem.	Lab.	Detyra	
Viti I	Sem. I	ALB 513	FILOLOGJI E ZBATUAR NE EDUKIM	8	200	90	4	2	0	110	
		ALB 514	PSIKOLOGJI E EDUKIMIT	8	200	90	4	2	0	110	
		ALB 515	ZHVILLIMI I KURRIKULES DHE VLERESIMI	6	150	60	3	1	0	90	
		ALB 500	KULTURE E GJUHES	6	150	60	3	1	0	90	
	SHUMA				28	700	300	12	8	0	400
	Sem. II	ALB 516	METODOLOGJI TE MESIMDHENIES	6	150	60	3	1	0	90	
		ALB 501	MODUL: METODIKE E MESIMDHENIES SE GJUHES SHQIPE	6	150	60	3	1	0	90	
		ALB 502	MODUL: METODIKE E MESIMDHENIES SE LETERSISE	6	150	60	3	1	0	90	
		ALB 507/ALB 511/ ALB 510	GJUHESI E PERGJITHSHME	8	200	90	4	2	0	110	
		ALB 503	INTERPRETIM I TEKSTEVE LETRARE	6	150	60	3	1	0	90	
	SHUMA				32	800	330	16	6	0	470
Viti 2	Sem. I	ALB 505	ANTROPOLOGJI E KULTURES	8	200	90	4	2	0	110	
		ALB 506/ALB 512	LETERSI E KRAHASUAR/ KURS MONOGRAFIK	8	200	90	4	2	0	110	
		ALB 504	ANALIZE E TEKSTIT	8	200	90	4	2	0	110	
		ALB 508	GJUHESI INFORMATIKE	6	150	60	3	1	0	90	
	SHUMA				30	750	330	15	7	0	420
	Sem. II	ALB 509	PRAKTIKE MESIMORE	10	250	0	0	0	0	250	
		ALB 598	MBROJTJE E MIKROTEZES	20	500	0	0	0	0	500	
SHUMA				30	750	0	0	0	0	750	

ALB 513 FILOLOGJI E ZBATUAR NE EDUKIM

Kredite 8

Ore leksioni per 15 jave:60

Ore seminari per 15 jave:30

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Lënda “Metodologjia e Kërkimit Shkencor”, do të zhvillohet në degën gjuhë e letërsi shqipe të Universitetit “Ismail Qemali” (Master) në 60 orë leksione dhe 30 orë seminare. Këto njohuri të thelluara mbështeten kryesisht në Kartën e Bolonjës dhe përvojën më të mirë të institucioneve të larta aarsimore të vendit tonë, të cilat kanë krijuar një përvojë dhe vizion të ri në veprimtarinë kërkimore e shkencore bashkëkohore. Në hartimin e leksioneve është patur parasysh mendimi më i përparuar europian, siç është ai i dijetarëve të njohur Umberto Eco, Mishel Abate, Fiorentina Kahn etj., për të përcjellë tek studentët raporte të drejta mësimdhënieje e mësimnxënieje, si dhe njohuri të thella për të ndërtuar punime shkencore konkrete gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre metodike e mësimore.

Permbajtja e kursit

KREU I Kërkimi shkencor dhe Karta e Bolonjës.Njohuri të përgjithshme për të shkruarit si proçes krijues dhe si punë.

KREU II Roli i kërkimit shkencor në edukim, llojet e kërkimeve. Çfarë është proçesi i të shkruarit, gjymtyrët kryesorë të shkrimit.

KREU III Të njohim disa terma ndihmës (gjykim, arsyetim, koncept, përkufizim, hipoteza, përgjithësimi, interpretimi, analiza).

KREU IV Shkrimi i esesë..Elementët përbërës të esesë. Eseja letrare,eseja filozofike,eseja historike.

KREU V Modeli i një referati: zhvillimi i poezisë moderne shqipe. Shkrimi i një teme diplome.

KREU VI Burimet e një shkrimi studimor dhe shkencor.Citimi dhe rregullat e tij.

KREU VII Varianti i parë i shkrimit..Redaktimi i shkrimit dhe shkurtime.Lënda përbërëse e një teme diplome.

KREU VIII Disa procedura formale në përgatitjen e temës së diplomës.Fundshënimet, fotot, skicat dhe vizatimet.

KREU IX Aspekte te kerkimit metodik të punës shkencore.Përgatitja e një projekti në punën shkencore.

KREU X Përçimi i ideve të reja në temën e diplomës. Metodologjia e kërkimit shkencor dhe disa specifika të saj.

KREU XI Si hartohen konkluzionet e një teme diplome.Debati mbi një tepë diplome.

KREU XII Umberto Eko dhe libri i tij “Si bëhet një punim diplome”.

Metodologjia e kërkimit shkencor të Akademikut Shaban Demiraj.

KREU XIII Kërkimi shkencor në disa universitete europiane.

KREU XIV Përgatitja për ekspeditë kërkimore shkencore.Puna kërkimore në ekspeditë dhe përvoja e studiuesve.

ALB 514 PSIKOLOGJI E EDUKIMIT

Kredite 8

Ore leksioni per 15 jave:60

Ore seminari per 15 jave:30

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Qëllimi i këtj kursi është të prezantoje studentet me informacionin me te rendesishem mbi aplikimin e teorive te psikologjise ne proceset e te nxenit, si dhe mbi zhvillimin e femijeve dhe adoleshenteve. Si nje kryqezim nderdisiplinor



mes psikologjise dhe edukimit, ai do te adresojë si ceshtje teorike dhe ato praktike. Si një degë e psikologjisë do të hulumtojë shkencën e sjelljes, vecanërisht sjelljen e lidhur me zhvillimin dhe të mësuarit. Si një degë e edukimit, fokusi kryesor i tij do të jetë praktika. Ne do të shohim se si njohuritë teorike e empirike mbi njohjen dhe të nxënët gjejnë aplikimin e tyre në shkollë apo ambiente të tjera të të nxënët. Kater fushat kryesore qe do te mbulohen gjate ketij kursi jane 1) zhvillimi, 2) te nxenet dhe motivimi, 3) vleresimi dhe vendosja e notave. 4) ceshtje profesionale, nxitja e mendimit kritik. Inteligjenca, motivimi, zgjidhja e problemeve, te menduarit dhe komunikimi ne klase, diferencat individuale, testet dhe vleresimet do te jene disa nga ceshtjet e trajtuara ne kete kurs.

Permbajtja e kursit

KREU I. Te nxenet, mesimdhenia dhe psikologjia e edukimit
 KREU II. Zhvillimi kognitiv dhe gjuha
 KREU III. Zhvillimi vetjak, shoqeror dhe moral
 KREU IV. Dallimet midis nxënësve dhe nevojat pergjate te nxënët
 KREU V. Kultura dhe diversiteti
 KREU VI. Kendveshtrime bihejvioriste rreth tw nxënët
 KREU VII. Kendveshtrime kognitive rreth tw nxënët
 KREU VIII. Proceset kognitive komplekse
 KREU IX. Shkencat e te nxënët dhe konstruktivizmi
 KREU X. Kendveshtrimi sociokognitiv mbi te nxënët dhe motivimin
 KREU XI. Motivimi ne te nxënët dhe mesimdhënie
 KREU XII. Krijimi i mjediseve të të nxënët
 KREU XIII. Të mësosh cdo nxënës
 KREU XIV. Vlerësimi në klase, vënia e notave

ALB 515 ZHVILLIMI I KURRIKULES DHE VLERESIMI

Kredite 6
 Ore leksioni per 15 jave:45
 Ore seminari per 15 jave:15
 Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Qellim i kursit eshte te informoje, te pergatise, profesioniste qe e njohin realitetin e arsimit ne strukture dhe ne lende. Studentet duhet te fitojne vetebesim dhe siguri ne marredhenien e tyre me elementet formale te veprimtrise se mesimdhënies, te kultivojne ndjenjen e respektit dhe te disiplines, te nxiten per t'u perfshire ne menyre koherente ne sistemin arsimor, larg empirizmit e spontanitetit. Thelbi I kursit eshte kultivimi i vetedijes formale profesionale.

Permbajtja e kursit

KREU I : Veshtrim historik mbi Arsimin ne Shqiperi.
 KREU II : Arsimi parauniversitar ne Shqiperi .Organizimi,karakteristikat
 KREU III : Baza te kurrikules
 KREU IV : Programi mesimor i arsimit fillor klasa 1-5
 KREU V : Struktura e Planit mesimor orientues Klasa1-9
 KREU VI : Tekstet shkollore te Arsimit te detyruar.
 KREU VII : Drejtimi i institucioneve arsimore
 KREU VIII : Zhvillimet e burimeve njerezore ne arsimin e detyruar
 KREU IX : Pajisjet dhe mjetet ndihmese ne shkolle. - Bashkepunimi shkolle, familje, komunitet-
 KREU X : Grupet qe ndikojne ne institucionet arsimore.Bordi,Organet shteterore,media,botuesit.
 KREU XI : Vleresimi, vetevleresimi i institucioneve arsimore{rezultatet e nxenesve



KREU XII : . Ligjshmeria dhe zbatimimi i saj ne arsimin e detyruar.

KREU XIII : Kualifikimi i vazhdueshem i mesuesve dhe drejtuesve

KREU XIV : Standartizimi i profesionit te mesuesit ne funksion te rritjes se cilesise se shkollimit

KREU XV : Kualifikimi i vazhdueshem i mesuesve dhe drejtuesve

KREU XVI : Reformimi i vazhdueshem i kurrikules se arsimit te detyruar ne kuadrin e strategjise kombetare te Zhvillimit te arsimit

KREU XVIV : Teknologjia mesimore dhe sistemet e informacionit

ALB 500 KULTURË E GJUHËS

Kredite 6

Ore leksioni per 15 jave:45

Ore seminari per 15 jave:15

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Kultura e gjuhës, si kurs i veçantë në programin e masterit shkencor për mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë, do të vërë theksin në disa prej dukurive të përdorimit të shqipes standarde në universitetet shqiptare, duke u ndalur, sidomos, në disa çështje të asaj që, ndërsa i kishim vënë re qëkur dhe jo pa shqetësim, si prirje, si rrezik potencial, tashmë mesa duket po bëhen më të shpesha se norma, sidomos edhe në rrethanat ku ndikimi i faktorëve shoqërorë në gjuhë është mjaft i ndjeshëm dhe të cilat ne i kemi ndjekur pak.

Lëndajep përgjigje të drejta për një varg pyetjesh, çështjesh dhe vështirësish që u dalin studentëve në praktikën e tyre të përditshme në auditore dhe jo vetëm aty, por edhe në veprimtarinë e tyre të përditshme. Kjo lëndë trajton çështje të

normës morfologjike dhe sintaksore; pjesëve të ligjëratës dhe kategorive gramatikore ku ka më shumë luhajtje në zbatimin e normës, si folja, emri dhe përemri. Gjithashtu, kursi trajton çështje të rendit të fjalëve, të përshtatjes së gjymtyrëve në fjali, si dhe të shmangies së ndërtimeve të huaja.

Përmbajtja e kursit

KREU I.Gjuha letrare kombëtare e njësuar si forma më e lartë e përdorimit të shqipes së shkruar. Formimi i gjuhës shqipe të njësuar. Gjuha si element themelor i kulturës kombëtare. Norma letrare dhe kultura e gjuhës. Respekti në gjuhë.

KREU II. Normat e shqipes standarde. Shprehitë e të shkruarit drejt. Institucionet dhe mjetet që përçojnë normat e shqipes standarde.

KREU III. Emri, veçoritë e tij; gjinia, trajta, rasa. Përdorimi i emrave të përveçëm. Shumësi i tyre.

KREU IV. Përemri vetor (trajtat e shkurtra të përbëra, drejtshkrimi i tyre, sintaksa e përemrave vetorë, gabime në përdorimin e tyre). Përemrat pyetës kush dhe cili. Përemri pronor (lakimi i tyre, përdorimi, gabime në përdorim, përemrat e emëruar). Pronori vetvetor i (e) vet. Përemrat lidhorë që, i cili.

KREU V. Foljet, mënyrat dhe rastet e foljeve me dysorë.

KREU VI.Rendi i gjymtyrëve në fjali (i përcaktorëve të emrit). Përshtatja e gjymtyrëve në fjali (e kryefjalës me kallëzuesin, e përcaktorëve me emrin, e kohëve në periudhën me nënrenditje).

KREU VII. Ndërtime shqipe në vend të ndërtimeve të huaja.

KREU VIII.Parimet e drejtshkrimit të shqipes. Struktura e rregullave të drejtshkrimit të shqipes. Drejtshkrimi i zanoreve (zanoret e theksuara e, ë;)

KREU IX.Kahe të drejtshqiptimit normativ në kohën tonë. Prurje dhe ndikime nëpërmjet procesit të bashkëveprimit ndërdialektor. Shkaqet e largimit nga norma drejtshqiptimore.



KREU X. Drejtshkrimi i zanoreve, para dhe pastheksore. Grupe dhe takime zanore. Fjalët me grupet -ie/ -je. Fjalët e huaja me grupet ia, ie, io, iu dhe ai, ei, oi, ui

KREU XI. Shkrimi i bashkëtingëlloreve. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. Përdorimi i shkronjave të mëdha. Nyja e përparme dhe parafjalët. Shkrimi i datave. Përshëndetje standarde.

KREU XII. Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i numërorëve. Gjymtyrët homogjene me lidhëza dhe pa lidhëza. Gjymtyrë homogjene me fjalë përgjithësuese.

KREU XIII. Pikësimi; shenjat dhe klasifikimi. Pikësimi i fjalisë dhe pikësimi periudhës. Pikësimi i ligjëratës së drejtë.

KREU XIV. Pasurimi i gjuhës. Burimet e pasurimit. Pastrimi i gjuhës. Huazimet dhe ndërkombëtarizmat. Qëndrimi ndaj tyre. Tregues i fjalëve që mund të zëvendësohen plotësisht apo pjesërisht. Shqipërimi i disa prapashtesave të huaja.

KREU XV. Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar. Format e ligjërimit në veprat artistike.

ALB 516 METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES

Kredite 6

Ore leksioni per 15 jave:45

Ore seminari per 15 jave:15

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Bazat e pedagogjisë dhe trajtimi bashkëkohor i koncepteve të reja pedagogjike. Metodatat e reja teknologjike dhe roli i tyre në pedagogjinë e sotme. Njëpërmjet punës individuale studimore do të sygjerojmë modele alternative në formë të punimeve të shkruara (esse). Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: faktorët që ndikojnë në procesin e mësimdhënies, klasifikimi i modeleve sipas zhvillimit bihejviorist, kognitiv dhe

socioal, konceptet e mësimdhënies për të kuptuarit, zhvillimi i shprehive të të menduarit dhe shprehive të shoqërisë së dijes.

Përmbajtja e kursit

KREU I: Pedagogjia si shkencë

KREU II: Mësuesi në shoqërinë e dijes dhe informacionit.

KREU III: Mjeshtëritë e mësimdhënies

KREU IV: Planifikimi i Mësimdhënies

KREU V: Strategjitë e të pyeturit

KREU VI: Modelet e mësimdhënies

KREU VII: Katër familjet e modeleve të mësimdhënies

KREU VIII: Mësimdhënia për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë.

KREU IX: Manaxhimi i klasës

KREU X: Strategjitë e të mësuarit

KREU XI: Të nxënësit bashkëpunues

KREU XII: Stilet e të mësuarit

KREU XIII: Vlerësimi dhe motivimi

ALB 501 METODIKË E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE

Kredite 6

Ore leksioni per 15 jave:45

Ore seminari per 15 jave:30

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Metodika e gjuhës shqipe si lëndë në nivelin universitar synon të aftësojë profesionalisht studentët e profilit të mësuesisë duke i përgatitur ata për profesionin e tyre të ardhshëm. Shkolla shqiptare në të gjitha nivelet e saj vuan nga një traditë e tejzgatur lidhur me tradicionalizmin në mësimdhënie



dhe të nxënë. Ndryshimet në këtë fushë kanë qenë shumë të vogla dhe nuk janë ndjerë në procesin e mësimdhënies dhe mësimxxënies. Metodika e gjuhës shqipe synon t'u japë studentëve mësues të ardhshëm çelesat e përdorimit të profesionit në kuadër të njohjes dhe përdorimit të parimeve, kritereve, metodave, teknikave dhe strategjive që lidhen me mësimdhënien, të nxënit dhe vlerësimin e nxënësve. Njëkohësisht metodika e gjuhës shqipe synon t'u qartësoj studentëve, mësues të ardhshëm disa specifika të gjuhës shqipe që lidhen me njohjen dhe përdorimin e saj si lëndë mësimore në arsimin e detyruar nëntëvjeçar dhe të mesëm.

Permbajtja e kursit

KREU I : Objekti dhe detyrat e didaktikës

KREU II: Plani mësimor - programi dhe tekstet shkollore. Planifikimi i lëndës

KREU III : Përgatitja e mësuesit për mësim. Mësuesi si kërkues

KREU IV :Vlerësime rreth mësimit të gjuhës shqipe në periudha të ndryshme. Gramatikat

KREU V : Tendenca të sotme për mësimin e gjuhës amtare në shkollë

KREU VI : Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë

KREU VII: Mësimi i lexim – shkrimit. Metodatat e mësimit të lexim-shkrimit

KREU VIII : Metodatat analitike dhe sintetike

KREU IX : Metoda mikste në abetaren në zbatim

KREU X : Rrugë dhe forma metodike për mësimin e lexim-shkrimit

KREU XI : Orë mësimi për paraqitjen e tingullit të ri dhe për paraqitjen e grafikut të shkronjës

KREU XII : Orë mësimi për leximin e faqes dhe përforsimin

KREU XIII : Orë mësimi me fletoren e punës dhe fletoren e modeluar

KREU XIV : Përmbajtja dhe ndërtimi i teksteve të gjuhës shqipe në shkollën tetëvjeçare

KREU XV : Linjat e mësimit të gjuhës shqipe. Përmbajtja dhe veçori

KREU XVI : Njohuri dhe shprehje për drejtshkrimin, pikësimin dhe për gjuhën e folur dhe të shkruar

KREU XVII : Vështrim për metodatat e mësimit dhe klasifikimi i tyre

KREU XVIII : Kriteret e zgjedhjes së metodave në një orë mësimi

ALB 507 GJUHËSI E PËRGJITHSHME

Kredite 8

Ore leksioni per 15 jave:60

Ore seminari per 15 jave:30

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Gjuhësia e përgjithshme synon t'i pajisë studentë me konceptet bazë të studimit shkencor të gjuhësisë, të informojë mbi drejtimit gjuhësorë a mbi gjuhëtarë të veçantë që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e mendimit gjuhësor gjatë shekujve të kaluar e sot. Në programi u kushtohet vëmendje koncepteve që gjejnë shtrirje në të gjitha rrafshet e gjuhës, njohuri për fonetikën, semantikën, gramatikën, klasifikimin e gjuhëve si edhe nëndarje të tjera të makrolinguistikës.

Permbajtja e kursit

KREU I..Objekti i studimit të gjuhësisë . Gjuha dhe pasqyrimi i botës, teori e metodë analize.

KREU II. Vështrim mbi gjuhën dhe funksionimin e saj,.Marrëdhëniet midis sistemit dhe procesit të ligjërit.

KREU III.Forma dhe substanca, forma. Tradita gjuhësore në semantikë, fillimet e një semantike strukturore.



KREU IV. Gjuhësia si shkencë. Greqia e lashtë. Alfabeti dhe shkrimi, shfaqjet e para të gjuhësisë.

KREU V. Studimet gjuhësore. Aristoteli dhe "Mbi interpretimin". Shkolla e stoikëve Gramatika" e Dionis Trakasit.

KREU VI. Apolon Diskoli, Trashëgimi e Greqisë së Lashtë. Varroni dhe "De lingua latina".

KREU VII. Prisciani dhe Donati. Mesjeta. Gramatika.

KREU VIII. Skolastika. Gramatika spekulative dhe Modistët. Rilindja.

KREU IX. Studimi i gjuhëve të folura. Petrus Ramus. Gjuhët joeuropiane: kinezishtja dhe japonishtja.

KREU X. Pragu i epokës moderne. Wilhelm von Humboldt. Zbulimi i sanskritishtes.

KREU XI. Gjuhësia indiane dhe gramatika e Paninit. Gjuhësia historike dhe krahasuese në shekullin XIX

KREU XII. Dialektologjia dhe studimet. Gjuhësia në shekullin XX

KREU XIII. Zhvillimi i gjuhësisë përshkruese. Ferdinand de Saussure dhe strukturalizmi.

KREU XIV. Gjuhësia amerikane. Boas, Sapir, Bloomfield.

KREU XV. Naom Chomsky dhe gramatika gjenerative transformuese. Gjuhësia kognitive (njohëse).

ALB 503 - INTERPRETIM I TEKSTEVE LETRARE

Kredite 6

Ore leksioni per 15 jave:45

Ore seminari per 15 jave:15

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Kursi Interpretim i teksteve letrare (ALB 503) synon të njohë e të përgatisë studentët me pikëpamje e metodologji të përshtatshme për interpretimin e teksteve letrare. Ai udhëhiqet prej domosdoshmërisë për të mënjanuar sa më objektivisht e

në mënyrë të vetëdijshme empirizmin e jashtëzakonshëm që sundon interpretimin. Përgjithësisht, ky kurs mund të përkufizohet si një organon i orientuar nga parimet e hermeneutikës fenomenologjike.

Përmbajtja e kursit

KREU I. Rimarrje e disa koncepteve themelore nga Teoria e letërsisë: Natyra e letërsisë. Funkzioni i letërsisë. Studimi i jashtëm, metodologjitë pozitiviste, studimi biografik, psikologjik, sociologjik e filozofik i letërsisë.

KREU II. Studimi brendshëm i letërsisë: mënyra e ekzistencës së veprës letrare, koncepti i normës si strukturë e domosdoshme. Shtresa tingullore e veprës letrare. Stili si koncept historik. Figura. Natyra dhe lloje të prozës rrëfimtare; Zhanret letrare. Vlerësimi.

KREU III. Hermeneutika: përkufizime terminologjike e disiplinare. Drejtimet kryesore të hermeneutikës moderne. Hermeneutika romantike: Friedrich Schleiermacher dhe Wilhelm Dilthey.

KREU IV. Hermeneutika ekzistenciale e fenomenologjike: Edmund Husserli dhe Martin Heidegger

KREU V. Gadamer: hermeneutika filozofike. Paul Ricoer: hermeneutika fenomenologjike. Habermass: hermeneutika kritike

KREU VI. Hermeneutika strukturaliste. Derrida: dekonstruksionizmi; hermeneutika teologjike; hermeneutika letrare. Drejtime të tjera hermeneutike.

KREU VII. Teori e interpretimit. Gjuha si ligjërim.

KREU VIII. Të folurit e të shkruarit.

KREU IX. Metafora dhe simboli.

KREU X. Shpjegimi dhe të kuptuarit.

KREU XI. Teorite moderne mbi interpretimin. Instrumente dhe nocione bazë për interpretimin. Kritika e Re. Formalizmi Rus. Gjuhësia moderne në studimin e letërsisë.



KREU XII. Teoritë moderne mbi interpretimin. Instrumente dhe nocione bazë për interpretimin. Dekonstruksioni. Strukturalizmi. Psikoanaliza, Feminizmi.

KREU XIII. Teoritë moderne mbi interpretimin. Instrumente dhe nocione bazë për interpretimin Marksizmi. Historicismi dhe studimet kulturore. Postkolonializmi dhe studimet racore. Teoritë letrare gjinore. Teoritë e Pergjigjes së Lexuesit.

KREU XIV. Modele të interpretimit, determinimi tekstor i metodës. Raste nga letërsia shqipe.

KREU XV. Modele të interpretimit, determinimi tekstor i metodës. Raste nga letërsia botërore.

ALB 502 – METODIKE MESIMDHËNIES SË LETËRSISË

Kredite 6

Ore leksioni per 15 jave:45

Ore seminari per 15 jave:15

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Kursi ofron metodologji dhe vetëdijësim liberal mbi mësimdhënien e letërsisë. Duke shmangur natyrën spekulative të informacionit dhe të komentit kursi përpiqet të zgjidhë një nga problemet më të njohura teorikisht sot: a është e mundur të ketë mësimdhënie të letërsisë, sa kohë profili shkencor i studimit letrar është eklektik? Në nivelin didaktik, e për rrjedhojë edhe në nivelin konceptual shkencor të studimit letrar kursi i jep përgjigje kësaj pyetjeje duke u mbështetur në terma si *përvoja*, *dija*, *struktura*, instrumente të interpretimit.

Përmbajtja e kursit

KREU I. Biografia e shkrimtarit.

KREU II. Inkuadrimi historik i copave letrare

KREU III. Metoda të mesimdhënies.

KREU V I. Metodika e studimit të njohurive teorike – letrare në lenden e leximit letrar

KREU V. Lidhja e tyre me prodhimin letrar.

KREU VI. Analiza kuptimore dhe artistike e copave letrare

KREU VI I. Specifika metodike sipas gjinive letrare të tyre.

KREU VIII. Punet me shkrim në lenden e leximit letrar: hartimi i teksteve letrare dhe joletrare

KREU XI. Eseja. Llojet e saj, hartimi.

KREU X. Puna me librin artistik në klasat 6 – 9 -12

KREU XI. Leximi shprehës

KREU XII. Teknika e të folurit, frymemarrja dhe zeri. Diksoni dhe drejtshqiptimi.

KREU XII I. Theksi logjik dhe emocional. Metodika e ligjerates

KREU XIV. Vecorite e leximit shprehës së gjinive të ndryshme letrare. Llojet e leximit shprehës: individual, i dramaturgjik dhe kolektiv.

KREU XV. Vendi i leximit shprehës. Pjesët permendesh dhe recitimi

ALB 505 ANTROPOLOGJI E KULTURES

Kredite 8

Ore leksioni per 15 jave:60

Ore seminari per 15 jave:30

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Prej lëndës Antropologji Kulturore në degën Gjuhë Shqipe – Letërsi (master) synohet të arrihet një formim akademik i studentëve me një sintezë të shkencave humane me ato natyrore nën dritën e diversitetit kulturor bashkëkohor. Nëpërmjet leksioneve dhe seminareve vëmendja do të drejtohet më tepër në tipare të tilla si: gjuha e artikuluar dhe figurative, ritet funerale, magjike, artet, religjonet, zakonet, farenfisnia: si dhe teknikat instrumentale të kujtesës.

Përmbajtja e kursit



KREU I : Antropologjia si dije e kufirit. Distanca dhe veçimi, postmodernizimit etnografik.

KREU II : Modelet kulturore: natyra e tyre. Statusi i modeleve.

KREU III : Gjuha dhe kultura. Kultura si tekst dhe përkthim kulturash.

KREU IV : Fjala si element i personalitetit .Antropologjia kulturore dhe miti.

KREU V : Psikanaliza ,mitologjia dhe domethënien e mitit. Domethënien e mendimit magjik.

KREU VI : Teoria e sistemeve dhe antropologjia. Fryma europiane në kulturën shqiptare brenda diversiteti fetar.

KREU VII : Tipare të kulturës shqiptare. Drejt një etnografie dhe antropologjia kozmopolite.

KREU VIII : Shkenca e etnologjisë dhe disa veçori të saj. Krite për klasifikimin e popujve të botës.

KREU IX : Etnia dhe etnokultura e popullit shqiptar. Përjasje etnokulturore me etnitë fqinje. Mbi origjinën e ilirëve

KREU X : Krahinat etnologjike dhe rajonizimi I tyre. Lëvizjet migruese të shqiptarëve. Shqiptaret në diasporë.

KREU XI : E drejta zakonore e popullit shqiptar. Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe Kanuni i Labërisë

KREU XII : Lidhjet martesore dhe karakteri I tyre. Ceremonia e fejesës (zënia) dhe ndërmjetësia.

KREU XIII : Tiparet dhe funksionet e familjes shqiptare. Doke, rite, ceremoni familjare dhe ceremoni për vdekje.

KREU XIV: Ekonomia fshatare dhe zhvillimi i bujqësisë. Lindja e Organizimi blektorisë dhe zhvillimi i saj në Shqipëri.

KREU XV : Vendbanimet -struktura formuese e fshatit. Tipa të banesës qytetare dhe urbanistika qytetare. Përvoja ndërtuese e shqiptarëve

KREU XVI : Elemente të kulturës së lashtë në veshje. Mendimi i prof. Andromaqi Gjergji për veshjet shqiptare.

KREU XVII : Mjeshtëritë popullore –tekstilet popullore. Mjeshtëria e zejtarisë popullore. Studiuesit shqiptarë për antropologjinë kulturore

ALB 506 – LETËRSI E KRAHASUAR

Kredite 8

Ore leksioni per 15 jave:60

Ore seminari per 15 jave:30

Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Prania e përhapur e veprave të huaja në programet e shkollave letrare, por edhe në katalogjet e kolanave të xhepit dhe në libraritë e tregjeve të stacioneve të trenave, shkrimet e shumta kritike për to, të botuara në revista dhe gazeta, dëshmojnë se sot letërsia nuk përbëhet vetëm nga krijimet kombëtare. Ajo po hapet gjithnjë e më tepër ndaj shumë kulturave të ndryshme. Komparatistët, që priren të njohin dhe të studiojnë pikërisht veprat që vijnë nga jashtë, që shkojnë gjetkë dhe flasin për gjetiu, kanë në këtë fushë një përvojë, e cila nuk duhet shpërfillur. Një pjesë të kësaj përvoje paraqet ky cikël leksionesh.

Përmbajtja e kursit

KREU I. Përkufizime mbi disiplinën.

KREU II. Vepra e huaj. I huaj/Kombëtar/I njohur

KREU III. Përkthimet dhe tekstet e përkthyer.

KREU VI. Një mjet i zakonshëm takimi me një vepër të huaj.

KREU V. Teoritë e përkthimit dhe stilistika e krahasuar.

KREU VI. Letërsia që do përkthyer dhe sistemi i pritjes.

KREU VII. Trevat gjuhësore, trevat kulturore.

KREU VIII. Letërsitë e quajtura klasike.

KREU XI. Letërsitë e quajtura regjionale ose dialektore.

KREU X. Nje konceptim krahasues i leximit.

KREU XI. Imazhi i të huajës.

KREU XII. Letërsia botërore.

KREU XIII. Cështjet e një historiografie letrare krahasuese.



KREU XIV. Zgjedhjet metodologjike themelore.
KREU XV. Epoka, lëvizjet, rrymat letrare.

ALB 512 KURS MONOGRAFIK

Kredite 6
Ore leksioni per 15 jave:60
Ore seminari per 15 jave:30
Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Lënda Kurs Monografik është konceptuar në dy pjesë: pjesa e parë do t'i njohë studentët me njohuri nga fusha e narratologjisë, e studimeve të semiotikës tekstore e pragmatikës tekstuale, me qëllim pajisjen me instrumentat e nevojshëm për interpretimin e teksteve letrare në prozë; pjesa e dytë e lëndës është një aplikim i këtyre koncepteve e instrumentave në prozën e shkrimtarit Faik Ballanca, me qëllim njohjen e karakteristikave të prozes së tij dhe ofrimin e një modeli të punës shkencore në kete drejtim.

Permbajtja E Kursit

KREU I:Kuptimet e termit rrëfim. Koha, aspekti, mënyra. Koha: rendi (anakronia, analepsa, prolesia), kohëzgjatja (përmbledhja, elipsa, pauza përshkrues, skena), shpeshtësia. Kronotopia: marrëdhëniet mes kohës e hapësirës. Skema e Joshuas.

KREU II: Mënyra (modaliteti). Perspektiva. Fokalizimet. Cështjet e zërit. Tipet e narracionit nga këndvështrimi kohor. Nivelet e narracionit.

KREU III: Funkzionet e tregimtarit. Historia dhe narracioni. Historia-Subjekti-Aksioni. Fillimi dhe fundi. Rrëfimet e shumëfishta. Përshkrimi. Funkzionet e përshkrimit. Hapësira. Inventari i vendeve. Spostimet e itineraret. Koha. Koha e aventurës. Koha e shkrimit. Koha e leximit.

KREU IV: Personazhet. Një rrjet raportesh. Funkzionet e personazhit romanor. Psikologjia e tyre. Mënyrat e prezantimit. Metamorfoza e personazhit romanesk.

KREU V: Prezantimi i studimit mbi prozën e Faik Ballancës. Ballafaqimi i veprës letrare me kriterin kohë dhe ligjësitë letrare.

KREU VI: Studimet kritiko – letrare për prozën e F. Ballancës. Vepra e tij letrare, një tërësi tekstesh pa metatekst. Struktura tematike e prozës tregimtare të Ballancës. Interesimet subjektore. Tipologjia tematike.

KREU VII: Struktura e personazheve. Cilësimet tematike të personazheve. Ligjërata rrëfyese në prozën e Ballancës. Rrëfimi në vetën e parë. Rrëfimi në vetën e parë të ndërthurur me vetën e tretë. Rrefimi në vetën e tretë. Rrëfimi në vetën e tretë të ndërthurur me vetën e parë.

KREU VIII: Sintaksa e tregimit të Ballancës.

KREU IX: “Nomeja e largët”, roman për individin dhe relacionet e tij me kolektivin. Historiku i shkrimit të romanit. Tematika filozofike e metafizike e romanit. Relacionet inerte tekstuale me novelën “Katër orë larg shtëpisë”. Kompozicioni i romanit. “Nomeja e largët” si formë e vecantë narracioni në prozën shqipe”

KREU X: Proza e Faik Ballancës, mes skemës së socrealizmit dhe estetikës së realizmit.

ALB 504 ANALIZE E TEKSTIT

Kredite 8
Ore leksioni per 15 jave:60
Ore seminari per 15 jave:30
Ore laboratory per 15 jave:0

Qëllimi i kursit

Ky program paraprin njohuritë për analiza gjuhësore që do t'u shërbejnë studentëve të gjuhës dhe letërsisë shqipe, që studiojnë në nivelin Master Shkencor në Mësimdhënie (cikli i



dytë i studimeve) me sistemin Bachelor, të cilët përgatiten për mësimdhënie në cikle të ndryshme të arsimit 9-vjeçar dhe të shkollave të mesme. Për leksionet e paraqitura jemi mbështetur në literaturë të gjerë bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj. Literatura e paraqitur veças për çdo leksion është një mundësi tjetër për aftësimin e studentëve lidhur me analizat gjuhësore të teksteve. Njohuritë e dhëna jepen të përpunuara nga ana didaktike për të rritur nivelin e të nxënit. Synon të pajisë studentët me njohuri rreth funksioneve të mjeteve të shprehjes dhe motivimin e përdorimit të tyre në tekst. Gjithashtu synon të ndihmojë për zotërimin aktiv të gjuhës letrare, për njohjen e mjeteve popullore të shprehjes, shumë të pasura e të larmishme si dhe për zhërvjellësimin e të folurit.

Permbajtja e kursit

KREU I : Teksti dhe metoda e analizës së tekstit
 KREU II : Vlerat e shndërrimit të tekstit
 KREU III : Teksti, bashkimi i domethënies dhe përcaktimet e tyre
 KREU IV : Procedurat e analizës së tekstit
 KREU V : Fjala si njësi gjuhësore dhe vlerat e fjalës në gjuhën shqipe
 KREU VI : Përmbajtja leksikore e fjalëve në gjuhën shqipe dhe kuptimi leksikor si njësi themelore semantike
 KREU VII : Leksiku dhe shtresimi i tij
 KREU VIII : Shtresa potenciale e leksikut të shqipes, pastërtia dhe pasurimi i leksikut
 KREU IX : Krijimtaria gjuhësore e shkrimtarit dhe teksti
 KREU X : Leksiku popullor si burim pasurimi dhe te folmet
 KREU XI : Kriteret për caktimin e burimit popullor të fjalëve
 KREU XII : Shtresimi i leksikut dialektor dhe krahinor dhe vlerat e tij
 KREU XIII : Dialektalizma leksikore në letersinë artistike dhe në letersinë politiko-shoqërore

KREU XIV : Frazheologjia e gjuhës shqipe dhe vlerat e saj
 KREU XV : Variacionet në frazeologji dhe lokucionet librore
 KREU XVI : Përdorimi stilistik i “contradictio in adiecto”
 KREU XVII : Stili politiko-shoqëror
 KREU XVIII : Gjuha e shtypit në kohën tonë dhe zhvillimi i tij

KREU XIX : Sasia dhe lloji i fjalëve në shkrime të gazetës

ALB 509 – PRAKTIKE MESIMORE

Kredite: 10

Ngarkesa: 12 javë (250 orë)

Qëllimi i kursit

Si formë e rëndësishme e organizimit të procesit mësimor në shkollën e lartë që përgatit mësues, praktika pedagogjike ka për qëllim të aftësojë studentët nga pikëpamja profesionale për të dhënë mësim, në përputhje me kërkesat bashkëkohore që shtrohen sot për forcimin cilësor të shkollës, dhe për t'i aftësuar me shprehje praktike për shkollën dhe jetën

Përmbajtja e kursit

KREU I. Vëzhgim orësh të drejtuar nga mësuesi metodist
 KREU II. Njohja me dokumentacionin shkollor
 KREU III. Praktika mësimore sipas metodës së mësimdhënies me në qendër nxënësin
 KREU IV. Përsosja e teknikave të gjuhës së folur
 KREU V. Metodot dhe teknikat e mësimdhënies gjatë analizës së pjesës letrare
 KREU VI. Strategjitë e të lexuarit dhe metodot përkatëse të mësimdhënies
 KREU VII. Ndërtimi i personazheve. Puna me stilistikën dhe fjalorin



KREU VIII. Plani organizativ në linjën “Njohuri Gjuhësore”.
Metodika e punës.

KREU IX. Njohuri të reja në: morfologji, sintaksë, leksikologji,
drejtshkrim, fjalëformim

KREU X. Ushtrime gjuhësore

KREU XI. Metagjuhë apo orë e integruar

KREU XII. Procesi i të shkruarit

KREU XIII. Realizimi i detyrave me shkrim në klasë

KREU XIV. Plotësimi i ‘dosjes së vlerësimit’ të nxënësve

KREU XV. Përgatitja për paraqitjen e praktikës mësimore dhe
për vlerësimin përkatës


Përgatiti

**Roksana Nowak
Ina Cobani
Zyra e Publikimeve
dhe Botimeve Universitare**

**Deliana Proj
Zyra e Marrëdhënieve
me Publikun**

Prill 2015

Cdo informacion ne kete guide eshte mare nga faqja zyrtare e Univeritetit "Ismail Qemali" Vlore www.univlora.edu.al, nga faqja jone zyrtare facebook si dhe nga zyrat e personelit akademik dhe nga zyra te ndryshme te administrates.



UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

**L. Pavarësia
9400 Vlorë
Shqipëri**

Telefon: +355 33 222288

www.univlora.edu.al